

# Malësia

E PAVARUR, INFORMATIVE, HISTORIKE DHE PATRIOTIKE

Botues; Vasel GILAJ, Viti i botim XXI, Nr 58, New York, Korrik 2016 hotian98@gmail.com

FREE



Po ku je, o Malësi e Madhe,  
Mirë e di ke pas shumë halle,  
Je kreshnike, je e mirë,  
Jam krenar që jam yt bir!

## PSE E SULMUAN MALËSORËT SHKODRËN MË 1912?!

Na ndiqni në:

[www.gazetamalesia.com](http://www.gazetamalesia.com)

**Papa shpall dekretin e martirizimit të 38 martireve të vrarë në 1945-1974**

FAQE 17-19

**A mund të jetë 5 Maji dita e të gjithë Dëshmorëve të Atdheut?!**

FAQE 20-26

**Cokajt, piramidë shqiptarie, të vrarë nga tre shtete**

FAQE 27-30

**Mirash Ivanaj, ministri i parë nga Malësia e Madhe që vuri themelet e arsimit kombëtar shqiptar**

FAQE 31-34

**Sali Mani këngëtar i kombit, kjo emblemë e traditës së Malësisë së Madhe**



FAQE 35-36

**Gjergj Kalaj, patrioti i paharruar**



FAQE 37-38

**Perlat Ramçaj fisniku që i duhej Malësisë**



FAQE 39-40

**Fran Pacaj-Babaj, artisti që u fsheh pas modestisë dhe njeriu ëndërrtar**



FAQE 41-45

**Gjok Pjetër Deçkaj shqiptaro-amerikani nga Kushe e Hotit flet për tmerret në kampet e Enverit**

FAQE 46-48

**Ermira Ymeraj intelektualja që nderon vendin e origjinës Malesinë e Madhe dhe Shkodër locen!**

FAQE 46-48

**Veleçiku i Koplikut apo i Malësisë?!**

FAQE 51

Rrethimi malazez i Shkodrës,  
mbrojtja 183-ditore e qytetit  
dhe kapitullimi



**Pas Sirisë, Shqipëria konsiderohet nga UNHCR si vendi me kërkesat më të larta për azil**

FAQE 4

**Parlamenti i ardhshëm i Shqipërisë me tre deputetë nga diaspora**

FAQE 5

**Si u formua krahina Malësi e Madhe? Përshkimi historik, rebelimi ndaj Balshës dhe roli i Venedikut**

FAQE 6-8

## Alba-Kos Malësia Tours



\*Your vacation is our business\*



**AIRLINE TICKETS**  
Domestic & International



Dedë Dedvukaj

Honeymoon Packages  
Cruises  
• Rental Cars  
• Hotel Reservations  
• Tours



Pashko Dedvukaj

*Ftesa për ceremonitë tuaja familjare.*

Bileta me çmime të volitshme për në Vendlindje,  
Evropë dhe kudo në SHBA!

### ALBAKOS

**Import / Export Company**

Goods ~ Food ~ Meats ~ Oil ~ Petroleum ~ Electronics ~ Equipment ~ Clothing

### MADENO ASSOC., INC.

Sales • Renting • Management • Investments

• *Anywhere you go Malësia will take you there* •

Land • Sea • Air - Sales • Rentals • Mgmt. • Import/Export

**Tel. 1-718-220-5000 Fax. 1-718-365-5371**


[www.MalesiaTours.com](http://www.MalesiaTours.com)

e-mail: [malesiatours@hotmail.com](mailto:malesiatours@hotmail.com)

2462 ARTHUR AVENUE, BRONX, NY 10458

## Malësia

Ju fton të kontriboni, për promovimin dhe mbrojtjen e vlerave të patjetërsueshme që trashëguam si amanet nga të parët!



**Për gjithëcka që juve interesoheni në fushën e krijimit dhe promovimit, me korrektësi dhe çmime konkurruese.**

**alsiva-art** Kontakt: +355 692098373  
albertvataj1966@gmail.com

## “Cakor” Restaurant Bar

- Kuzhine speciale e të gjitha llojeve
- Te Cakor këndojnë këngëtarët më të mirë të të gjitha trojeve shqiptare në Ballkan.

**SHËRBEJMË EDHE ME POROSI**

TELEFONO: 718-733-1033

718-733-2300

ADRESA: 632 E 186th St, Bronx,  
NY 10458

WEB: [www.cakorrestaurantny.com](http://www.cakorrestaurantny.com)

Një mundësi,  
një zgjedhje,  
një zgjidhje



Korrektësi  
dhe çmime të  
leverdisshme



Gëzimet tuaja  
marrin dimension  
të ri tek ne



**UNHCR**  
The UN Refugee Agency



# Pas Sirisë, Shqipëria me kërkesat më të larta për azil

**R**epublika arabe e Sirisë ishte gjatë vitit të kaluar 2015, vendi i origjinës me numrin më të lartë për azilkërkuessit, e ndjekur nga Shqipëria, Serbia dhe Kosova, Afganistani, Iraku. Një fakt i tillë konfirmohet në raportin vjetor të UNHCR-së (Organizata Ndërkombëtare e Refugjatëve) “Tendenca Globale”, i cili ndjek zhvendosjet e detyruara në mbarë botën, bazuar në të dhënat e qeverive, partnerëve, përfshirë Qendrën Monitoruese të Zhvendosjeve të Brendshme. Publikuar pikërisht në Ditën Botërore të Refugjatëve, ai tregon sesi duke filluar nga fundi i vitit 2015, janë zhvendosur plot 65.3 milion njerëz, krahasuar me 59.5 milion vetëm dymbëdhjetë muaj më parë. “Kjo është hera e parë që pragu prej 60 milionësh është kapërcyer”, - shpjegon UNHCR për situacionin e emigrimit më vitin 2015. Duke shtuar se Gjermania ishte pritësi më i madh i kërkesave të reja për azil, me 441,900 të regjistruar gjatë vitit 2015. Kjo është më shumë se dyfishi i numrit të regjistruar një vit më parë (173.100) dhe rritja e tetë radhazi për Gjermani. Numri më i madh i aplikimeve është pranuar për individë me origjinë nga Republika Arabe të Sirisë- 158,700 aplikacione të reja, ose rreth katër herë më shumë se gjatë vitit 2014 (39,300). UNHCR referon se më tej edhe faktin se Gjermania pa një rritje dramatike të numrit të aplikacioneve të reja për azil nga shqiptarët me rreth 53,800 kërkesa të tilla, ose gjashtë herë më shumë se një vit më parë. Kurse për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës aplikimet për azil

në vitin 2015 thuhet se u rritën me nivelin prej 42%. “Këta individë vijnë kryesisht nga Meksika, El Salvador, Guatemala dhe Honduras kryesisht prej dhunës dhe persekutimit të krijuara nga krimi i organizuar i lidhur me bandat e drogës”, citon

UNHCR-ja. Duke përfunduar se Suedia renditet e treta në vitin 2015 me 156,400 aplikime të reja për azil, më shumë se dyfishi i vitit të mëparshëm (75,100). Ndërsa ka pasur një rritje të konsiderueshme në pretendimet siriane për azil.





# Parlamenti i ardhshëm i Shqipërisë me tre deputetë nga diaspora

**V**izitat e koheve te fundit, te dy liderve kryesore te politikës se Shqipërisë L.Basha dhe E.Rama ne SH.B.A dhe takimet e tyre me Diosporen, e ne vecanti ajo e Kryeministerit Rama ndonese ende te pa bera publike per opinionin, por vetem per rrethet e ngushta te tyre. Kane zbuluar nje sekret dhe qe eshte parashikimi se Parlamenti i ardhshem i shqipërisë do te kete se paku 3 Deputet nga diaspora ne SH.B.A, dhe jo vetem pasi perfaqesues te Emigracionit ne Politiken e ardhshme te shqipërisë, do te kete edhe nga vendet Europiane e ndoshta edhe nga Kanadaja. Dhe konkretishte sic jane Italia, Greqia, Anglia, apo Gjermania, gjithsesi ky eshte vetem fillimi dhe parashikimi i ketij procesi,

sa te formohet dhe te miratohet vendimi per pjesmarrjen ne votim te te gjithe shtetaseve te Shqipërisë kudo ku ata ndollen ne te gjithe boten, proces i cili edhe pse ne pamje te pare te duket i veshtire teknologjia e sotme dhe nje organizim sa me i mire do ta munesonte realishte ,dhe qe pa dyshim nje pjesmarrje e tille tashme eshte bere edhe domozdoshmeri e kohes. Gjithashtu behet me dije se eshte duke u punuar edhe per percaktimin e numerit te deputeteve per seicilin shtet. Sa i takon Diaspores se shqipërisë ne sh.b.a ajo do te perfaqesohet se paku me 3 deputet, ne Parlamentin e erdhshem te Shqipërisë, zgjelljet e te cilit do te mbahen ne mesin e vitit 2017.

Sa i takon numerit te pergjithshem nga te gjitha vendet te marra se bashku burimi ne fjalt sqaron per gazetën Malesia se do te jene gjithsejt 11 persona ,ose 11 vende ne Parlament

qe do tu lihen perfaqesueseve te shtetaseve te shqipërisë ne te gjithe boten. Gjithsesi gjithcka pritet te marr forme ne muajin Nentore te ketij viti kohe kur ne Tirane do te mbahet Samiti i Diaspores, samit i cili do te mbahet menjeher pas zgjelljeve ne SH.B.A kohe kur do te sqarohen edhe shume gjera te tjera, se kush do jene aleatet e ardhshem te SH.B.A-ve, nese ata do te jen Qeverisesit aktual apo, Opozitaret e tanishem.

Vasel Gilaj New York



# Si u formua krahina Malësi e Madhe?

As. prof. dr. Kahreman Ulqini

**M**alësia e Madhe gjate shek. XV-XVII shtrihej brenda ketyre kufive natyrore. Prroni i Thate, Mali i Kurriles, Qafa e Thanës, Bjeshket e Nemuna, malet Kom e Vizitor, lumenjet Zeta, Moraca te bashkuar me Zeten, deri ne derdhje te liqenit te Shkodres. Kjo krahine ne mesjeten paraosmane perputhej pak a shume ne shtrirje me njesin administrative Zeta e Siperme. Nga fundi i shek. XIV fillimi i shek. XV njohim nepermjet doku-

menteve te kohes, disa bashkesi fisnore ne Malesin e Madhe. Si Fiset Tuz, Hot, Bythdose, e tjer te nxitur nga Venediku, ata ngriten krye kunder Balshes se Tretepor, meqe nuk e perballuan forcen e tij, u detyruan ti braktisin viset e veta e te strehijeshin brenda kufive te Sinjorise ne komunen e Shkodres. Tuzet, te udhehequr nga kreu Junk Tuzi, me 1403 formuan vendbanimin e ri me emeri Tuz, i cili perbehej prej 150 shtepish, dhe perfshinte zonen nga Gradeci e Pjetroshani deri ne breg te liqenit te Buze Ujit. Sipas marrveshjeve

te viteve 1403 e 1416 tuzet do te nxirrnin 500 luftetare kalores e kembesore, sa here qe Republika e Venedikut do ti kerkonte. Nga fundi i shek. XVI. Organizata fisnore e tuzeve ishte shperbere. Ne vendin e preardhjes mbijetoi fisi. Me 1455 tuzet marrin pjese ne Kuvendin e Zetes krahas bashkesive te tjera te Malesise. Ne rregjisterimin osman te vitit 1497 permenden tuzet e siperm. Zanafillen e ketij fisi studiuesit e marrin tek Llesh Tuzi banor i katundit te shqiptareve 1330. Mirpo antroponomi Tuz ne kete krahin figuron ne dokumentet e

viteve 1222deri ne vitin 1228.

Me 1414 Andrea Hoti me krene te fisit perfunduan kete marrveshje me autoritete venedikase, ata do te qenderonin shtetas besnike, do te ruanin paqen, do te luftonin me ate qe ishin ne gjendje lufte Republika, do te jepni 300 luftetare, ne mese te cileve 80 ishin Kalores. Ne anen tjetër siguronin privilegje e prona toksore ne fushen e Mbishkodres dhe u falen nga cemtinet e ngarkuara me pare. Me vdekjen e Balshes se trete me 1421 Hotet u kthyen ne trojet e veta, Edhe fisi Bythdose e Matagushe me 1417 iu nenshtruan Venedikaseve. Malesia e Madhe, duke qen ne skaj te truallit shqiptar, u godit heret nga vala e serbizimit. Pa perjashtuar edhe faktor te tjere, kryesore ishte qenia e saje gjysem ortodokse e lidhur me kishen serbe. Ne mes Malesoreve Katolike e Ortodokse u nderprene marrdheniet martesore tradicionale. Malesoret ortodokse benin krushqi kryesishte me Malazezet. Gruaja futi ne shtepi gjuhen e huaj. Lale Drekali, udheheqesi i Kucit ne shek XVII e ndaun gruan e tij shqiptare katolike dhe u martua me nje Malazeze. Sipas Erdeljanoviqit e Rashoviqit iu cel rruga serbizimit te Kucit sepse shembullin e Drekalit e ndoqen edhe shume te tjere. Gojedhenat Malazeze tregojne se me ane te martesave u seerbizuan Bratonishiqet, Nikiqet, e Pejoviqet ne Llazorce, Bubiqet e tjer. Faktorit fetar i duhet shtuar edhe ai politiko-administrative. Ne kushtet e sundimit osman malesoret ortodokse doradores u bashkuan me Malin e Zi, jo aq nga joshja fetare por per te gezuar pavarresi me te madhe. Gjate shek XVIII-fillimi shek. XIX procesi i sebizimit perfundoje ne Vasoviq, Piper, Palbardhe, Bratonisq, Kuc e tjer, kjo popullsi megjithse e serbizuar nuk e njohu veten per Malazeze, vazhdoi te perdorte emerin Malesi e malesore, pore tashme te perkthyer ne serbishte Brida e Brigjani emeri Berda se pari duket ne dokumentet venedikase te vitit 1687. Serbizimi i plote ne Berde perfundoi ne kuadrin e shtetit modern malazet me ane te dhunes e vrasjeve te malesoreve katolik e atyre ortodokse te panenshtruar. Me 1856 Mirkoja vellai i Princit, hyri me forca te medha ne fshatin Kosor te Kucit banoret e te cilit ishin malesore shqiptare ortodokse, ku preu kokat e femijeve ne djep. Gjate viteve 1877-1878

malazezet pushtuan bajraket Rahoje, Triesh, Koje, e Fundena, e fshaterat e Kucit te Poshtem dhe fushen e Zetes. Disa vite me vone E. Durham do te shkruante se pashe nje serbizim te vrazhde ne proces. Veshja shqiptare u ndalua dhe mbajtja e kapices malazeze ishte e detyrueshme. Kufite politik te Malesise se Madhe ndryshuan perseri me vone, duke e ngushtuar krahinen. Ne Konferencen e Ambasadorëve te Fuqive te Medha, ne Londer 1913, Tuzi, Gruda dhe pjesa me e madhe e Hotit iu dhane padrejtesisht Malit te Zi. Nga fundi i shek. XVIII Malesia e Madhe njohu bajrakun, si lidhje bashkesishte te organizimit te vjeter shoqerore. ishin keta bajraktare, ne Hot, Rapsha e Traboini. ne Grude Dinosh e Ksheva, ne Kelmend Selca, Vukli, Nikci, e Boga, Kastrat, Shkrel, Triesh, Tuz, Koje, Fundena, Rahoje, Medun, Ubli, Kosor, Kividol, e Momce. Bajraktaret grupoheshin ne male, ne krye te te cileve emeroheshin Bylykbashe. Si male u trajtuan Hoti, Gruda, Kelmendi, SHkreli, Tuzi, dhe Trieshi, Fundena e Koja se bashku. Numeri i bajraktareve ka ndryshuar kohe pase kohe. Ne cerekun e pare te shek. XIX Kelmendi qe nje bajrak me vone u nda ne tre bajrake Selce, Vukel, dhe Nikc qe nga viti 1860 iu shtua edhe Boga. Pase vitit 1870 Kastrati e Shkreli u ndane si bajrake me vete. edhe bajraket e Malesise se Madhe administroheshin nga komisioni i Xhibalit me qender ne Shkoder. Malesia e Madhe eshte konsideruar si vendi i fiseve te medha sic jane ato Hot, Kelmend, Bakeq, Kastrat, Shkrel, Sumaj, Drekal, Kuci i vjeter, Palbardhi, Piper, Vasoviq, Bratonishiq, te serbizuar e tjer. Me gjithë kete gjenden edhe disa fise te vegjel, si Gashaj, Bekaj, Delaj, Boin, Anasit, e Hotit Jeran e tjer. Sipas gojdhenes popullore disa nga fiset e medha qe kemi permendur jane dege te nje fisi. Hot e Bakeq ne Malesi te Madhe. Piper e Vasoviq ne Berde dhe Krasniqe duke perfeshire edhe Nikajt ne Malesi te Gjakoves qe u themeluan nga pese vellezer perkatesisht Lazri, Bani, Pipri, Vojsava e Krasi bije te Keqit. Palbardhet ne Berde dhe te Bardhet ne Malesi te Gjakoves jan pasardhes nga axhe e nip, Bardhi e Pali. Shkreli e Bytyci jane dege te nje fisi. Sipas zanafilles i pari i Kelmendit, Ahmati qe e ka varrin ne Bshtan, i pari i Kastratit, Dedli qe e ka varrin tek shpella



e Bagtive, Keqi i pari i Hotit qe e ka varrin ne Rapshe, dhe Drekali. qe e ka varrin ne Rikavec kane ardhur nga viset perreth maleve Durmitor e Vizitor, i pari i Shkrelit dhe ai i Palbardhit kane ardhur nga Kosova. Fiset Sumaj, Berishaj, Gashaj, Boin, jane vendas, Jerani eshte nip bije i Detlit Kastrat. Fisi me i madhe i Malesise se Madhe eshte Kelmendi qe shtrihet edhe ne Koje, Gjlobalajt e bajrakut te Vuthajve, ne Rugove nje shumic e banoreve te sllavizuar ne Berane, Rozhaje, Ceklinet, Dajkoviqet, Gornjaket, ne Berde e tjer jane Kelmendas, Me 1700 Hyda Verdi Pashe Begolli shpernguli me force 254 shtepi Kelmend, me se shumti te vllaznise Nikc e me pak Vukel, dhe i vendosi ne Pshter, shumica e te cileve sote jane te sllavizuar. Fise historikishte te shuara jane Matagushtet, Lopet, Spanet, Bythduset, Kakarriqet, Tuzet, Bukmiret, Qimekuqet, Bushatet, e tjer Malesia e Madhe eshte krahine etnografishte e vjeter e percaktuar nga ana gjeografike, banoret e se ciles ruajne vecori e dallohen nga krahinat perreth, Krahina

thirret Malesi e Madhe. Edhe pse jane Male me ate emer nuk thirren Dukagjini, Puka, Mirdita e tjer Banoret e Malesise se Madhe dhe ata te Malesise se Gjakoves e quanin veten Malesore. Askush tjetër ne Shqiperi te Veriut nuk njihet me emerin Malesor. Malesise se Madhe si nga ana Gjeografike dhe etnografike i perkasin edhe Rranxat e Myslimanizuara ose Rranxat e Malesise dhe qe jane Bajraket Rec, Lohe, Rrjoll, Koplik, Grizhe , Buze e Ujit e tjer. Pavarresishte nga fakti i shkeputjes me dhune i disa viseve te Malesise se Madhe 140 vjet me pare e disa te tjerave me vone me 1913 si dhe i nderprerjes edhe te marrdhenieve familjare Malesoret kurrsesi nuk u shkombetarizuan dhe u perpoqen ta ruajne sa ma shume kete race te rradhe shqiptare, e sa me te paster c ka do te thote se qe te ruhet edhe me tej, si e tille eshte detyre urgjente rilidhja dhe lidhja e martesave ne Mese Malesoreve ne te dy anet e kufirit si dhe kudo ku ata ndollen.



**Na ndiqni në:**

**[www.gazetamalesia.com](http://www.gazetamalesia.com)**

- Ne nuk ju premtojmë lajmin e fundit, por atë që juve ju intereson më shumë.
- Ne nuk konkurojmë me askënd, por cilësia dhe përzgjedhja na dallojnë nga të tjerët.
- Tek ne, secili nga ju ka diçka për të lexuar dhe një mundësi për të treguar.



# Pse e sulmuan malësorët Shkodrën në vitin 1912?!

ANALIZE



Nga Vasel GILAJ  
New York



**P**ase kryengjeritjes anti-turke ose anti-otomane te vitit 1911, e cila kulmoi me ngritjen e flamurit tone kombetar. Ose i pari pase atij te Gjergj Kastriotit. Malesoret e Malesise se Madhe dhe ne vecanti ata te besimit historik- katolik. dhe qe me se shumti e kishin pesuar nga pushtuesi 5 shekullor. Turke, dhe qe po me se shumti edhe e kishin luftuare, ishin bere nje faktore shume i rendesishem tashme edhe ne range kombetar. Te cilet ne nje fare menyre funksiononin, dhe sa here qe ishte nevoja edhe si nje ushtri e rregullt, kuptohet me kushtet dhe mundesit qe u ofronte koha ne te cilen ata jetonin.

Mirpo c fare ndolli vetem nje vite me vonë dhe pase ngjarjes me te lavdishme, te Malesoreve te Malesise se Madhe, te cilet vetem ne pranveren e vitit 1911 i llane lirise dhe pamvaresise se shqiperise 259, te vrare dhe

qindera malesor te tjere te plagosur. Vjeshta e vitit 1912 Cuditerishte Malesoret dhe ne vecanti ata te besimit katolik, dhe qe jetonin me se shumti ne trojet shqiptare te pushtuara nga Mali i Zi, i gjen perkrah ushtrise, Malazeze e cila kishte marre vendimin per te sulmuare, rrethuar, e pushtuar Shkodren. Dhe qe realishte ndolli dhe jo pake por per 6 muaj me rralle. Qytet dhe qender te cilen Kraill Nikolla i Malit te Zi e dinte shume mire se nuk munde ta pushtonte pa ndihmen e Malesoreve, pasi per te hyre ne Shkoder me pare dhe konkretishte nga Mali i Zi duhet te kaloshe nepermjet Malesise se Madhe.

Kraill Nikolla kishte vendosur dhe me ndihmen e jo pake vendeve europiane, sic ishin Rusia, Franca, Serbia e tjer qe Shkodren ta benin kryeqytetin e Mali te Zi, perpara vendosjes perfundimtare te kufive te vitit

1913, prandaj gjithcka ndolle ne vjeshten e vitit 1912, dhe qe do te thot se nese shkodra gjendet e pushtuar ateher do ti jepej Mali te Zi.

Po pse u bashkuan malesoret katolik me malin e zi ose ushterin Serbo-Malazeze, eshte kjo nje pyetje qe historia e bene prej mese 100 e sa vitesh, dhe qe realishte nuk e sqarone sepse asaj i mungojne gjykatesit e veretete, dhe qe jan Historianet. Edhe pse realishte jane thene shume te verteta dhe te pa verteta lillur me kete ngjarje, dhe qe eshte me e pa lavdishmja persa u takon Malesoreve te Malesise se Madhe te cilet Kraill Nikolla arriti ti mashtrorj me grada arme e para, duke u thene se ejani me ne te luftojme Turkun se u jap c ka te doni, dhe Malesoret kete e besuan dhe me se shumti ber besimin fetar, dhe realishte jo per ate Shqiptetar.

Dhe kjo realisht ndolli dhe Malesoret Katolik jo vetem se nuk ia ben bam pore u bashkuan me ushtrin Serbo-Malazeze, duke e rrethuar Shkodren dhe banoret e saja me se shumti te besimit Mysliman per jo me pak se 6 Muaj me rradhe.

Gjithsesi, te dhenat e ndryshme historike duan edhe ndonje sqarim po historik dhe konkret, per shembull sic jan te llenat dhe deklarimet,

se sa ishte numeri i malesoreve qe muar-en pjese ne rrethimin e shkodres perkra-h ushtrise Malazeze e me vone te ndihmuar edhe nga ajo Serbe.

Ka nga ata historian qe thone se perkra-h malazezeve ishin 10,000 Malesore te besim-it katolik, pasi myslimanet perfshi edhe ata te shkodres perkrahin perandorin Turke, e kundreshtaret vinin nga trojet shqiptare nen malin e zi, por jo pake te perkrashur edhe nga malesoret e tjer katolik te shqiperise, deri edhe ne nen shkoder e Le-zhe. Realishte nese i referohesh kohes, dhe numerit te popullsesise po te asaj kohe keto shifra te duken nje numer i egzagjeruar, e per me teper kure ka te dhena te tjera qe thone se ne rrethimin Malazezo-Malesore te shkodres dhe konkretishte ne Tetor te vitit 1912, kan marre pjese 3000 Malesore Katolik, nderkohe qe ka te tjer qe thone se kan qene 1973

Malesore qe rrethuan shkodren, duhet permendur fakti se si shume si pake, kjo ka ndollur, edhe nje fakt tjeter eshte se Kleri katolik se bashku me Malesoret kan kerkuar qe lufta per mbrojtjen e shkodres duhej zhvilluar, nen flamurin kombetar shqiptare. gje qe perandoria osmane nuk e kishte lejuar, duke i detyruar banoret mysliman te Qytetit te Shkodres dhe te rrethinave qe te luftonin per mberojtjen e qytetit ndaj Malazezeve e Malesoreve me Flamurin dhe kapalen e qeleshen me ylle e hane oso simbolin turk.

E aqe me teper dhe jo per te mbrojtur Malesoret Katolik te Malesise se Madhe te cilet shenuan me kete raste prap e them nje pjes te erret te historise se tyre gjithsesi te lavdishme qofshin te shqiperise ose ne malin zi, kjo mund te kete ardhur edhe si nje hakmarrje, sepse ne pranveren e vitit 1911, kur Malesoret filluan kryengritjen anti-turke, Bedri Pasha ka derguar nga shkodra ne drejtim te Malesise se Madhe dhe konkretishte ne Tuze nepermjet

liqenit te shkodres 1000 ushtare te cilet me se shumti ishin mysliman shkodran dhe te zonave per-rreth qe te sulmonin dhe asgjesonin malesoret Kaurra qe po luftonin Perandorin.

Sido qofte dhe sido qe ka ndollur eshte e vertete se malesoret vellezerit e tyre, shqiptar arriten qe ti zene rober dhe asnje prej tyre nuk e kane vrare, biles ka patur nga ata qe edhe i jan bashkuar kryengritjes anti-turke edhe pse tashme ishin kthyer ne besimin amaysliman.

Ajo qe duhet ven ne dukje dhe sqaruar me se shumti, eshte fakti se shqiptare realishte luftuan kunder njeri-tjetrit. dhe ku ase njeri nga palet muk se pse dhe me c ka te mburret, se per c fare luftoj pervecse mashtrimit dhe besimit fetare, dhe qe do te thote se nese myslimanet thone se mbrojtjen qytet-in, donin ti ia linin ne dore pushtuesit 500 vjecar turke, ashtu sic edhe malesoret donin qe shkodren ti a jepnin nje pushtuesi tjeter sic eshte ai Malazez, me kete raste dhe shume tragjik historik te lindin edhe disa pyetje jo pake interresante sic jane se perse Ismail Qemali e shpalli pavaresin e

shqiperise ne vlore me 28 nentore te vitit 1912, kure shkodra, ose ishe kryeqendera e Ilirise ishte e rrethuar dhe e pushtuare nga Malazezet, pse u zgjoll Luigj Gurakuqi, per te shkuar ne vlore dhe jo Ded Gjon Luli. meqenese flamuri ishte ngritur me 1911 ne Malesin e Madhe, ku ishin aso kohe figurat me te njohura te Malesise se Madhe dhe shkodres perpara te cileve dhe jo rralle verberishte ne betohemi dhe perulemi, ku ishin kleriket qofte te besimit katolik apo atij mysliman, ku ishin ata per te cilet ne themi se vendosen kufijte e shqiperise dhe malesise duke e ndare ate dhe per ke dhe ne fafor te kujte punuan, veprime qe kom-bi shqiptare zor se ka per ti rikuperuare ndojeher, personalitete qe politika aktuale shqiptare e dites i dekoron edhe me urdherin tashme te dalur boje nderi i kombit. Sido qe ka ndollur eshte e vertete se shko-dra shpetoj dhe i mbeti shqiperise por Malesia e Madhe u nda dhe jo pake per faje te vete Malesoreve te cilet kure po vendoseshin kufite dhe fatet e kombit jo pake prej tyre u gjeten perkrahe Ushtrive Serbo-Malazeze.





Nga Blendi Fevziu

# Rrethimi malazez i Shkodrës, mbrojtja 183-ditore e qytetit dhe kapitullimi

**N**je nga ngjarjet me te bujshme te historise shqiptare te Shekullit te XX. Mbrojtja 183 ditore e Shkodres dhe jehona e saj. Qendresa e Hasan Riza Pashes dhe vrasja e tij. Roli i Esat Pashe Toptanit ne vrasjen e komandantit turk, ne mbrojtjen e qytetit dhe me pas ne dorezimin e tij. Marreveshja me Malazezet dhe vendimi i Londres. Adjutanti i gjeneral Hasan Riza Pashes, trokiti ne deren e eprorit te tij pa zbardhur ende mengjesi i dates 8 tetor 1912. Komandanti (dhe njekohe-sisht Valiu i qytetit) ishte ende i pergjumur, kur degjoi lajmin qe e priste prej kohe: Mali i Zi i shpalli lufte Turqise dhe trupat e tij sapo kaluan kufirin mes dy shteteve. Pashai nuk kishte nevojte per me shume shpjegime. Dy ore me pas, ai u njoftua se trupat Malazeze, ashtu sic pritej, qene drejtuar per ne Shkoder. Komanda turke e dinte prej kohesh se ne rremujen e Luftes Ballkanike, trupat e principates se vogel ne veri te Shqiperise kishin vetem nje mision: te nenshtronin qytetin e lashte shqiptar. Agimi sapo kishte filluar te zbardhte mbi kalane e Rozafes, kur ai urdheroi levizjen e trupave ushtarake per ne rrethinat e fortifikuara te qytetit. Fortifikata te ndertuara me ngut vitin e fundit dhe qe, tashme, ash-

tu sic pritej, ishin gati te perballeshin me zjarrin e luftes. Ne mesdite gjithcka ishte gati. Me shtabin e tij, Hasan Riza Pasha, komandanti turk i qytetit, qe vendosur ne Bardhanjore dhe po ate mbasdite mblodhi te gjithe komandantet e tij. "Qyteti do te rrethohet se shpejti, - iu tha ai atyre - por ky qytet nuk do te bjere ne doren e malazezeve. Shkodra eshte fati yne ose varri yne, por jo turpi yne. Sot kemi 5 mije trupa ushtarake, por mbi 20 mije te tjere jane duke ardhur ne ndihmen tone. Qe sot fillon nje beteje e veshtire, qe asnje nga ne, nuk e di se sa do te zgjase".

## Rrethimi i Shkodres

Ne te vertete, as Hasan Riza Pasha dhe askush tjeter nuk mund ta parashikonte ate mbasdite te dates 8 tetor 1912 se, Rrethimi i Shkodres do te zgjaste me shume se 183 dite dhe se beteja per te do te be-

hej nje nga me te famshmet ne Evropen e kohes. Te rejat e saj zinin vend rregullisht ne te gjitha gazetate me te medha perendimore, ndersa Hasan Riza Pasha, Esat Pashe Toptani apo Princ Danilo i Malit te Zi, u bene figura te njohura. Se paku, 15 libra jane botuar ne gjuhe te ndryshme per ate rrethim, ndersa Harta e Mbrojtjes se Qytetit, se bashku me shenimet e Hasan Riza Pashes, eshte ende sot e ekspozuar ne nje mur te shkolles ushtarake ne Gjeneve te Zvicres. Ne fillim te vitit 1914, gjate nje vizite ne Viene, Esat Pashe Toptani u prit me nderime si Komandant i Mbrojtjes se Shkodres dhe nje mbremje, pothuaj gjithe oficeret e larte austriake, te prire nga princi trashgimtar Franc Ferdinand, u ulen perballe nje table, ne te cilen ai u perpoq te sqaronte strategjine e mbrojtjes. Edhe pse dihet mire tashme se mbrojtja e

qytetit i dedikohet komandantit turk dhe se vrasja e tij, ne mes te rrethimit, ishte, sipas te gjitha gjasave, veper e Esat Pashes. Por te gjitha keto erdhen me vone. I ulur ne shtabin e tij ne Bardhanjore, Hasan Riza Pasha nuk e dinte se cili do te ishte fati i qytetit mesditen e 11 tetorit 1912. Ate mengjes, nga te gjitha trupat e pritura, vetem 10 mije vullnetare te Shqiperise se Mesme, te prire nga gjeneral Esat Pashe Toptani, kishin arritur te hynin ne qytet. Mbi 2 mije matjane, te drejtuar nga djaloshi i ri 17 vjecar Ahmet bej Zogu, ishin shpartalluar nga Serbet ne Lezhe, ndersa trupat ushtarake turke, te drejtuara nga gjeneral Mahmut Hajret Pashe Jella, qe gjendeshin ne Berat, u gozhduan ne fushen e Myzeqese nga sulmi i perbashket serbo - bullgar. Ai nuk priste me ndihma te tjera dhe me 15 mije luftetare i duhej te perballonte nje rrethim te ashper prej me shume se 25 mije malazezesh dhe nje fuqi ndihmese prej gati 30 mije serbesh, qe shume shpejt do te bashkohej me ta.

Topat malazeze filluan te hedhin gjylet e para ne qytet mengjesin e 11 tetorit dhe, per me shume se gjashte muaj, bombardimet u bene pjese e perditshme e jetes se qytetit. Por duket se ata qe sulmonin, e kishin vene re se qyteti ishte i fortifikuar mire dhe se ai drejtohej nga nje gjeneral, qe

ishte, padyshim, nje nder me te shquarit e ushtrise turke. Situata ne rajon nuk ishte aspak e favorshme ne fillimet e rrethimit, kurse ajo brenda qytetit akoma me keq. Trupat e Fuqive Ballkanike kishin futur ne dare trupat turke dhe forcat e kesaj te fundit po pesonin humbje pothuaj ne gjithe frontin.

Ideja, se Turqia po sfilitej nga problemet e brendshme dhe se nuk do t'i mbronte dot zoterimet e saj ne Ballkan, u duk qarte. Me idene e faktit te kryer, Fuqite Ballkanike, te ndihmuara edhe nga diplomacia ruse, vendosen te pushtojne sa me shume terriore te mundshme, me idene qe Konferenca e Ambasadoreve, qe pritej te mblidhej ne dhjetor, te vendoste shtrirjen e kufijve te tyre ne gjithe tokat, qe kishin nen kontroll. Pushtimi i Shkodres u be nje domosdoshmeri per ushtrite malazeze dhe Rrethimi i tyre me i ashper. Nje muaj pas vendosjes se Rrethimit, situata ne qytet nuk ishte aspak e favorshme dhe mungesat po beheshin gjithnje e me te ndjeshme. Vete Knjaz Nikolla, princi i Malit te Zi ishte vendosur ne fushimin e trupave te tij per t'i dhene zemer ushtrise, qe drejtohej nga princi Danilo. Thyerja e trupave turke dhe armepushimi qe pasoi ne muajin dhjetor, u kishte dhene mundesi serbeve qe mbi 30 mije trupa te tyre, t'i dergonin ne perforcim



**HASAN RIZA PASHA**

te trupave malazeze. Po ne kete kohe, me nje telegram direkt, ministri turk i Luftes urdheronte Hasan Riza Pashen, komandantin e qytetit, qe lufta kishte mbaruar dhe se ai duhej te dorezonte qytetin tek malazezet. Telegrami shoqerohej nga nje leter e Princit Danilo, sipas se ciles, nese Hasan Riza Pasha nuk i bindej urdhrin, ai konsiderohej dezertor dhe denohej me vdekje se bashku me shtabin e tij.

Pergjigjia e Komandantit te qytetit erdhi me 24 dhjetor, ku ai shprehte bindjen e gjithe popullates qe kishte ne ngarkim: Si popullsia myslimane edhe ajo katolike e qytetit ishin kunder dorezimit dhe insistonin qe qyteti te vazhdonte te mbrohej. Ne pergjigje te letres se princit Danilo ishte edhe nje mesazh i Kryetarit te Bashkise se Shkodres, Muharrem Gjylbegut, i cili



i lutej sulmuesve qe te mos bombardonin spitalet, qendrat e femijeve, kishat, xhamiat, konsullatat dhe qendren, ku ishin vendosur gazetaret e huaj. Po ne ate leter, Gjylbegu u kerkonte trupave rrethuese, qe te lejonin hyrjen ne qytet te ilaceve per te plagosurit, si dhe te ushqimeve per diplomatet dhe per 13 gazetaret e huaj.

Qyteti vazhdonte te qendronte, por dukej qarte se telegrami i Ministrit te Mbrojtjes e kishte vene ne veshtiresi Hasan Riza Pashen. I bindur se qendresa ne qytet duhej te kishte nje flamur, ai hyri ne tratativa me Austro - Hungarine. Por, po ate dite, Komandanti mori nje tjetër mesazh: Alush Lohja, nje burrë nga paria e qytetit e lajmeronte se Qeveria Shqiptare, qe kishte shpallur Pavaresine ne Vlore, qe njohur nga Fuqite e Medha dhe se mbrojtja e metejshme e qytetit mund te behej nen flamurin shqiptar. Sipas Lohjes, ne kete menyre mund te motivoheshin edhe malesoret e Mirdites per te marshuar ne ndihme te qytetit te rrethuar. Ideja e Lohjes duket se i pelqeu Komandantit dhe, po ate dite, mori aprovimin edhe nga shtabi i tij. Hasan Riza Pasha u njoftua se Kryeministri Shqiptar, Ismail Qemali, nje i njohur i vjeter i tij, ishte ne dijeni te zhvillimeve ne Shkoder dhe se nje korrier, i quajtur Mark Dubashi, i dergonte atij rregullisht mesazhet e Arqipeshkvit te qytetit, Jak Sereqi. Naten e 31 dhjetorit, Hasan Riza Pasha, mori nje mesazh te drejteperdrejte edhe nga Kryeministri Shqiptar, qe e sqaronte se rezistenca ne Shkoder ishte jetike per te ardhmen e qytetit dhe e ftonte qe ta mbronte kete nen flamurin shqiptar.

Mbrojtja e qytetit ishte bere nderkohe e famshme ne Evrope. Nje korrespondent i gazetes angleze "Times", i quajtur H. Nevinson, botonte cdo jave nga nje artikull dhe, bashke me raportimet e kolegeve te tjere, mbrojtja e qytetit beri buje ne Perendim. Per me teper, Evropa u sensibilizua nga njoftimet mbi bombardimet e bera ndaj popullsisë civile dhe trupit diplomatik ne Shkoder. Per te verifikuar raportet e gazetave dhe ato te konsujve te huaj atje, Konferenca e Ambasadoreve dergoi ne qytet nje mision te kryesuar nga atasheu ushtarak austriak ne Cetinje, kapiteni Hubka. Hubka, qe u takua direkt me Hasan Riza Pashen dhe nen-komandantin Esat Pashe Toptanin, e kuptoi se qyteti po i afrohej pragut te urise dhe se mbi te qene hedhur bomba pa meshire. Por, Hubka kreu edhe nje mision te rendesishem politik: Jak Sereqi, arkipeshkvi i qytetit kishte rene dakort me Hasan Riza Pashen dhe Alush Lohjen, qe te ndihmonte ne mobilizimin e malesoreve katolike ne ndihme te qytetit, me kusht qe, ne te ngrihej flamuri shqiptar dhe qe per kete aksion te binte dakort Austro - Hungaria. Hubka e siguroi per kete, por ai shtoi, se nuk besonte qe qyteti mund te rezistonte me shume se 5 - 6 dite, kohe e pamjaftueshme per te mobilizuar malesoret. Fatmiresisht, qyteti rezistoi edhe kater muaj. Aprovimi i Austro - Hungarise mobilizoi edhe me shume popullsinë katolike te qytetit. Gjeneral Hasan Riza Pasha, Imzot Sereqi, Alush Lohja dhe Esat Pasha, rane dakort t'u dergonin malesoreve, permes Kuvendit te Rubikut, dy mesazhe per ndihme. Mesazhet, qe shoqeroheshin



ESAT PASH TOPTANI

edhe nga garancite e Imzot Sereqit dhe ato te Austro - Hungarise, i udhezoni malesoret katolike, qe te sulmonin nga pas trupat malazeze, me te pare qe ne Kalane e Shkodres eshte ngritur flamuri shqiptar. Ky takim, qe deshmohej nga shume historiane dhe shume vete, qe kane qene ne dijeni te zhvillimeve ne Shkoder, duhet te jete zhvilluar diku ne muajin Janar. Ne ate kohe, situata ne qytet ishte renduar dhe ushqimet, megjithe racionimin e forte, nuk gjendeshin me. Kesaj i duhej shtuar fakti, qe pjesa me e madhe e qytetit ishte bere germadhe nga bombardimet dhe ne spitale nuk kishte me vend per te plago-



surit-shumica e te cileve ishin nga popullsia civile. Po keshtu, trupat mbrojtese kishin shume humbje nga rradhet e tyre, edhe pse tregimet e kohes deshmojne se edhe malazezet kishin shume te vrare. Ne qytet kishte filluar te qarkullonte ideja e dorezimit, ide qe sidoqofte nuk thuhej me ze te larte.

## Vrasja e Hasan Riza Pashes

Pas takimit midis krereve te qytetit, Imzot Sereqi mori persiper te lajmeroje abatin e Rubikut dhe te sjelle menjehere nje pergjigje nga ai. Pergjigjia ishte parashikuar ne fund te muajit Janar dhe mberriti vertet ne daten 30 te po atij muaji. Ate dite, komandanti i qytetit kishte shkuar per inspektim ne rrethinat e qytetit dhe vetem mbasdite vone u kthye ne shtepi. Vila ku banonte komandanti ishte vetem 150 metra me larg asaj, ku ishte vendosur Esat Pashe Toptani dhe midis te dyjave qendronin roje disa vullnetare shqiptare te Shqiperise se Mesme. Hasan Riza Pasha u njoftua se lajmesi kishte mberritur ne shtepine e Esat Pashes dhe se e priste atje. Ai nuk u vonua. I vetem, pa roje dhe pa adjutant, u nis per ne shtepine perballe. Duhet te kete ndenjtur atje jo shume kohe dhe, rreth ores 18.45, doli per t'u kthyer ne shtepi. Esat Pasha e perculli deri ne deren e jashtme dhe nje sherbetor i tij ecte perpara per t'i ndricuar rrugen me fener. Gjenerali nuk kishte bere as 50 metra, kur tre krisma njera pas tjetres prishen qetesine e nates. Rojet



dhe oficeret, qe dolen me vrull nga te dyja shtepite, e gjeten komandantin te shtrire ne rruge dhe te mbytur ne gjak. Hasan Riza Pasha kishte marre tre plumba pushke ne shpine dhe dha shpirt disa ore me vone. Perpara vdekjes, i kerkoi Esat Pashes qe te kujdesej per t'ja derguar familjen pas lufte ne Stamboll, ndersa oficerëve te tij, te grumbulluar perreth shtratit, iu kerkoi qe te mos e dorezojne qytetin ne asnje menyre. Gjenerali u varros te nesermen ne Xhamine e Parruces, ne prani te popullsise se gjithe Shkodres se rrethuar.

Deri me sot, askush nuk ka ditur te flase me siguri per vrasjen e Komandantit te qytetit, por pothuajse te gjithe kronistet e asaj kohe, ata qe kane shkruajtur ku-

jttime, si dhe historianet e mevonshem bashkohen ne nje pike: vrasja u krye nga Osman Bali, nje njeri i afert i Esat Pashë Toptanit, me urdherin direkt te Esatit. Bashke me Balin, kane qelluar edhe nje kavajas i quajtur Mahmut dhe nje shijakas i quajtur Tofik. Sipas te gjithe shenimeve te mevonshme, vrasja e Hasan Riza Pashes u be, pasi ky i fundit kerkonte te ngrinte flamurin shqiptar dhe se shtabi xhonturk ne qytet nuk ishte dakort per kete. Xhonturqit bashkepunuan me Esat Pashen, ndersa ky i fundit pranoi, i tunduar nga fakti, qe pas vrasjes se Hasan Riza Pashes, komanda e qytetit t'i mbetej atij. Sic u pa me vone, Esat Pasha kishte synuar te hynte ne marreveshje me malazezet per hir te interesave te tij. Esat Pasha asnjehere nuk e ka pranuar kete vrasje. Ai akuzoi menjehere, pas kesaj, nje malesor nga Shoshi, te quajtur Ndoc Deda, i cili, sipas tij, ishte paguar nga malazezet. Kujtimi i Hasan Riza Pashes duket se eshte ruajtur per shume kohe ne qytetin fisnik Verior. Ne nje nga botimet me serioze mbi historine e qytetit, bere nga Hamdi Bushati dhe titulluar, "Shkodra dhe motet", Gjenerali pershkruhet keshtu: "Shkodra ruan kujtimet me te mira per Hasan Riza Pashen, i cili per fisnikerine, shpirtmadhesine, e dhimbshurine qe tregoi per popullin e vuajtun shkodran, sidomos ne periudhen e lufte, mbetet i paharruem".

## Tratativat diplomatike dhe dorezimi i qytetit

Qendresa e Shkodres, mbarimi i lufte dhe Konferenca e Ambasadoreve filluan te krijojne nje situatë aspak te favorshme



per ushtrite malazeze. Duke e kuptuar se situata ecte kunder tyre, malazet shtuan sulmet dhe bombardimet, me idene per te nenshtruar qytetin dhe per ta bere ate te tyrin, perpara se te fillonte diskutimi per kufijte veriore. Kunder vullnetit rus, Konferenca e Ambasadoreve kishte njohur pavaresine e Shqiperise, por kishte bere " korrigjime" te frikshme te kufijve te saj ne favor te Serbise, Malit te Zi dhe Greqise. Shkodra ishte parashikuar ne zonen Malazeze, por pak kohe me vone, Austro - Hungaria dhe Italia, u kujtuan se ajo ishte qendra e katolicizmit shqiptar. Si pasoje, bashke me ndihmen e Anglise, ato vendosen qe qyteti t'i mbetet Shqiperise. Vete Cari i dergoi nje telegram Knjaz Nikolles te Malit te Zi dhe Mbretit te Serbise, ne te cilin i sqaronte per vendimin dhe per pamundesine e Rusise per te kundershtuar kete vendim. Menjehere pas ketij vendimi, trupat serbe u terhoqen nga rrethimi i Shkodres, ndersa Mali i Zi nuk pranoi. Ne pergjigje te kesaj, parlamenti britanik zhvilloi nje seance diskutimi per rrethimin e Shkodres dhe Ministri i jashtem Grey, u thirr per te dhene shpjegime. Grei mbajti nje fjalim te hapur, por edhe shume cinik. "Ne e dime, tha ai, se pas ca kohesh femijet tane do ta shohin te gjithen kete, si nje padrejtesi te madhe. Do te cuditen qe toka

te banuara kryesisht prej shqiptarësh ose krejtesisht prej shqiptarësh i janë dhënë fqinjëve të tyre. Kjo është e padrejtë, por ata do të kuptojnë se ekuilibri i Fuqive të Medha nuk mund të prishej për një vend të quajtur Shqiperi". Grei nuk harroi të sqarojë, se lufta që Mali i Zi po bënte në Shkodër nuk ishte me një luftë çlirimtare, por një luftë e mirefillte pushtuese. Ai shtoi se kundër kësaj janë gjithë Fuqitë e Medha. Për t'i bërë presion Malit të Zi që të heqë rrethimin, disa luftanije austro - hungareze të shoqëruara nga anije italiane, angleze dhe franceze manifestuan në ujrat e Adriatikut, përballë Tivarit. Siç kishin bërë 40 vjet më parë kundër trupave të Haxhi Zekës, që mbronin Ulqinin nga pushtimi malazez.

Nderkohe, gjendja në qytet ishte rënduar. Zija e bukes kishte pllakosur kudo dhe me shumë se gjysma e të vdekurve ditore ishin nga uria. Qyteti ishte shkatërruar dhe, sipas kronikave të kohës, vullnetaret nga Shqiperia e Mesme kishin filluar të zienin opingat e tyre prej lekure dhe të pinin lengun e tyre. Nga ana tjetër, vdekjet dhe plagët kishin provokuar epidemi, që po beheshin gjithnjë e më kërcënuese. Me 5 Mars, princi Danilo kerkoi një armepushim dy ditë dhe ofroi një ndihmë për të plagosurit. I shoqëruar nga Ministri i



Jashtëm i Malit të Zi, ai mbërriti në qytet me anije dhe u tmerrua nga pamja që i hapej para syve. Në pak orët që qendroi në qytet, ai bisedoi vetëm për vetëm me Esat Pashën dhe tema kryesore duhet të ketë qenë: Dorezimi i qytetit. Nuk dihet se si shkoi kjo bisedë, por dihet se qyteti rezistoi pas kësaj edhe me shumë se një muaj e gjysëm. Me famën e Komandantit të Shkodrës, Esat Pasha ishte zgjedhur nga Qeveria e Vlores, Ministri i Luftes në mungesë dhe pritej që, pas Rrethimit, ai të shkonte në Vlorë si një hero. Në fillim të prillit, Konferenca e Ambasadoreve vendosi që edhe Gjakova t'i mbetej Shqiperise. I vetmi kundërshtim mbetej Rusia dhe marrëdhëniet e kësaj të fundit me Austro - Hungarinë po tensionoheshin. Në këtë kohë, Rusia keshilloi malazet që t'i jepnin fund Shkodrës në më pak se një javë. Situata në qytet ishte rënduar dhe nuk dihej se sa kohë mund të rezistohet ende. Pikerisht në këtë kohë hyri në lojë Esat Pasha. I lodhur nga rezistenca, nga uria, nga presionet, apo sipas një marrëveshjeje me malazet, ai vendosi të dorezohet. Në mëngjesin e 19 prillit, ai thirri Shefin e Shtatmadhorisë, Abdurrahman Nasif Beun, dhe i komunikoi vendimin që kishte marrë. Bisedimet me malazet filluan që atë ditë. Gjenerali Janko Vukatiq dhe Ministri i Jashtëm Pjeter Pllamenac mbërritën në Shkodër. Gjithçka zgjati me shumë se tre ditë dhe, në përfundim të tyre, malazet pranuan kërkesën e Esat Pashes, që ushtria turke dhe vullnetaret shqiptarë të largoheshin nga qyteti me armët e tyre dhe me një ceremoni nderimi ushtarak. Pra, duke mos i njohur si të humbur, por si bashkëpunëtarë të një armepushimi. Faktikisht kjo ishte formula më e mirë e një





dorezimi, por vete dorezimi, formula me e keqe per Shkodren. Nese rezistenca do te kishte zgjatur edhe me pak se 10 dite, malazet do te ishin terhequr per shkak te presionit nderkombetar. Nuk eshte cudi qe Esat Pasha ta kete dorezuar Shkodren si pasoje e nje marreveshjeje me malazet dhe serbet, marreveshje qe i njihte atij te drejten per te drejtuar ne principaten e vogel shqiptare, qe kishte ndermend te ngrinte me qender ne Tirane.

Dorezimi u be mengjesin e dates 25 prill dhe, vetem pasi u largua edhe luftetari i fundit shqiptar, pushtuesi ngriti ne kalane e Rozafes flamurin e vet. 25 Prilli ishte dita e 183 e rrethimit. 183 dite qe kishin shenuar mbi 3500 te vrare e te vdekur, disa mijera te plagosur apo te semure si dhe nje shkaterrim te mbi 60 % te qytetit. Por qe i kishin siguruar Shkodres nje emer te madh ne kronikat europiane.

Ushtria malazeze hyri ne Shkoder 24 ore pasi qene larguar trupat e Esat Pashes. Keto te fundit, duke kaluar neper Lezhe dhe Milot, ku u priten me nderime ushtarake nga trupat pushtuese Serbe, mberriten ne Tirane. Nje jave me vone, mbi 1800 ushtar turq u larguan me anije per ne Stamboll, ndersa vullnetaret e Shqiperise se Mesme pas nje parakalimi ne Tirane u shperndane ne qytetet e tyre.

Dorezimi i Shkodres u konsiderua si tradheti me shume se sa si fitore. Ismail Qemali e priti me nderime Esat Pashen, ndersa ky vinte ne Vlore per te marre postin e tij. Por dorezimi i Shkodres krijoi probleme per diplomacine pro shqiptare. Vendimi unanim i Fuqive te Medha per t'ia dhene Shkodren

Shqiperise u komplikua nga prania malazeze atje. Rusia hyri perseri ne loje dhe i kerkoi Konferences se Ambasadoreve qe Gjakova, qyteti verilindor qe i ishte lene Shqiperise, t'i jepej Malit te Zi, me kushtin qe ky te hiqte dore nga Shkodra. Situata mes Austro - Hungarise dhe Rusise u tensionua prape, por gjithcka u zgjidh perseri ne favor te sllaveve. Nje mengjes te fillim majit 1913, Ambasadori Austro - Hugerz ne Londer, Konti Mensdorf i kerkoi nje takim urgjent Ministrit te Jashtem Britanik, Eduard Grei. I sapo ngritur nga



shtrati, Grei, u detyrua ta priste kontin i veshur me rroba shtepie. Ende pa hyre ne dere, konti shqiptoi me eufori: Austro - Hungaria dhe Rusia nuk kane me pse te grinden mes tyre. Ne pranojme qe Gjakova t'i kaloje Serbise ose Malit te Zi, me kusht qe Shkodra te mbetet ne Shqiperi. Grei aprovoi dhe po ate moment dhe pakti mori vlere zyrtare.

### Fundi

Me qenese administrata e re e Qeverise se Vlores nuk kishte lidhje tokesore me Shkodren, administrimi i saj dukej mjaft i veshtire. Por, nje koment i gazetes britanike "Times", dha nje zgjidhje perfekte. Shkodra te merrej nen administrim nderkombetar. Procedurat moren fund shpejt dhe nen-Admirali Anglez, Burney, u urdherua te zbrese ne toke dhe te marre ne dore administrimin e qytetit. Me 13 Maj, malazet u larguan dhe me 14 Maj, nen-Admirali Burney hyri ne qytetin, qe digjej ende. Ne ikje e siper, malazet i kishin vene zjerrin pazarit te mrekuallueshem te qytetit. Me 15 Maj, u krijua Keshilli i Ri Bashkiak, i perbere nga 6 katolike dhe gjashte myslimane. Te gjitha nen urdherat e nje britaniku. Pas me shume se 450 vjetesh, Shkodra ishte perseri e lire.

Kush ishte Hasan Riza Pasha


Vali i qytetit te Shkodres qe nga viti 1911, Hasan Riza Pasha e lidhi emrin e tij me qytetin verior shqiptar sidomos gjate rrethimit dhe qendreses se tij ndaj malazezeve me 1912 - 1913. Gjeneral i ushtrise turke, ai kishte lindur me 1871 ne Bagdad. I jati Namik Pasha ishte Vali i Bagdadit dhe djali pati nje karriere te shkëlqyer. Ne vitin 1892 u gradua si nentoger ne Akademine Ushtarake te Stambollit, ndersa me 1895 u gradua kapiten ne Shkollen turke te Shtatmadhorise. Me granden nenkolonel, me 1899 u dergua ne Gjermani ku plotesoi studimet e larta ushtarake. Nga viti 1901 deri me 1911 sherbeu ne Irak, ku fitoi edhe graden Gjeneral, ndersa me 1911 u emrua ne Shkoder. Ai luajti nje rol fantastik ne mbrojtjen e qytetit nga sulmi malazet dhe ne kalimin e Shkodres administrates shqiptare te Qeverise se Vlores. Per kete edhe u vra ne nje atentat, naten e 30 janarit 1913 duke u kthyer nga shtepia e Esat Pashë Toptanit. Vrasesi i tij sipas te gjitha gjasave ishte Osman Bali. Eshte varrosur ne xhamine e Parruces ne Shkoder.



Papa Françesku firmos  
zyrtarisht martirizimin e 38  
Martirëve të Kishës katolike



Papa shpall  
dekretin e  
martirizimit të  
38 martireve  
të vrarë në  
1945-1974



Njoftimi është dhënë nga Imzot Angelo Massafra, kreu i Konferencës Ipeshkvnore

**E**shtë bërë i mundur sigurimi i dekretit të publikuar nga zyra e shtyptit të Vatikanit që mban datën 26 prill 2016 ku thuhet se Kongregacioni i Cështjeve të Shënjtërimit në Vatikan dekreton martirizimin e Im zot Vincenzo Prenushi Ipeshkop i Durrësit e të 37 meshtarëve të tjerë të vrarë prej vitit 1945 më 1974, në Shqipëri.

*Kush ishin martirët shqiptarë të vendosur në këtë proces? (marre nga Peregrinus.al)*

**Imzot Vincenc Prennushi:**


Françeskan, ipeshkëv i Durrësit, poet. U burgos e u torturua sepse nuk pranoi ta shkëpuste Kishën shqiptare nga Selia e Shenjtë; dha shpirt me 19 mars 1949 në birucë të burgut, i shtrirë në dheun e lagësht, të ftohtë, këmbëzbathur, si Shën Fraçesku, bir të cilit ishte!

**Imzot Frano Gjini:**

Ipeshkëv, martirizimi i të cilit ia kaloi çdo fantazie kriminale njerëzore: i papërkulur para torturave, si nuk pranoi ta shkëpusë Kishën nga Papa, u dënua me vdekje e u pushkatua më 11 mars 1948.

**Imzot Jul Bonati:**

Meshtari i madh intelektual, si u mbyll, për torturë, në çmendinë e si provoi tmerre të padëgjueshme në qeli të ndryshme të sigurimit famëkeq, nga Vlora në Durrës, vdiq në burgun e Durrësit, pranë Imzot Pren-



FAKSIMILE E NJË PREJ SHUMË VENDIMEVE MONSTROZE TË TRUPAVE GJYKUESE KOMUNISTE, PJSË E LUFTËS SË PËRBINSHME NDAJ PËRFAQËSUESVE TË KLERIT

nushit, i cili i jepte shËjtën për shtegtimin e mbram: Vojimin Shenjt.

**Dom Alfons Tracki:**

Prifti gjerman, më shqiptar se shqiptarët, bir i Breslaut, u torturua dhe u pushkatua më 25 qershor 1946, në moshën 50 vjeçe.

**Dom Anton Muzaj:**

U torturua në mënyrë çnjerëzore, vetëm sepse nuk pranoi të mohonte fenë: si i thyen këmbë e duar, e liruan nga burgu dhe e nisën në shtëpi, ku vdiq mes dhimbjeve të tmerrshme mbas pak ditësh, në moshën 29 vjeçare.

**Dom Anton Zogaj:**

Famullitar i Durrësit, sekretar i Imzot Prennushit, meshtar jashtzakonisht i përgatitur në të gjitha drejtimet, u burgos e u torturua mizorisht. E lanë të mbyllur disa ditë në një banjo të qelbur, në sa priste ditën e pushkatimit: 31 dhjetorin e 1946-tës.

**Dom Dedë Maçaj:**

i akuzuar si spijun i Vatikanit, u torturua, u gjykua dhe u pushkatua për rezistencën e tij heroike fetare, në moshën 27 vjeç.

**Dom Dedë Malaj:**

Mbeti i paharruar në kujtesën e popullit për mbrojtjen heroike që i bëri fesë së krishterë në gjyqin e organizuar kundër tij, që e dënoi me vdekje. U pushkatua në breg të Liqenit të Shkodrës më 12 maj 1959. Ishte 39 vjeç.

**Dom Dedë Plani:**

Dha shpirt në spital më 30 prill 1949, mbasi nuk pranoi asnjë akuzë e u bëri ballë heroikisht torturave mizore.

**Dom Ejëll Deda:**

Famullitar i Bushatit, i arrestuar vetëm pse ishte prift, vdiq më 12 maj 1948 në spitalin e burgut, mbas torturash çnjerëzore.

**Dom Jak Bushati:**

E akuzuan se ndihmonte diversantët, se bënte agjitacion e propagandë: pretekste të cilat e çuan në pushkatimin pa gjyq më 12 shkurt 1949.

**Papa Josif Mihali:**

Njeri i Zotit, arrestuar e torturuar veç me këtë akuzë, u mbyt për së gjalli në baltën e kënetës, në kampin e shfarosjes të Maliqit.

**Dom Zef Maksen:**

Meshtar gjerman, pushkatuar me 1946, duke shqiptuar fjalët: “Des i lumtun, tue mendue se do të kujtohem prej shqiptarëve si meshtar i fesë së Krishtit”.

**Dom Lazër Shantoja:**

Meshtar i ndritur, njeri i kulturës, i letërsisë e i artit, u masakrua deri në atë gradë, sa vetë e ëma kërkoi nga xhelatët komunistë ta pushkatonin një orë e më parë, gjë që s’munguan ta bënin në fushat e shkreta të Tiranës, në sa ishte në moshën 54 vjeç.

**Dom Lekë Sirdani:**

Personalitet i shquar i Kishës katolike: prift, patriot, shkrimtar. U torturua mizorisht dhe u mbyt për së gjalli në një gropë ujërash të zeza.

**Dom Luigj Prendushi:**

U arrestua, u torturua dhe u pushkatua si spiun i Vatikanit më 24 janar 1947.

**Dom Marin Shkurti:**

I shuguruar meshtar më 1961, shërbeu pak kohë në Kishën me dyer të hapura e shumë, në atë të heshtimit: guxoi ta vijojë heroikisht shërbimin meshtarak në kohën e terrorit. U arrestua, prandaj, u torturua e u pushkatua në vitin 1969.

**Dom Mark Gjani:**

U arrestua për veprimtarinë e tij meshtarake dhe u shua gjatë torturave të tmerrshme në duart e salvuesve të tij në qeli, me 1945.

**Dom Mikel Beltoja:**

U pushkatua më 10 shkurt 1974, mbasi mbrojti heroikisht e haptas idealet e veta fetare në gjyqin që iu bë pas gjashtë muaj torturash, i cili e dënoi me vdekje.

**Dom Ndoc Suma:**

Vdiq 2 vjet mbasi ishte liruar, i shkatërruar, nga burgu, ku u torturua me akuza për të cilat thoshte: “Vetëm kur dola në gjyq e mora vesht pse isha arrestue”.

**Dom Ndre Zadeja:**

Prift e poet, pushkatuar pa gjyq në qytetin e Shkodrës, duke u bërë martiri i parë, viktimë e diktaturës komuniste.

**Dom Pjetër Çuni:**

prift; vdiq i varur me kokë poshtë mbi gropën e ujërave të zeza.

**Dom Shtjefën Kurti:**

prift, pushkatuar para banorëve të Gurëzit. Sigurimi e akuzoi se deshi të helmatishte popullin duke shfrytëzuar për këtë, furrat e bukës.

**Atë Bernardin Palaj:**

Frat e poet i madh, do të vdiste ne Kuvendin e Françeskanëve në Shkodër, shndërruar në burg për 700 vetë. Nën torturat e Sigurimit mori tetanozin. Qe mbledhësi i parë i Eposit të Kreshnikëve, mitologji i shquar, por edhe muzikant e pianist i talentuar. Gjenerali i letrave shqiptare, pasardhës i denjë i Fishtës së madh, i mbytur e i harruar.

**Atë Çiprian Nika:**

Françeskan, vdiq nën akuzën e rëndë e shpifëse se kishte fshehur armë në elterin e Shëna Ndout, në Kishën françeskane të Gjuhadorit.

**Atë Gaspër Suma:**

Rregulltar, pinjoll i një familjeje, që u shua nga komunistët, u arrestua më 1947 dhe vdiq në burg.

**Atë Gjon Shkallu:**

Frati i madh filozof, u pushkatua së bashku me jezuitët Atë Gjovani Fausti (missionar italian) e Atë Daniel Dajani si dhe me seminaristin Mark Çuni, në fillimet e masakrës komuniste kundër klerit katolik. U akuzuan për “tentativë arratisjeje” dhe

për formimin e Partisë Demokristiane. Që të katërtëve shteti shqiptar u ka dhënë dekoratën “Martir i Demokracisë”.

**Atë Karl Serreqi:**

Frati që nuk pranoi të kallëxojë rrëfimin e një të plagosuri në ndeshjet me komunistët në mal, e kaloi jetën burgjeve. Vdiq në Burrel më 4 prill 1954. Është një ndër martirët e rrallë të sekretit të rrëfimit në historinë e Kishës universale.

**Atë Mati Prendushi:**

Frati që mori pjesë në ngritjen e flamurit në Deçiq, u përndoq dhe u fal nga kraji Nikolla e nga mbreti Zog, por u dënua me vdekje nga i ashtuquajhuri “gjyq” komunist. Nuk i dihet as varri.

**Atë Serafin Koda:**

Frat françeskan; dha shpirt mbasi hetuesët komunistë, duke mos u ngopur me torturat e zakonshme, ia shqyen fytyrën me thonj.

**Vëlla Gjon Pantalia:**

Jezuit; u arrestua ndër të parët e vdiq në spital, mbasi vuajti tmerre të papërshkrueshme.

**Fran Miraka, Qerim Sadiku e Gjelo Lulashi,** të rinj që edukoheshin ndër jezuitë; u vranë pse deshën Krishtin.

**Maria Tuci:**

U torturua e mbyllur në një thes, së bashku me një maçok, të cilin e godisnin me shkop. Virgjër e martire, vasha dha shpirt me mundime të jashtëzakonshme.





Nga Ndue BACAJ



# A mund të jetë 5 Maji dita e të gjithë Dëshmorëve të Atdheut?!



**Q**ë kur Krijuesi i Gjithësisë “vendosi” që “jeten” e njeriut ta “ndajë” në dy pjesë, në atë matriale (tokësore) dhe në atë shpirtërore (qiellore), njerëzimi dalëngadalë filloi të krijojë ndërgjegjen e respektit e nderimit për para-ardhësit dhe të afërmit e tyre që tashmë i përkisnin “jetës” qiellore, pra kishin vdekur materialisht. E si kujtim u kishin lënë varret ku preheshin trupat e tyre. Duke realizuar kështu “profecinë” e hershme që thoshte: “Se nga dheu na lindi trupi dhe dhe prapë do të bëhet”. Pas perqafimit dhe praktikimit të besimeve monoteiste (Kristianizmit e Islamizmit), që u perhapen e konsoliduan nga të dërguarit (e paralajmëruar) nga vetë Zoti ; mesitë Jezu Krishti e më

vonë Muhameti, nderimi për të vdekurit jo vetëm u rritë, por mbi të gjitha u bë një detyrim i pashmangshëm moral e material, si nga të krishterët, muhamedanët e tjerë. E për realizimin e nderimit të të vdekurve u caktuan data fikse që respektohen nga të gjitha shtresat njerëzore, jo vetëm si detyrim i jetës tokësore, por mbi të gjitha si detyrim shpirtëror i botës qiellore, nga ku kërkohet të ndihmohet jeta e pasosur e shpirtërave të atyre brezave që janë parardhësit tanë...Nuk ka as më të voglin dyshim se nga këtu mësuan edhe shtete e qeveri, laike apo teokratike që caktuan data për të përkujtuar e nderuar dëshmorët e rënë për atdheun. Gjithësesi nëse shumë popuj kanë dhjetra data të

shënuara të dëshmorëve të tyre të rënë në mbrojtje të lirisë e pavarësisë, ne shqiptarët kemi me mijëra, jo se ne donim vetë kështu të derdhim lumenj gjaku, por fatkeqësisht na e imponuan, pushtues, hileqarë e grabitqarë që shekujt na i sollën herë të afërt e herë të largët. Gjithsesi edhe ne shqiptarët me shtet apo pa shtet jo vetëm kemi respektuar dëshmorët e heronjtë tanë, duke i nderuar në data të caktuara, por mbi të gjitha i kemi përjetësuar në këngë, në legjenda, në gojdhna dhe në shkrime të ndryshme duke i transmetuar nga një brez në tjetrin, si vlera trimërie e atdhedashurie, duke u bërë burim frymëzimi për t'i dalur zot atdheut kur ai kishte nevojë, madje duke mos kursyer asgjë, as jetën... Gjithçka deri këtu mund të quhet "Normale", por normale nuk është data e caktuar për të kujtuar e nderuar dëshmorët e atdheut tonë, pasi atdheu ka ekzistuar prej mijëra vitesh, madje si rezultat i parardhësve tanë trima që u flijuan vetë për të mbijetuar Shqipëria, e ata janë dëshmorët e të gjitha kohërave, që meritojnë përkujtim e nderim pa dallim kohe, besimi, krahine dhe ideje. Ku data pesë maj jo vetëm nuk mund të jetë data përfunduese e të gjithë dëshmorëve të atdheut, por përkundrazi kjo datë përfqaeson atë pjesë të dëshmorëve të "vonuar" në kohë e ide, me gjakun e të cileve "luajten" për gati një gjysëm shekulli shakëllbanet e kuq të mjerimit, antinjerzimit, e antipendimit... Data 5 maj (1942) e vendosur



dhunshem nga sundimtarët komunist përkon me rënien e një dëshmori tepër të "vonë" të atdheut tonë të hershem. Vrasja e këtij dëshmori ngjanë me një flijim të dyshimtë nga vetë shokët komunistë ziliqarë. Komunistin Qemal Stafa e vranë pushtuesit Italian, me (5 maj 1942) dhe sipas shumë dëshmimeve del se nuk është viktimitë direkte e pushtuesit, por viktimitë e shokëve të tij, dhe idesë komuniste-mash-

truese. Gjithsesi ne nuk kemi asgjë kundër këtij dëshmori, që duhet ta kujtojmë e respektojmë, por jo kurrë nuk mund ta konsiderojmë si dëshmorin më sinjifikativ që mund të simbolizojë mijëra dëshmorë të tjerë. Por për të sqaruar diçka rreth viktimitimit nga shokët e vet të idealit të Qemal Stafës po u referohemi dy burimeve të ndryshme që përshkruajnë ngjarjen (vrasjen nga fashistët italianë më 5 maj 1942). Së pari dëshmia e znj. Drita Kosturi, e cila ishte një ndër 200 komunistet e para, por edhe njeriu më i afërt i Qemalit (e fejuara), e cila ndër të tjera thotë: "... Shtëpia e Beqir Minxhozit kishte vetëm tre ditë që ishte marrë me qera dhe shokët nuk e dinin pasi ishte tepër sekret! Në mbrëmjen e 4 majit të 1942, në këtë shtëpi ndodheshin 5 vetë, Qemal Stafa, Drita Kosturi, Flora (Gjystina) Dishnica, Marija Lezha dhe i zoti i shtëpisë Beqir Minxhozi. Rreth orës 10.00 të datës 5 maj 1942 erdhi në shtëpi Kristo Themelko. Në atë kohë Beqir Minxhozi ishte i dalur për pazar... dhe pa vonuar Beqir Minxhozi vjen i lidhur duarsh nën shoqërinë e rreth 60 policëve të SIM-it. Në këtë kohë Kristo Themelkoja (Shulja) hapi derën e nevojtores dhe u zhduk. Ilegalët e mbetur u nisën me vrap për të ikur. Në krye ecte





**E PAVARUR, INFORMATIVE, HISTORIKE DHE PATRIOTIKE**

Qemali, pas tij Marija, në fund Gjystina. Ndërsa Dritën e zunë italianë tek dera e shtëpisë. Kishin kaluar tre ara me grurë duke ecur me vrap, në atë kohë gjenden para policëve. Gjystina dhe Maria u ulën në tokë për të lënë bombat. Qemali vazhdoi rrugën duke qëlluar me patllake, italianët e plagosën Qemalin dhe nuk e pamë më. Dikush tha se vdiq në spital...” (Këtë dëshmi e pamë edhe njëherë në TV-KLAN të datës 05 maj 2014..). Ndërsa burimi tjetër është një trakt i Partisë Komuniste i lëshuar në atë kohë, në të cilin, ndër të tjera shkruhej: “...Qemali u gjend i rrethuar... Qemali i përcolli me të shpejtë shokët nga një anë e shtëpisë... kur agentët u afruan hapi zjarr duke shtrirë dy prej tyre të plasogur rëndë. Në këtë mënyrë çau rrethimin... Po në një luftë të pabarabartë, një plumb e mori Qemalin sydragua... Shoku Qemal thirri me sa fuqi që pati... Rroftë Komunizmi dhe shoku Stalin...”. Pra nga “dëshmia” e vetë komunistëve, në ato momente shokut Qemal i paska rënë ndërmend për komunizmin dhe shokun Stalin (madje një veteran me mustaqe kishte protestuar se në këtë trakt ishte censuruar pjesa që thoshte, “rrofshin” edhe mustaqet e shokut Stalinit). Gjithësi pas kësaj, Drita, Maria dhe Flora (Gjys-

tina) u dënuan me burg nga fashistët, ndërsa i zoti i shtëpisë Beqir Minxhozi u lirua pa pësuar asnjë dënim. Madje dhe gjatë regjimit të Enver Hoxhës, ky komunist veteran jo vetëm nuk pësoi asgjë për këtë tragjedi të heroit Qemal Stafa, por u respektua e nderua nga vetë sistemi komunist. Dhe si për të sqaruar “vrasësit” e vërtetë të Qemalit vjen momenti i rënies së komunizmit dhe fitorja e pluralizmit, ku

në vitin 1992 ishin gjallë tre femrat dëshmitare të kësaj ngjarje dhe vetë Beqir Minxhozi .. Drita, Flora dhe Maria kërkuar një takim të përbashkët me B. Minxhozin për të sqaruar se kush ishte spiuni që dekonspiroi bazën më 5 Maj 1942, por z. Minxhozi nuk e pranoi gjallë këtë takim, madje më vonë ai shkroi një libër për luftën “Nacional-Çlirimtare”, ku emri i Qemalit nuk figuron fare. Ndërsa nga dëshmitë e





kohës komuniste na vjen fakti se E. Hoxha në një vizitë të para vitit 1947 në shtëpinë e Qemalit, ndodhet para një të "papriture", ku nëna e Qemalit i thotë: "...Të mos më shkelësh më në shtëpi sepse ti më ke vra djalin." Madje E. Hoxha nuk ka asnjë fotografi me familjarët e Qemalit, duke dëshmuar se pas vitit 1947 familjen e Qemal Stafës nuk e ka vizituar kurrë më pas kësaj. Dhe si për të përforcuar këto nga dokumente të kohës sqarohet se familjarëve të heroit nuk u ishte lidhur pension deri në vitin 1950, kur ndërhyt Gogo Nushi... Pa dyshim ia vlen të ndalemi edhe në një fakt tjetër të dëshmorëve në përgjithsi të luftës Nac.-Çl., ku ky fakt vjen nga një gazetë shumë e afert me trashigimtarët e komunisteve (atëhere kur e shkruan 2002 dhe sot 2014), nga e cila po citojmë: "... Numri i brigadave partizane ka qenë 28, por në fakt ka pasur 25 brigada, se tre prej tyre nuk u krijuan fare. Po të kihet parasysh numri i përafërt prej 1000 partizanësh që ka pasur çdo brigadë dhe po t'i shtojmë edhe 3000 të tjerë që kanë qenë pjesëmarrës në çetat territoriale, numri arrin në 28 mijë partizanë. Në këtë kontekst dhe po të merret si e vëretë shifra e 28 mijë dëshmorëve, del se duhet të figuronin të vrarë të gjithë ata që u radhitën nëpër brigadat partizane... dhe larg qoftë, sot s'do të kishim gjallë asnjë veteran..." (Gazeta

Shqiptare më 5 maj 2002, shkruar nga Dashnor Kaloçi). Sipas statestikave shtetore kurrë nuk u gjetën të shkruar emrat e 28 mijë dëshmorëve. (Gjatë viteve të komunizmit ky numer dëshmoresh ishte një tabu, që nuk guxonte burr nane ta "prekte"..) Ish Zv/kryeministri dhe ish ministri Dashmir Shehu, që ishte marrur me këtë problem (gjatë viteve të demokracisë 1992-1996) kishte arritur të siguronte vetem rreth katër-mijë emra, ku në mes ketyre emrave ekzitonin edhe

emrat e atyre që mund të quhen gjithshka, por kurr dëshmor të atdheut, si p.sh. : "Partizanë" të vrarë duke luftuar në krah të pushtuesve Serbo-Jugosllav-komunist, kunder nacionalistëve Kosovar, që mbrojnë trojet e tyre me të drejtën e Zotit e autoktonisë, por edhe me konventat nderkombetare të vetvendosjes... Ndersa shovenet e vjeter serbo-sllav, me prapashtesen e re komunist, të ndihmuar nga PKSH që kishin krijuar vetë (1941), luftuan së bashku për ripushtimin e Kosoves nga dhjetori i vitit 1944 deri në prill 1945... (Siç dihet që nga fundi i muajit tetor 1944, nuk kishte këmbë pushtuesi gjerman në trojet e kosoves që në shumicën e territoreve të saj qeverisej nga nacionalistët shqiptar..). Gjithashtu në këtë listë figurojnë emra "dëshmoresh" të vrarë pas çlirimit të Shqipërisë, pra gjatë ekspeditave ndeshkimore të ushtrisë komuniste ndaj nacionalistëve shqiptar që nuk e donin komunizmin e pa F.E dhe pa ATDHE.. E keta siç dihet mund të quhen dëshmoret e partisë (komuniste të punes apo...), por jo të Shqipërisë, e aq më pak të asaj demokratike- Europiane...

Gjithsesi Shqipëria dhe shqiptarët kanë ekzistuar e sakrifikuar për atdheun, madje për një atdhe entiko-nacionalist dhe jo internacionalist të shkarravitur nga ideologji e sundime çnjerëzore, e ky atdhe që quhet Shqipëri, ka me mijëra data më sinjifikative që mund të përfaqësonin vërtetë në një datë të vetme ditën e dësh-





**E PAVARUR, INFORMATIVE, HISTORIKE DHE PATRIOTIKE** morëve të të gjitha kohërave, pa dallim besimi, krahine apo ideje, por me një qëllim të vetëm, shpëtimin e Shqipërisë, duke e dëshiruar siç e ka falur Zoti, të bukur, të lirë e të pavarur. Dhe data të tilla mund të gjinden me mijëra të paktën tash qindra vjet, por unë për ta bërë sa më “konkrete” po kujtoj vetem ato që i përkasin shekullit XX, që në fakt është edhe shekulli i konsolidimit të vetë shtetit dhe sovranitetit të kombit tonë (ndonëse të ndarë). Si fillim po kujtoj kryengritjen anti-osmane të vitit 1911, e cila zgjati nga 24 marsi (1911) deri më 4 gusht (1911). Ku nga kjo kryengritje iu dhanë kombit qindra dëshmorë. Dhe vetëm më 6 prill (1911), dita kur u ngrit flamuri shqiptar i Gjergj Kastriotit, për herë të parë pas rreth katër shekujsh e gjysëm robërie otomane i dha shqiptarizms 7 dëshmorë. Madje data 6 prill mund të ishte data që duhej të nderoheshin e kujtoheshin në përjetësi dëshmorët e atdheut. Dhe si për t’u bërë qejfin veteranëve me sy e mendje vetëm nga jugu, u kujtoj se data dëshmorësh mund të gjinden edhe në vitet 1912-1913 në Qafën e Llogorasë, ku kanë rënë dëshmorët e parë për të mbrojtur shtetin e parë shqiptar të krijuar që më 28 Nëntor 1912. Po në këto vite ka edhe dhjetra data e dëshmorë të rënë në Veri

të Shqipërisë në mbrojtje të shtetit e trojeve tona nga lakmitë serbo-malazeze. Në vitin 1914 ka dhjetra data e dëshmorë që simbolizojnë luftën e shqiptarëve të jugut për të mbrojtur trojet tona nga Andartet grekë, ku vlen të shënohet data 23 mars 1914 ku kanë rënë dëshmorët Ceno Sharra,

Haki Glina e tjerë, këta dëshmorë ranë edhe për mbrojtjen e shtetit shqiptar që rrezikohej edhe nga bandat e Haxhi Qamilit që kërkonte baba sulltanin.

Po në viset jugore të Shqipërisë, në Vlorën heroike më 1920 u zhvillua një luftë titanike për shporrjen e pushtuesve italianë, ku dhanë jetën dhjetra dëshmorë, dhe shumë mirë mund të zgjedhej një datë e kësaj epopeje.

Po brenda vitit 1920 mund të zgjedheshin data të tjera dëshmorësh të panumërta në luftën e shqiptarëve të Veriut kundër pushtuesve serbo-sllavë. Ku kulmi arrin me atë që tashmë njihet në histori si “Lufta e Koplikut”, e cila zgjati nga 26 korriku 1920 deri 14 shkurt 1921, ku edhe nga kjo luftë mbrojtëse, ju shtuan atdheun tonë edhe dhjetra dëshmorë, të tjer të lirisë ku nga kjo epope lavdiplotë po veçojmë datën 20 shtator 1920, kur në Fushën e Koplikut ra heroikisht dëshmori trim Zef Prel Martini, i përjetësuar në këngë e legjendë nga populli i trevave tona. E mos të harrojmë se kjo luftë nuk ishte luftë spontane, por një luftë e organizuar dhe drejtuar nga qeveria shqiptare e dalë nga Kongresi i Lushnjes. Por data dëshmorësh mund të gjinden në pafundësi edhe në vitet 1921, si vazhdim i luftës mbrojtëse nga lakmitë e shtuara shovene. Ndërsa në vitin 1923 përsëri ka dëshmorë të rënë në Gjirokastrë, për të







mbrojtur trojet shqiptare nga lakmitë shovene greke. Gjithashtu mund të vazhdohet deri në ditën e zezë të pushtimit fashist më 7 prill 1939. Vetëm në këtë datë në Durrës u zhvillua një betejë legjendare në mes nacionalistëve shqiptarë e pushtuesve italianë, ku dhanë jetën dëshmorët Mujo Ulqinaku, Haxhi Tabaku, Isa Metalia, Hamit Dollari e tjerë, gjaku i të cilëve nuk do të “thahet” kurrë, pasi ata ishin dëshmorët e parë kundër bishës fashiste që kërkonte të gllabëronte atdheun tonë. Padyshim nga këto kohë heroike dhe historike, por edhe të tjera që nuk u shënuan në këtë shkrim (të shkurter memorativ) mund të gjenden data të pranueshme nga gjithë shqiptarët, jo vetëm të Shqipërisë “Londineze”, por edhe viseve të tjera jashtë kufijve politikë të Shqipërisë, si nga Kosova tashma e lirë dhe e pavarur, apo nga troje të tjera shqiptare si Çamëria, Maqedonia Perëndimore e deri trojet shqiptare nën Malin e Zi etj.

Gjatë regjimit diktatorial primare në gjithçka ishte partishmëria (komunizmi) dhe data 5 Maj ishte e “padiskutueshme”, por me rënien e komunizmit, duhej të binte edhe ky simbol me aromë të dukshme komuniste.. Kjo do të realizohej duke bërë një studim serioz për të përcaktuar datën e vërtetë në të cilën duhet të perkujtohen e nderohen ata që janë themeli i Shqipërisë së vërtetë, por mjerisht kjo deri sot nuk është bërë... E kështu më 5 maj nderohen njëloj, si dëshmorët e vërtetë që i falën

shpirtin e jetën atdheut, ashtu edhe ata që janë bërë dëshmor e heronj për qellime politike nga klika anadollake komuniste. Për ta ilustruar këtë unë si fillim do të shkruaj për kriminelin e njohur në Veri të Shqipërisë me “nofkën” Toger Baba, që në të vërtetë e kishte emrin Hodo Habibi, dhe ishte një analfabet nga Kurveleshi. Ky komunist kur ia mujti zollumi, vetë komunistët e arrestuan dhe nxorën në gjyq, ku u vërtetua se kishte pushkatuar mbi 100 vetë pa gjyq, kishte dhunuar seksualisht mbi 50 femra të pafajshme, kishte kryer mbi 24 tortura çnjerëzore vetëm tek gratë, ku 12 gra i kishte zhveshur lakuriq në sy të gjithë partizanëve, por edhe të tjera që gjenden në dosjen e tij të vitit 1947.



Madje Toger Baba ishte arrestuar vetëm kur kishte përdhunuar një partizane që ishte dashnorja e Zoi Themelit. Nga gjyqi u dënua me vdekje, por më vonë, me propozim të Hysni Kapos, Enver Hoxha e shpalli dëshmor, nga ku edhe sot figuron si i tillë, duke u “nderuar” çdo 5 maj...

Ndërsa në zonën veriore të Shqipërisë në një fshat ndodhen disa varreza që nderohen si varrezat e dëshmorëve, kur në fakt ata jo vetëm nuk shpazën asnjë pushkë kundër pushtuesit, por u bënë viktimë e një krimi çnjerëzor të disa bashkëfshatarëve të tyre, pasi tre gjermanë të paarmatosur po ktheheshin në punë të tyre, këta fshatarë u dolën përpara dhe pasi i vranë, i zhveshën lakuriq, duke i marrë të gjitha rrobat e shtatit dhe sendet me vlerë që kishin, dhe kur pas disa orësh kalon andej një batalion gjerman që po kthehej për t’u larguar në “punë të vet” (nga Shqipëria) dhe gjejnë shokët e tyre të masakruar, ndërmarrin një raprezalje të tillë që sot këto viktima të vetvetes i nderojmë si dëshmorë. Gjithashtu si dëshmor nderohen e perkujtohen edhe ata shqiptar që u vranë gjatë luftës civile (në mes komunisteve e nacionalistëve), të inskenuar nga partia komuniste (e më vonë e Punes), për të marrë e ruajtur pushtetin e tyre absolut e tjer, kur në Shqipëri nuk kishte “kokerr” italian apo gjermani.. Por gjatë sundimit komunist u krijuan edhe qindra dëshmorë të tjerë që nuk ishin asgjë tjetër vetëm viktimë e kushteve teknike të punës apo stërvitjeve ushtarake, madje ka nga ata dëshmorë që ishin viktimë e cjamin që printe tufën e dhive (që e goditi se iu kruan brirët dhe e hodhi në humnerë) dhe



e shpallën dëshmor, sikur u përlesh me agjentë të ndryshëm antishqiptarë. Gjithsesi sot duhej të ndaheshin dëshmorët e vërtetë, nga ata që krijoi vetë regjimi për qëllimet e veta mashtruese e nënshtruese. Deri tani, megjithëse kanë kaluar kaq vite nga rënia e sistemit komunist, njerëzit ende janë të “detyruar” të nderojnë data e simbole aspak perfaqësuese siç është edhe data 5 Maji që quhet “Dita e Dëshmorëve”. E ndonëse për këtë datë sot shumica e popullit nuk ka “interes”, është një pjesë që ka marrë flamurin e veteranëve që “luftuan” gjoja për Shqipërinë dhe në këtë ditë simbol trimërohen, por edhe gëzohen, se shpresojnë se pas këtij simboli, simbole të tjera do të vijnë, ndonëse ngadalë e disi pa u ndjerë. Në këtë ditë gjallojnë fotografit e kriminelit Enver Hoxha, mbahen fjalime glorifikuese për diktatorin e diktaturen, si dhe nderohet si dikur me grusht, por kjo faqe e zezë nuk ka mbetur vetëm në kuadër të disa “veteranve” të matufepsur, por ky manifestin enveristçe është shoqëruar edhe nga deputet e ministra të qeverisë së “rilindjes”. Vlenë të kujtohet se shimica e atyre që ranë vertet në luftë kundër nazifashizmit nuk kishin qënë kurr komunist sa ishin gjallë ( ndersa një pjesë të ketyre dëshmoreve PKSH i “bëri” komunist pas vdekjes...). Gjithsesi edhe ata që e derdhen gjakun për një ideal të gabuar në

këtë truall të vertet, patjetër e mendonin më mirë seç ishte atëherë, madje ata nuk mund të parashikonin gjëmën që mund t'i bënin atdheut shokët e tyre që mbetën gjallë. Për këtë luftë që fillojë si luftë antifashiste e perfundoi në luftë civile në mes shqiptarëve kanë shkruar shumë autor , por nga keto libra mendova të perzgjedhë diçka nga libri më i “bujshem” i asaj kohe e sot me titull “REFLEKSIONE”, i publikuar në vitin 1992 me autor kryeministrin e sotem zotin Edi Rama (dhe bashkeautor të ndjerin Ardian Klosi). Edi Rama dhe Ardian Klosi nuk ishin intelektual të çfarëdoshem, por të lindur, rritur, shkolluar e kalitur në gjirin e nënës Parti... Me këtë

“rast” nga libri “Refleksione” po citojmë : “..Historia e luftes per pushtet që kishte projektuar gjeneral Enver Hoxha, dhe marrja e pushtetit me dhunë, që ka qënë thelbi i çdo levizje komuniste, është shkak i vetem që ajo luftë kundër okupatorit degjeneroi në luftë civile. Pra çështja e pushtetit është argumenti që zbulon edhe shkakun e tradhtisë që komunistet i bënë demokracisë dhe kombit shqiptar... Shifrat e terrorit komunist janë jashtëzakonisht të mëdha në krahasim me popullaten e Shqipërisë dhe në krahasim me vende të tjera ish-komuniste të Europës, prandaj edhe më e pamundur është harresa tek ne.... E kaluara do të na mbajë të gozhdur në rrethin e saj vicioz për sa kohë nuk kemi bërë katarsisin e vertet historik...”. Duke dashur ti besojmë me sinqeritet librit “Refleksione” për nevojën e katarsisit historik, neve na mbetet veçse të urojmë që autori kryesor i “Refleksioneve” zoti Edi Rama të kenë ato mend që kishte rreth njëçerek shekulli më përpara për të bërë katarsisin historik , që sot e ka më të nevojshem dhe mundëshem se kurr, pasi ai është kryeminister i Shqipërisë... (Por siç duken” bathët” deri tani kjo ska për të ndodhur.) Duke dashur të perfundoj këtë shkrim dua të “garantoj” adhuruesit e kesaj dite plot grushte, yje dhe enver, se unë nuk kam pasur qellim të shpreh asnjë mllef apo inat me askënd , madje as nuk “pretendoj” të kerkoj ndryshimin e kesaj historie që tashma ka “marrë” para edhe opoziten, e cila “noton” në ketë ditë në mes valëve të shkumbëzuara të 5 majit...”. Gjithsesi dëshmorët e vertet që u flijuan për Shqipërinë pushofshin në page...





Nga Vasel GILAJ  
New York

# Cokajt, piramidë shqiptarie, të vrarë nga tre shtete

**R**reth 200 vite me pare, familja e Cokajve edhe pse as atje nuk u mungonte pasuria per kohen, qe jetonin vendosen qe te zbresin nga Nikci i Kelmendit duke u vendosure ne Shenkollë te Bregut te Matit, shume shpejt Cokajt shtuan numerin e bagtivate, hapen siperfaqe te medha toke, dhe nisen tregtin e prollimeve qe merrnin duke u pasuruar dhe bere nje faktore shume i rendesishem, dhe jo vetem per zonen e Lezhes pore edhe te Shkodres e Malesise se Madhe edhe prej nga vinin.

E pse jo edhe deri ne Kosove nepermjet tregtise se prollimeve Bujqesore e Blegtorale, si dhe asaj te Krypes dhe tregtise se Armeve. duke u bere jo vetem shume te njohur edhe me mjaft personalitete te kohes. Lavdia dhe fuqia e kesaj familjeje malesore eshte e lidhur ngushte edhe me Cok Preken, dhe qe vazhdon gjithmon ne rritje me djemte e tij dhe konkretishte, Mash Coku, Gjeto Coku, dhe Ded Coku.

Te cilet kane nje histori sa tragjike aqe edhe te lavdishme, patriotike dhe atdhetare duke u bere vertet piramid shqiptarie per nje periulle kohore afer 1 shekulli. Cok Preka arrestohet si kryengerites anti-turke, dhe si organizatore i kundershimit te pagimit te taksave Turke dhe vdes ne

kalan e shkodres, ne tetor te vitit 1886 pasi ishte denuar me burgim te perjetshem.

Djali i madhe i Cok Prekes, Mashi udhheqes popullore dhe luftetare trim, edhe vrare nga Cetniket Malazeze si luftetare per mberojtjen e tokave shqiptare nga malazezet, te cilit iu deshe, te luftonte pervec turkut edhe me fqinjet malazez, Mashe Coku kishte lindur ne vitin 1848 ne shenkollë te bregut te matit.

Mashe Coku me Llesh Nik Daken organizuan malesoret per mberojtjen e Plaves e Gucise ne vitin 1879

Fitoret e arritura ne betejat e zhvilluara e vecanarisht ajo e Nokshiqit ne vitet 1879-1880 paten rendesin e tyre dhe ku rol mjaft te rendesishem luajten edhe malesoret bregmatas.

Ne keto kushte drejtimin e familjes se madhe te Cokajve e merr. Djali i dyte i Cok Prekes, Gjeto Coku i lindur po ne shenkollë te lezhes ne vitin 1860 Gjetoja dhe Deda, qen vellezer me gruan e dyte te Cok Prekes, Lulen e bija e heroit te Vranines Kacel Dodes nga Kastrati i Malesise se Madhe.

**GJETO COKU KAJMEKAMI I LEZHES**  
Ngjarjet e vitit 1878 kure levizja kombetare shqiptare mori zhvillim te madhe, vendimet e Shen- Stefanit qe ishin rrezik edhe per malesin e madhe, kongeresi i Berlinit e tjer si dhe vrasja e babes ne burgun e kalas se shkodres nga pushtuesit Turq, e nxiten



SKULPTORI VASIL RAKAJ GJATË PUNËS PËR REALIZIMIN E BUSTIT TE GJETO COKUT



**E PAVARUR, INFORMATIVE, HISTORIKE DHE PATRIOTIKE**

19 vjecarin Gjeto Coku qe te rrembente armet, dhe te luftonte perkrah vellait te tij Mashit. e pasi edhe Mashin e vrane cetniket malazez, tani mbi Gjeto Cokun binte barre edhe me e rende. Gjeto Coku ishte burri i urte dhe i matur, malesor trim e i ndershem i cili sa vinte e brumosej me idealet e Rilindjes Kombetare. Ne perjekjet e tij per liri e pavaresi Gjeto Coku ra ne kontakt me figurat e shquara te kohes, te cilet ia shtuan edhe me shume bindjen per liri. ne vitin 1879 Gjeto Coku martohet me Laze Martinin nga Selca e Kelmendit, me te cilen pati 8 femije, nga keta 4 djem e 4 vajza. ka pasur edhe nje djal tjetër Gjergjin me gruan e dyte Pashken, zhvillimi i ngjarjeve te viteve 1899-1904 pas Lidhjes Shqiptare te Pejes, veprimtarit anti osmane me ne krye Gjeto Cokun u bene gjithnje e me te zjarrta e te shpeshta.

Masa me e rrepte qe Qeveria Turke mori ndaj tij qe Internimi ne Izmir te turqise per 4 vite me rralle dhe konkretisht ne

vitet 1904 - 1908 ka qene vellai i tij Ded Coku qe me pagese e miqesi i cili edhe pas takimeve me deputetin e Vilajetit te Beratit e Stambollit, Ismail Qemali ka bere te mundur lirimin nga internimi ne izmir te Turqise te Gjeto Cokut. Sapo eshte kthyer nga internimi Gjeto Coku vecse e ka shtuar veprimtarin e tij, fillimisht ai vendosi lidhjet me kreret e krahinave te Lezhes, Kol Toma, Gjin Pjetri, e tjer si dhe me ata te Mirdites e Malesise se Madhe, Ded Gjon Luli e deri ne Kosove me Zefin e Vogel, dhe me Toptanet ne Jug te Shqiperise. Ne shenje solidariteti me Ded Gjon Lulin vellezerit Coku marrin pjese ne kryengritjen anti turke te vitit 1911 Gjeto Coku dergon vellain e tij Ded Coku ne krye te 200 kryengriteseve nga Lezha si dhe dy djemt e tij, Preken dhe Markun qe ishin te inkuadruar ne Malin e Zi, nga ana tjetër vete Gjeto Coku ne krye te 300 malesoreve bregmatas kryengrites me 29 maje te vitit 1911 sulmon forcat turke ne

drejtim te Rriles per te cliruar Lezhen, ne pranveren e vitit 1912 Gjeto Coku me vellan e tij Deden dhe krere te tjer te Bregut te Matit, moren pjes nder kuvendet krahinore, ku si me rendesishmit permenden ai i Zejmenit, dhe ai i Rubikut, ku u vendose qe kryengritja te shtrihej deri ne Durres, me qellim vendosjen atje te flamurit kombetare, ne keto kushte administrata Turke e arreston perseri Gjeto Cokun dhe e dergon ne burgun e Shkodres ku i kishte vdekur edhe Baba i tij, me gjithë kushtet qe turqit i vune per ta liruar asi nuk pranoi dhe pas nje muaji burgim, administrata turke nga friga e pershkallezimit te kryengritjes dhe levizjes se malesoreve e lirone. Sulmet e malesoreve kunder Turqeve nuk reshten derisa me 22 qershor te vitit 1912 Gjeto Coku me te vellan Deden e Llesh Nik Daken, organizuan betejën me te madhe e me te pergjakshme anti turke. Ne bregun e lumit Mat, ku ushtria turke u shpartallua, me 16 gushte po te vitit 1912

Gjeto Coku me te vellan dhe djemt e tij vihet ne krye te betejes se Durresit ku numeri i forcave te drejtuara nga Gjeto Coku perbehej nga 200 persona, qenia ne krye te shum luftimeve nga Cokajt si dhe ngritja e flamurit tone kombetare ne dhjetor te vitit 1912 nga Gjeto Coku e Ded Coku ne Lezhe, si perkrahja qe ata i dhan qeverise se Ismail Qemalit bene qe Gjeto Coku te zgjillej kajmekam i Lezhes ose Kryetari i Qeverise se Lezhes, nga dhjetori i vitit 1912 deri ne tetor te vitit 1913.

Qeveria e kishte kete perberje, Gjeto Coku kryetar qeverie, Ded Coku zv. kryetar, e pastaj, Frrok Ded Bajraktari, Kol Toma, Vat Marashi, Gjin Pjeter Previzi, Tom Pjeter Bajraktari, Gjok Murri, Xhemal Bregu, Lush Llani, Gjergj Sokol Malaj, Murr Koleci, Zef Xhuxhi, Kasem Kadia, Ahmet Osmani, Haxhi Ahmet Likaj, dhe Kol Gjok Doda, ishin anetar te kuvendit per nje vite aktivitet ky kuvend eshte mbledhur tre here, Rritja e autoriteti te Qeverise se Lezhes si dhe bashkimi i tyre me qeverin e perkohshme te Vlores nuk u prit mire nga Esat Pash Toptani qe kishte formuar Qeverin e Durresit, si dhe nga Preng Bib Doda i Mirdites qe donte te krijonte nje kanton katolik ne Mirdite e veri te Shqiperise. Ne nje takim kreresh




te zhvilluar ne Lezhe ne mese kreut te qeverise Gjeto Coku dhe Preng Bib Dodes e Gjon Marka Gjoni, perfaqesues te Mirdites Gjeto Cokut iu propozua nga keta te fundit qe te shkeputej nga Qeveria e Vlores dhe Ismail Qemali dhe te bashkoj me ta per te formuar principaten Lezhe, Puke, Mirdite te drejtuar nga Preng Bib Doda, Gjeto Coku i kundërshton dhe nuk pranon, dhe ja c fare ndolle me 7 tetor te viti 1913 Kajmekami i Lezhes Gjeto Coku po kalonte uren e Lezhes se bashku me baronin Nopca pa pritur dhe pa menduar qellohet me dy plumba pistolete, vrasesi ishte Preng Gjakova nje Mirditor dale ne Gjakove e kthyer aso kohe ne Xhandarmarin e Lezhes, jo pak muaj me vone Malesoret vrasin Prek Pashen e Mirdites, pore fatmiresisht dhe burrisht fale burrave te urte e te zghuar, dhe miqesis qe Cokajt kishin me Mirditorët gjithcka perfundoj ketu, dhe kurre nuk u kthye ne nje hakmarrje te metejshme Malesi- Mirdite. pase vrasjes se Gjeto Cokut me vendim te Qeverise se Vlores ne krye te Qeverise se Lezhes eshte vendosur vellai i Gjeto Cokut edhe si ishe zevendes i tij Ded Coku.

### DED COKU NDERI I KOMBIT

Ded Coku ka lindur ne vitin 1870, ne Shen-

Me rastin e përvjetorit të pavarësisë së atdheut, në vitin 1982 Presidiumi Kuvendit Popullor e dekoroi Gjeto Cok Prekën me "Medaljen e trimërisë për veprimtari patriotike".



koll te Bregut te Matit, figure me permasa kombetare, 16 vjec vendose pushken ne krah dhe lufton kunder cetnikeve Malazez e kunder turqeve per lirine e Shqiperise. Ishte i biri i atdhetarit te shquar Cok Prekes dhe vellai i luftetareve dhe patrioteve Mash e Gjeto Coku.

Ded Coku mori pjese ne kryengeritjen e Malesise se Madhe perkrah Ded Gjon Lulit ne vitin 1911,

deshmi per keto akte flasin jo vetem deshmi por edhe dokumentat historik si dhe fotografite ku Ded Coku eshte gjithnje perkrah Ded Gjon Lulit, ishte pjesmarres ne te gjitha kuvendet patriotike krahinore e nderkrahinore si dhe ne kuvendin e Dheut. Ded Coku ka organizuar tre kuvende ne Bregun e Matit, me kreret e kesaj krahine si dhe asaj te Mirdites, Ktheles, Kurbinit e Malesise se Lezhes me te cilet ka krijuar edhe te Beslidhurit ne kuvendin e Zejmenit 1912, te cilat luajten nje role te rendesishem per bashkerendimin e veprimeve kryengeritese te ketyre krahinave ne vitet e pavaresise, se bashku me Gjeto Cokun e Llesh Nik Daken organizuan kryengeritjen e 22 qershorit ne Breg te Matit, e cila ishte beteja me e pergjakshme ne kuadrin e kryengeritjes se pergjithshme te vitit 1912 ku mbeten te vrare 17 luftetare

te cilet jane Nikoll Miri, Pjeter Miri, Gjergj Nikolla, Mark Ded Ndoka, Mirash Ujka, Haxhi Cari Djala, Kol Lek Bori, Pjeter Bici, Llesh Sokoli, Ded Marashi, Gjelosh Delia, Preng Nikolla, Mark Daka, Dil Daka, Vake Daka, Mar Daka, Vat Llesh Daka. Ndersa Tabori iTurgut Pashes eshte spartalluar plotesisht, sipas at Gjergj Fishtes Ded Coku eshte edhe Kryetar i ekspedites se Durresit Gushte 1912 ku dhe eshte plagosur, per te vendosur atje flamurin shqiptar, merr pjese me te vellane Gjeton ne vendosjen e flamurit kometar ne Lezhe dhjetor 1912. Po ne vitin 1912 me te Beslidhurit lufton kunder ushtrise se Esat Pashes, ne Koder-Pllane, qe po vraponte drejt veriut. e kjo ndolle ne muajin shtatore 1912

Merr pjese ne kuvendin e Rubikut me 1 dhjetor te vitit 1912, eshte pjestar i ngritjes se flamurit tone kombetar atje, se bashku me kreret e Mirdites,

Me 3 dhjetor 1912 Ded Coku me te vellan Gjeton e me kreret e tjer te Bregut te Matit, Lezhes, Zadrimes e Malesise se Lezhes ngren flamurin ne Lezhe. Menjeher, ne kuvendin me te formohet Qeverin e Lezhes, ku Ded Coku zgjillet zv. kryetar i kesaj Qeverie. duke u bashkuar me qeverin e Ismail Qemalit.

Me rastin e nje vjetorit te Pavaresise se Shqiperise me 28 nentore 1913, Ded Coku ftohet nga Ismail Qemali ne Vlore dhe pritet me respekt dhe nderime te larta, gjithashtu ate dite Ismail Qemali ne prani edhe te Ded Cokut ka pritur edhe konsujt e Italise, Austrise, dhe Bullgarise. Lufton me forcat Serbo -Malazeze gjate vitit 1913, per te mbrojtur flamurin e Shqiperise. Pase vrasjes se vellait te tij Gjeto Coku Ded Coku eshte kryetar i qeverise se Lezhes deri ne vitin 1915 vite kure serbo -malazezet pushtuan Lezhen. Merre pjese ne lufte kunder rebeleve turkomane te Haxhi Qamilit, per mberojtjen e Princ Vidit maje qershor te vitit 1914, lufton perkrah Frrok Ded Bajraktarit. Merr pjese ne Kongresin Kombetar te Lushnjes, me 21 janar te vitit 1920 i cili mori vendime te rendesishme per fatet e shqiperise, ku eshte zgjellur anetar i keshillit kombetare te ketij kongeresi.

Ne vitin 1923-24 e gjejme ne veri te shqiperise per mberojtjen e kufive te Vermoshit, perkrah Prek Cakit e Uc Turkut. Perkrah opoziten dhe merre pjese ne levizjen e qershorit te vitii 1924, qe



SKULPTORI VASIL RAKAJ GJATË PUNËS PËR REALIZIMIN E BUSTIT TE DED COKUT

ullhiqej nga Fan Noli, Luigj Gurakuqi e Bajram Curri. Arrestohet nga qeveria e Zogut ne vitin 1925 si kryengerites. Falet po nga kjo qeveri, me rastin e 15 vjetorit te pavaresise ne vitin 1927 si kontribues ne luften antiosmane per pavaresin e atdheut. Ded Coku Zgjidhet Nen Prefekt i Lezhes ne vitin 1937. Po kete vit, per veprimtari fetare dhe si i krishtere i devotshem, emerohet ne krye te delegacionit te katolikeve te veriut per te vizituar Selin e shejte ne Rome, ku takohet me Papen. Dhuron toke dhe ndihmon me materiale per ngritjen e shkollës se re te Shenkollit aty ku ajo ndollet edhe sote. Zgjidhet dy her deputet ne parlamentin shqiptare ne vitin 1922 si dhe ne parlamentin e pare etnik shqiptare ne vitin 1943. Merr pjese ne te gjitha kuvendet nacionaliste per te organizuar rezistencen antikomuniste. Dergon 300 forca per te ndaluar marshimin e komunisteve ne Perlat, ne gushte te vitit 1944 Merret veshe me ta, pasi Partizanet ben te ditur se luftonin per Shqiperi dhe Flamur, dhe u hape rruge pa shkrepur asnje pushke. duke ndaluar vllavrasjen pore megjithkete qe Ded Coku beri. Arrestohet ne Dhjetor te vitit 1944 dhe pushkatohet me 22 gushte te vitit 1945 ne qender te qytetit te Lezhes,

si antikomunitë ne moshen 75 vjecare, dhe duke thene rrofte flamuri, rrofte shqiperia. duke u bere keshtu i treti vella i vrare, dhe i katerti i Cokajve po te kemi parasyshe edhe vdekjen e babait te tyre Cok Prekes ne burgun e kalase se Skodres ne kohen e Turqise, dhe qe jane vrare nga tre Shtete, Coku nga Turqia, Mashi djali i tij i mall nga Mali i Zi dhe fatkeqesishte dy djemt e tjer te Cok Prekes Gjetoja dhe Deda nga Shqiptaret.

Ded Cokut I jane dhene disa vlerisimesic jane Dekorata e dhene me Urdher Trimerie nga Perandori i Austro- Hungarise Franc Jozef ne vitin 1914 ku Ded Coku ka qe nje nga anetaret e delegacionit Shqiptar ne Vjen. Gjithashtu djali i Ded Cokut, Sokol Coku ka vuajtur 4 vite burg ne kohen e rregjimit komunist ne Shqiperi. Ded Coku eshte vleresuar nga komisioni is Vleresimit te Figurave dhe Shoqata e ishe te perndjekureve dhe persekutuareve Politik, Ded Coku eshte shpallur Qytetar Nderi I

Qarkut Lezhe . Nga ishe presidenti i shqiperise Bamir Topi i eshte dhe Medalja e Arte e Shqiponjes. Per te mberritur ne viti 2015 kohe kure Ded Coku eshte nderusr me titullin me te larte Nderi i Kombit.

# Mirash Ivanaj, ministri i parë nga Malësia e Madhe që vuri themelet e arsimit kombëtar shqiptar

IN MEMORIAM



Nga Ndue Bacaj

**T**reva etnike shqiptare e Malesisë Madhe ka një histori lavdi-plotë luftrash e qendreses në mbrojtje të trojeve të veta nga pushtues e shoven fqinjë, por ka edhe një histori të tillë të beses, burrisë, bujarisë, urtësisë e mbi të gjitha të intelektualizmit me permasa kombetare, ku njeri ndër intelektualët më të shendritshëm malësor është padyshim mesuesi, juristi, publicisti dhe ish ministri i arsimit Mirash Ivanaj, i cili vuri themelet e arsimit shqiptar kombëtar. Mirash Ivanaj lindi më 12 mars 1891 në Podgoricë, ishte djali i Dodës dhe i Zogës, që patën ardhur në Podgoricë nga fisi i njohur i Bëkajve të Trieshit, për arsye se Dodë Ivanaj (babai i Mirashit) ishte denuar tri herë me vdekje nga qeveria turke.. Familja Ivanaj ndër mote kishte qenë e përmendur në luftrat për liri dhe identitet kombëtar, kundër pushtuesve osman dhe shovenëve malazez. Nga kjo histori lufte e qendrese po kujtojmë se baba dhe axha i Mirashit, Dodë Ivani dhe Lekë Ivani ishin njohur si luftëtar trima, që nga viti 1878 nën udhëheqjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, dhe mbi të gjitha ishin dalluar në kryengritjen antiosmane të vitit 1911 të udhëhequr nga kreshniku i shqipatrisë Dedë Gjon Luli. Por edhe pas kesaj Doda e Leka deri sa kishin qenë gjallë kishin



PROF.DR.MIRASH E PROF.MARTIN IVANAJ, TIRANE 1930

**E PAVARUR, INFORMATIVE, HISTORIKE DHE PATRIOTIKE**

qenë pushkë e ngrehur në mbrojtje të lirisë e identitetit të trojeve shqiptare. Vellezrit Dodë e Lekë Ivani ishin shquar jo vetem për trimeri, por edhe për besë, urti, burrni, bujari dhe harmoni të pandarë vëllazërore e shoqërore, aq sa kur dy vetë shkonin shumë mirë si vëllezer apo shokë u thonin se shkojnë mirë si Doda e Leka.. Vlenë të theksohet se si shumë shqiptar atdhetar edhe Doda e Leka kishin qenë halë në syrin e pushtuesve osman e veçanarisht të atyre serbo-malazez të cilet Lekë Ivanit i pergatiten një “fat” tragjik. Ndersa djali i madh Dodës (vëllai i Mirashit), Zefi, vdes nga helmimi në vitin 1911, kur sapo kishte mbushur 26 vjeç. Në këtë ambientin familjar dhe atdhetar u rritë dhe mori edukaten e parë njerzore e shoqerore Mirash Ivanaj. Familja Ivanaj, ishte një ndër familjet malesore që e kishin kuptuar se atdhetarizmi shqiptar kishte nevojë jo vetem për pushkë, por edhe për pendë e dije. Për tja arritur ketij qellimi Dodë Ivani, djemt e tij Mirashin dhe Martinin pasi kryejnë shkollën fillore... në Potgoricë i dergon të ndjekin gjimnazin klasik të Pozharovacit (në juglindje të Beogradit). Këtë shkollë vellezërit Ivanaj e mbaruan me rezultatet

të shkëlqyera në fund-gushtin e vitit 1912... Në vitin akademik 1912-1913 Mirashi me të vëllanë Martinin do të ndjekin kursin e filozofisë në Universitetin e Beogradit. Pasi klima politike ndaj Shqipërisë u ashpersua akoma më shumë, Mirashi me të vëllanë do të shkonin në Itali ku do të studionin në Universitetin e Romës. Në këtë Universitet vellezërit “Ivanaj” do të dalloheshin nga të gjithë studentet e tjer të cilet ishin thuajse nga e gjithë “Bota”. Vlen të kujtohet se në vitin 1915 Mirash Ivanajt i vdes babai. Ndersa kur bursa nuk u mjaftonte vellezerve “Ivanaj” me interesimin e mikut të tij, Demir Vilës, mbas ngjarjeve të 1920, ministri i arsimit Sotir Peçi merr përsipër dhe i ndihmon. Ndersa Mirashi pëson edhe një “traumë” tjetër pasi i vdes edhe e dashura e tij zemrës, fotografinë e së cilës e ruajti deri në fund të jetës. Megjithë keto veshtirsi e fatkeqësi Mirashi nuk u “dorzua”, por u laureua shkëlqyeshëm në dy degë, Filozofi-Letërsi dhe Jurisprudencë. Puna e tij e zellshme, e përkushtuar prej 8 vitesh studimi intensiv dhe shumë të suksesshëm u finalizua në vitin 1921 me mbrojtjen e tezës me temë: “Nga historia e gjuhës shqipe në marrëdhënie me gjuhët e vjetra”. Ky është

rasti i parë kur gjuha shqipe bëhej objekt i diskutimeve shkencore universitare. Studimi i paraqitur nga student shqiptar u vlerësua me maksimumin e pikëve, 110 nga 110 pikë si dhe me lavdërimet si një punë e vërtetë dhe e mirëfilltë shkencore (vero e proprio lavoro scientifico). Me një vullnet të admirueshëm dhe punë të palodhur ai arriti të mbyllë edhe studimet për drejtësi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Romës brenda dy viteve. Teza e tij e diplomimit ishte: “Kodi i Stefan Dushanit” që i përkiste shekullit të XIV. Mbrojta ishte një sukses tjetër madhor i Mirash Ivanajt. Ajo u zhvillua në sallën e Madhe të Universitetit ku merrnin pjesë të gjithë profesorët e Fakultetit Juridik. Në përfundim të mbrojtjes kryetari i komisionit të diplomimit deklaroi vlerësimin maksimal 110 pikë me lavdërimë (cum laude). Lajmin e mbrojtjes së diplomimit të Mirashit e dha edhe gazeta e përditshme e Romës: “Il nuovo Paese”, e cila informoi lexuesit Italian për suksesin e merituar të studentit shqiptar. Arritjet e studimeve të tij në Universitetin e Romës e bënë atë të njohur në rrethet intelektuale italiane. Me mbarimin e studimeve atij (dhe vëllait Martinit) i erdhën disa herë propozime për ta emëruar si asistent në Universitetin e Romës si dhe në disa poste të larta të shtetit Italian. Por Mirashi e kishte marrë vendimin e tij të prerë: do të kthehej në Shqipëri. Ai thoshte: “Dëshira ime ka qenë dhe asht me i shërbye me çfarëdo mënyrë atdheut, për të mirën e të cilit nuk paraqes e as do të paraqes kondita”. Kështu Mirash Ivanaj kthehet në Shqipëri në korrik të vitit 1923 me dy diploma universitare të vlerësuar shkëlqyeshëm në Universitetin e Romës, vjen në atdheun e tij një intelektual që edhe vendeve më të përparuara rrallë se mund t’i vijnë një herë në disa dhjetëvjeçar. (<http://www.tiranaobserver.al/homazh-per-mirash-ivanaj/> Nga prof. dr. Dritan Spahiu, dt. 12/03/2015). Gjatë kesaj kohe Mirash Ivanaj kishte arritur të mesoi edhe gjuhët : sërbiisht , italisht, rumunisht, bullgarisht, gjermanisht, frangjisht ; si dhe gjuhët e “vdekura”: latinisht , greqishten e vjetër, sanskritisht e tjer.. Mbas kthimit në Shqipëri Mirash Ivanaj me të vëllanë Martinin dhe bashkë me kushëririn Nikollë Ivanajn themeloi një gazetën atdhetare “Republika”. Vetë



emertimi “Republika” dëgjohej për herë të “parë” në Shqipëri, dhe shënonte një lëvizje, që sipas shprehjes së Ivanajt “për një trajtë regjimi të të gjitha klasave që përbajnë një shtet”. Gazeta kishte si ideator e drejtor Mirash Ivanajn, i cili ishte edhe autor i mjaft artikujve domethenës të kohës, por ai bente edhe punën e redaktorit, radhitësit, korrektorit e deri edhe atë punëtorit të shtypshkronjes. Gazeta “republika” doli me divizën e “huazuar” nga Mazzini “Republika asht e vetmja trajtë ligjore dhe logjike qeverimi”. Gazeta u botua në 30 numra dhe tematikën e saj ishte konformë problemeve dhe halleve që “mbizotronin” në jetën e shqiptarëve. Që në numrin e parë (tetor 1923), në gazetën “Republika” shpalohej një program me 11 pika, ku në pikën e parë shkruhej “Shkollat fillore dhe të mesme vetëm në dorë të shtetit”. Per këtë program pati shumë polemika me klerin e tre besimeve... Mirash Ivanaj ishte njeri nga ata intelektual që kishte dënuar Kongresin e Durrësit dhe traktatin e fshehtë që u bë me qeverinë italiane me 20 gusht 1919, kritikon Kuvendin Kushtetues me 318 anëtarë ku shumë prej tyre me shkollim gjysmak. (Gazeta “Republika” nr.8 e dates 23.12.1923).

Revolucionin e qershorit të vitit 1924 Mirash Ivanaj nuk e perkrahu, dhe per këtë e la Shqipërinë dhe u strehua në Podgoricë. Mbas deshtimit të këtij revolucionin në vitin 1925 Mirash Ivanaj u kthye në Shkodër, ku fillon të punojë si avokat. Ndersa me dt.10 shkurt (1925) fillon punë edhe në gjimnazin shtetëror të Shkodrës.... Mirashi edhe si profesor e si drejtor në gjimnaz do të ishte një edukator i shquar. Ai ishte një “partizan” i teorisë pellazgjike... Një nga nxënësit e tij të degës normale në Licé, Rrok Zojzi tregon ; mbasi na ndau diplomat dhe na përshëndeti në ceremoninë e rastit, drejtori tha: Kjoftë livdue Jezu Krishti. Dikush muer guximin dhe reagoi, por ai me atë taktin e tij foli si me shokun e vet: Po unë nuk jam shfaqë kurrë kundër fesë...( Teacher education in the Euro-Mediterranean region Author Ronald G. Sultana Editor Ronald G. Sultana Publisher P. Lang, 2002 ISBN 0820462160, 9780820462165 p. 30). Drejtor Mirash Ivanaj ndaloi përdorimin e fesit gjatë mësimit, gjë që cënonte dhe marrëdhënjet normale me të krishterët. Në mendësinë e qytetit u

krijua bindja se në shkollën e Ivanajt nxënësit nuk prisheshin nga feja e nga morali. Ishte kjo bindje që bëri prindërit katolikë me çue fëmijët pa rezerva, bile edhe duke i lëvizë nga shkollat private. Ndërsa muslimanët duke përdorë një “argument” që atëherë qarkullonte si thashethem, se kur trupat e revolucionit të 1924 shkuan në shtëpinë e Mirashit atë e gjetën hapur dhe mbi shtrat gjetën Kuranin. Pjestarët muslimanë në komisionin e kontrollit menduan se ky i krishterë donte të bëhej musliman... ndërsa në të vërtetë ai po studjonte ndikimin e të Drejtës Romake në librin e shenjt musliman. Me reformat që aplikoi në administrimin e shkollës, i rritën prestigjin sa që kur ishte bërë drejtor ai me 1925 kishte pasur vetem 83 nxënës ndersa kur e dorëzoi në tetor 1930,

gjimnazi kishte arritur të kishte 280 nxënës....Pas kesaj Mirashi u emrua mësues në Tiranë ku drejtor ishte Karl Gurakuqi. Banonte në kat të dytë te rruga e Pishës me të vëllanë. ([https://sq.wikipedia.org/wiki/Mirash\\_Ivanaj](https://sq.wikipedia.org/wiki/Mirash_Ivanaj)). Pasi vdiq Hilë Mosi, kryeministri Pandeli Evangjeli me datën e 11 janar 1933 i ngarkuar të formonte kabinetin e ri, i paraqiti të nesërmen mbretit Ahmet Zogu listën e ministrave ku Mirash Ivanaj figuronte Minister i Arsimit.. Mirash Ivanaj si Minister i Arsimit ndërmorri disa reforma për të homogjenizuar gjendjen e arsimit në vend. Nisi të shtetëzonte shkollat e huaja dhe qeveria Shqiptare u vu nën presion për politikën e saja, në veçanti nga qeveria e Italisë fashiste, greke e tjer.. Në shtator të 1934 paraqiti ligjin e ri për arsimin, duke bërë 5 vjeçaren e fillores të



detyruar. Mirash Ivanaj krijoi gjithashtu institute edukuese dytësore të ndryshme. “Ligji i Arsimit”, u paraqit edhe me nofkën “Ligji Ivanaj” ishte ligji më i rëndësishëm e më i plotë i kohës. Qëllimi i tij ishte të krijonte dhe integronte sistemi e arsimit kombëtar në Shqipëri. Me zbatimin e këtij ligji u suprimuan 17 shkolla të komunisteti katolik, 14 shkolla të komunisteti musliman, 4 shkolla të komunitetit ortodoks, 10 shkolla private të komunitetit ortodoks, si dhe 19 shkolla të huaja e tjer..

(Foundation [https://sq.wikipedia.org/wiki/Mirash\\_Ivanaj](https://sq.wikipedia.org/wiki/Mirash_Ivanaj)). Mirash Ivanaj me datën 16 gusht 1935 jep dorëheqjen e parevokueshme në shenjë proteste ndaj “kapitulimit” të shtetit në çështjen e shkollës kombëtare. Më pas, Mirash Ivanaj vazhdon detyra të tjera në arsim dhe si këshilltar i mbretit Zog I, deri sa me 27 janar 1937 kur emërohet kryetar i Këshillit të Shtetit, detyrë që e vazhdon deri me 7 prill 1939, kur së bashku me miqtë e tij organizoi studentët shqiptarë në protestat kundër pushtimit italian. Pas kesaj Mirash Ivanaj së bashku me të Vëllan e tij Martinin largohet nga Shqipëria, ku kalon nëpër Greqi e perfundon në Stambollë, ku kalon një jetë plotë vuajtje dhe mundime, duke huambur edhe vëllan... Pas çlirimit të Shqipërisë Mirash Ivanaj shpreson e beson për një Shqipëri të lirë e demokratike, ndaj për këtë ai bënë kërkesë të kthehet në Shqipëri. Kërkesa ju plotësua me 30 gusht 1945. Mirash Ivanaj me të mbërritur në Shqipërinë ku tashmë sundonin komunistet, ai si intelektual me formim perëndimorë e kupton se jeta nuk do të ishte e “lehtë” siç e kishte menduar, por dashuria për Shqipërinë (e mbetur pas kongresit të Berlinit 1878 dhe konferencës londres 1913, ku fqinjët kishin grabitur shumë

troje shqiptare, duke përfshirë edhe ato të Trieshit tij) e bënë të punonte pa u lodhur në arsim, edhe si mesues i thjeshtë. Kthimi i Mirash Ivanajt në Shqipëri për hirë të vertetes duhet thënë se në fillim u pritë mirë nga qeveria e kohës, këtë e tregon edhe pritja që i bënë Mirash Ivanajt vetë Enver Hoxha. Por megjithë këtë pritje dhe afrimin e punëve (të niveleve të ulta për personalitetin e Mirash Ivanajt), ai ishte gjithnjë i dyshuar, pasi ishte shkolluar, formuar dhe edukuar si intelektual Perëndimor. Me datën 15 maj 1947 Mirash Ivanaj arrestohet, dhe pasi e mbajnë rreth një viti në hetuesi e denojnë me 7 vite burg

me akuza false. Këtë e tregojnë pyetje dhe përgjigjet në

mes tij e trupin gjykues që e denon: -Mirash Ivanaj - Po për çka jam dënue zotni?. Gjykatësi: -Ti i pandehuri Mirash ke ardhur me mendime e ide që të bësh propagandë kundër nesh (në Shqipëri). -Mirashi - Po a ka ligj në Botë që të dënojnë mendimin.... Shteti komunist këtë menyrë denimi e kishte bërë praktikë “pune”, për të gjithë ata që i kondideronte kundërshtar potencial politik, dhe për këtë po kujtojmë edhe një dialog të një të arrestuar që e mbanin në hetuesi pa akuzë konkrete dhe e pyet hetuesin, se çfarë kam bërë që më keni arrestuar?, dhe hetuesi i përgjigjet, se sipas tejet ne duhet të kishin pritur sa të besh ti diçka kundër nesh e pastaj të arrestojmë, jo më jo ne të kemi arrestuar e do të denojmë, jo për atë çfarë ke bërë, por për atë që ti kishe në mendje të bësh

kundër nesh... Mirash Ivanaj Vdiq me 22 shtator 1953 në Spitalin e Tiranës mbas një operacioni të thjeshtë, vdiq 12 ditë para se të lirohej... (Iljaz Gogaj: Mirash Ivanaj, Tiranë 2004). Trupi i Mirash Ivanajt pas vdekjes thonë se ishte shfrytëzuar nga studentet e mjeksisë deri sa një ditë “mbetjet” e tij u varrosen pa asnjëllpojë cermnie... Mirash Ivanaj ka lënë edhe një vëllim me poezi, “Epopeja e Njeriut” - ku janë dhe poezitë e vëllasë, që dr. Lazër Radi i ka përkthyer nga serbishtja. Në vitin 1995 u hapë fondacioni “Martin and Mirash Ivanaj Foundation”, i krijuar nga mbesa e Mirashit, Drita Ivanaj (e bija e Martin Ivanajt)... Malesia e Madhe sot është krenare për birin e saj intelektual, që ishte jo vetëm ministri i parë nga Malesia Madhe, por edhe për vepren e tij patriotike, ku mbi të gjitha qendron se Mirash Ivanaj Vuri themelet e arsimit kombëtar shqiptar, themelet mbi të cilat qendron edhe sot arsimi në Shqipërinë demokratike...






# Sali Mani këngëtari i kombit

Nga Ramiz Lika

**S**ali Mani u lind ne Gushte te vitit 1944 ne fshatin Duk te Recit te Malesise se Madhe. Qe ne moshe te re u dallua si nje vezhgues i holle i folklorit, e sidomos te treves se tij, ne fillimet e viteve 1960 banoret e Recit e ata te Malesise se Madhe, shikonin nje djalosh te ri, me lahute ne dore tek kendonte kenget Epike te Eposit te Kreshnikeve. Zeri dhe virtuziteti i djaloshit, do te terhiqte menjeher vemendjen ne Malesin e tij te dashur, e ne te gjitha krahinat e atdheut e me pase ne tere universin ku jetonin shqiptare ne disa kontinente. Sali Mani kendonte kenget e Eposit te heronjeve te te gjitha kohrave, i kendonte Atdheut, Kombit, Flamurit, e per me teper shkruante vete tekste e bente muziken. Ne vitin 1966 merr pjese ne festivalin e pare kombetare ne Qytetin



PORTRETI



e Elbasanit, duke u paraqitur si kengetare dhe instrumentiste virtuozë, jo vetëm me lahuten klasike por edhe me Cifteli. Eshtë për tu theksuar fakti se kengetari, poeti, e kompozitori i ri, qyshe në hapat e para të krijimitarise së tij, u shqua për pathosin e tij patriotik. Motivi atdhetarë ishte paresorë qyshe kure e nisi e deri në vitin 2010 kohe kure u largua nga kjo jetë. Ai merrte pjesë në të gjitha festivalet e or-



**MODERATORI QAZIM ÇELA DUKE PREZANTUAR RAPSODIN POPULLOR, SALI MANI**

ganizuar.

Për Sali Manin atdheu nuk shtrihej nga Vermoshi deri në Konispol, porë qyshe prej Tivarit e deri në Preveze, në Ulqin, Prishtin, Tetovë, Konice e gjithë Camerine. Kure kendonte Bardi i ri, perloteshin syte e atdhetareve, ngrihej patriotizmi dhe zgjohet nga gjumi rrebelimi ndaj pushtuesve greko-serbe.

Për këte nuk vonoj shumë dhe u pagezua si Kengetari i Kombit. Në vitin 1979 iu dha titulli Artist i Merituar. Deri në daljen e Sali Manit në skenë kenget e lahutes e çiftelise, këndoheshin njëtrajtshëm, dhe me një vijë melodike monotone, të cilat tingellon si recitime të kënduara, kurse Sali Mani krijoi një melos të larmishëm dhe origjinal, duke ofruar për çdo tekst një melodi të vecantë, ai futi refrenin në çifteli duke u bërë reformatori i çiftelise. E temperoi çifteline, që t'i jepte me shumë nota e hapësirë muzikale, pra bëri ndryshimin krijoi modernën sa e lejonte koha në të cilën jetohej kure dihet se ishte ajo në regjimin komuniste. Shumë shpejt dhe sipas ndryshimit që Sali Mani bëri, e gjithë plejada e rapsodeve dhe kengetareve të veriut të shqiperise, filluan të këndonin sipas stilit që ai reformoi. Ka krijuar me tekst e Melodi 1300 kënge. Përvec titullit Artist i Merituar . Sali Mani është shpallur edhe Qytetare Nderi i Qytetit të Koplikut qender e Malesise së Madhe, ku ai ka jetuar e punuar jo pake vite, Qendera Kultururo e Malesise së Madhe mban emrin Sali Mani, gjithashtu është formuar dhe vazhdon veprimtarinë e sajë Shoqata Sali Mani me qender po në Qyteti e Koplikut, kaqë atdhetarë ka qenë dhe mbetet Sali Mani ku në luftën- Clirimtare të Kosovës, ka dërguar njerin nga djemt e tij, Artanin i cili ka luftuar për krahu UCK-së me batalionin Atlantiku. pasë vdekjes së parakohshme të Sali Manit janë jo të pakët kengetarët dhe rapsodët, nga shqiperia dhe kosova të cilët i kanë kënduar dhe kushtuar, disa kënge atij, si për shembull Shaqir Cervadiku, vellezerit Paloka, Nik Carku, Fran Kodra e Ndue Shytani, Han e Kol Nikprelaj, Jonuz Delaj e tjer, para pak kohësh edhe Ilir Shaqiri e Nikoll Nikprelaj duke e kujtuar përjetësuar e vlerësuar me një Balad. gjithsesi Sali Manit populli i vet ia ka dhënë titullin Kengetari i Kombit ndërkohe që i mbetet Presidencës së Republikës së Shqiperise



**SALI MANI ME NJË TJETËR FIGURË TË RËNDËSISHME TË TRADITËS KOMBËTARE, RAPSODIN FRROK HAXHIA**

që ta vlerësojë edhe me titullin Nderi i Kombit. E një veprim të tillë duhet ta bëjë edhe presidenca e Kosovës të cilës Sali Mani i këndoj aq shumë dhe që në vitet 1980 duke paralajmëruar, me zërin dhe çiftelin e tij, formimin e një ushtrie Clirimtare. Sali Mani ka kënduar përpara të gjithë shqiptarëve të botës, ai ka kënduar në Zvicër në Gjermani, në Angli, e vende të tjera të Europës, si dhe në Kanada e Amerikë ku ka kaluar edhe vitet e fundit të jetës së tij, duke u njohur nga aferë e mallur me çdo shqiptarë kudo ku jeton. E vecanta e Sali Manit ka qenë dhe mbetet se ai u ka kënduar të gjitha kohërave dhe personaliteteve historike shqiptare, duke filluar me eposin e kreshnikeve e deri në ditët tona.

# Gjergj Kalaj, patrioti i paharruar

Përgatiti: Dede Kole Miri Dedvukaj

**M**alesia po i jep nderimin e fundit birit të vetë Gjergj Markut Kalaj, i cili u lindi në fshatin Pikale, të kësaj Malësie, para 67 vitesh. Malesia po e qanë me lotë në sy dhe dhimbje në zemër këte burrë,

Malesia e Madhe dhe Diaspora shqiptare, po ndahen nga fisniku i fisit Kalaj, sot Mali i Deciqit dhe maja e Bratiles së Flamurit të heroit kombëtar Dede Gjon Lulit, po përcjellin atdhetarin e pashoq, i cili kurë nuk u ndal së punuari për shqiptari. Diaspora shqiptare po i thotë lamtumirën e fundit patriotit të vertetë, ideatorit dhe punëtorit me zemër e shpirt për Shqipërinë etnike. Ishte patriot me vepra e jo për të lavdëruar apo imponuar. Kryente punë kombëtare në heshtje e jo me zhurmë. I ketill ishte në rini, e kështu mbeti edhe në moshën e burrave. Kurë nuk kanë arritur që të ja nderojnë mendjen dhe qenderimet e tij për Shqipëtarë. Të ndjerin Gjergj, padrejtësit fillojnë të prekin si nxënës të Gjimnazit në Ulqin. E braktisi shkollën si maturant dhe në vitin



1969 mërgoi në SHBA, porë pa i harruar asnjëherë të afermit, familjarët, dhe Malesinë e Shqiptarin, deri në marsin e vitit 2016, e për të kthyer persëri në Malesinë e amanetit të vetë, me bindjen se vetëm në këte dhe, duhet shijuar jeta e pa amshueme.

Me lartësinë e tij trupore që ia kishte falur zoti. Gjergj Kalaj mbante lartë Flamurin e Gjergj Kastriotit, Dede Gjon Lulit, e Adem Jasharit. Nga ky flamur nuk do të ndante as vdekja, pasi edhe sote trupin dhe arkivolin e tij po i mbulon flamuri ynë kombëtarë, shtëpia e Gjergj Kales në SHBA ishte dhe mbeti shtëpia e takimit dhe strehimit të aktivistëve shqiptarë, dhe shtëpi e mikpritjes fisnike Malësore.

Bashkeshortja e të ndjerit Gjergj, Gjyftja me të me të afermit e sajë dhe të bashkeshortit, si dhe me dashamirësit dhe shokët e burrit nga diaspora, Gjergj Kales po i plotësojnë dëshirën e fundit nga kjo jetë-po e varrosin në varrezat familjare, këtu në Malësi.

Gjergj Kalaj, nderroi jetë për të jetuar veprimtaria e tij, Vlerësimi i punës dhe aktiviteti i tij kombëtarë, sepse ai për një gjysëm shekulli luftoi me gjithë forcën që kishte, për lirin e Shqiptarëve dhe krijimin e kushteve me të mira për jetesë.

Ja filloi në demonstratë dhe pothuajse nuk mungoi në asnjë që u organizua kundër regjimit komunist të ishë Jugosllavisë, kundërshtoi pushtetin policor të Serbisë dhe represionet e tyre ndaj popullit liri-dashës shqiptarë të Kosovës, dhe enderra



e tij për shtetin e pavarur të Kosovës, ju bë realitet, Gjergj Kalaj për të cilin dhe për hirë të së vertetës, duhet thënë se ka qenë edhe mikë i Enver Hoxhës dhe i politikës së tij, porë pa u perzier dhe pa u perlyer, në azgjë, dhe në asnjë rastë me vrasjet që komunizmi kryente aso kohë në shqipëri dhe jo vetëm. Ishte shumë aktiv edhe në vitet 1990 gjatë proceseve të demokratizimit të Shqipërisë. Këtu mbetet për të përmendur pritja që ai i ka bërë ishë presidentit të parë të shqipërisë Ramiz Alia gjatë vizitës së tij në SHBA vizitë që aso kohë ka patur shumë ndikim për demokratizimin e mëvonshëm të shqipërisë. dhe i tillë mbeti deri në ditët e fundit të jetës së tij, vecanarishtë për fitimin e të drejtave të popullsisë shqiptarë në Malin e Zi. Me gjithë shpirt e zemër dontë bashkimin kombëtarë, porë nga ana tjetër ishte edhe i vetdëshëm për pengesat që po i shkaktonin ata që nuk mendonin dhe punonin me koken e vetë, ata që i sherbenin të huajit e jo kombit. I njihë mirë Gjergji të gjithë, se shumë herë kishte kaluar në duart e tyre. Duket se zemra e madhe dhe e fortë shqiptarë dhe

patriotizmi i tij kombetar, i kishte nervozuar shume ata qe kishin marre detyren per te perjellur punen dhe aktivitetin e Gjergj Kales ne demonstratat anti-jugosllave. dhe kunder regjimeve anti shqiptare, u kishte ra ne sy atyre qe moren detyren e ndeshkuesit, per ta torturuar, e bile edhe sa here vizitonte te afermit e tij ne Malesi. Te gjitha keto Gjergji i perballoi dhe se ndalen ase ata qe e torturuan fizikisht psikikisht, gjate veprimtarise se tij patriotike.

Ndoshta ata mendojne se jane te gjalle pore per Gjergjin dhe te gjithë , kane vdekur, ashtu sic e meritojne vdekjen ata qe punojne dhe veprojne kunder popullit te vete. Vendin dhe karrigen e Gjergj Kales ne shoqaten Malesia e Madhe ne New York do te jete e veshtire per ta zevendesuar dikush, nderkohe qe zbraztesia qe ai na krijuar ne zemrat tona do te mbese e perjetshme.

**EJLLO BERISHAJ**  
**Kryetar i Shoqates Malesia**  
**e Madhe New York**



## Elegji për mikun tim Gjergj Mark Kalaj

Autor: Luigj Gjokaj, Sekretar i Shoqatës, Malësia e Madhe Miçigen

Ne New York c ka ba vaki  
 Krejt Malesoret vesh ne zi  
 Dhe Diaspora po ban gajret  
 Me telefona e internet  
 E lajmi i zi po hapet shpejt  
 Se Gjergj Kalaj, ka nderrua jete  
 Edhe Malet po ushtojne  
 Ore e zanat po vajtojn  
 Dhe me lote po e lotojne  
 Kte Kreshnik dhe atdhetar  
 Sokol zoti e pati fale  
 Burre fisnik, trim e bujar  
 Ishe me te paret nismetare  
 Per liri e bashkim kombetare  
 Gjake i paster atdhetar  
 Nuk u ndal gjithë jeten e tij  
 Tue ngrit zanin per Shqiptari  
 Sofren shtruar, zemren bujare  
 Me traditat atdhetare  
 Per kosove e shqiperi  
 Larg e ngriti zanin e tij  
 Çka Gjergji bani per Kosove  
 Te gjithë e dine te dalin me fole  
 Si Rexhep Qosja me Adem Demacin  
 Takua i ka ne Amerike

Dhe ne familje i ka prit  
 Si Gjergj Kalaj me tradite  
 Zemra e madhe ketij s ju ndale  
 Ne shpi ka prite edhe gjeneral  
 Gjeneralin Tome Berisha  
 E Akademik si Mark Krasniqa  
 Burra te kombit priste te shpia  
 Deri edhe presidentin Ramiz Alia  
 Si mikprites i pate dale zani  
 Te ky nejtj edhe Sali Mani  
 Burre me zemer e jo me hile  
 I ka dashte miqte e prit ne familje  
 Nikoll Nikprelaj e shum te tjere  
 Te ky burre kane ardh per here  
 Parashqevia e Agim Krajka  
 Gjergji e Gjystja si bjeshket e nalta  
 Kane ardh Agustin e Rifat Berisha  
 Si shume rapsod edhe Gzim Nika  
 E ate burre qe ma t mire se mbante toka  
 Se profesorin Gjelosh Gjokaj  
 Dhe shume biseda me ta i ka ba  
 Me pshtua Malsin nga armiku shkja  
 Edhe nje shok dua me t permen  
 Le e rrite jeni ne nje vende  
 Me te cilin ke ba shume shoqni

Gjoke Martini i thone atije  
 Burre i njoftun per Shqiptari  
 Pore kenka kene thon e vertete  
 Se askushe si ka dy jete  
 E ky vigan ne kte arkivol shtrire  
 Po na thote ne Lamtumire  
 Gjithe ky popull per ty kane ardh  
 Cou e thuajave dy tri fjale  
 S kan durua pa ardh me pa  
 E prej tejet gjithmone me u nda  
 Lamtumir motra e vllazni  
 Lamtumire Malesoret e mi  
 Lamtumir Kosove Kreshnike  
 Lamtumir Shqiperi Etnike  
 Lamtumir Vllazen Shqiptare  
 Kodo jeni ne boten mbare



# Perlat Ramçaj fisniku që i duhej Malësisë

**P**as një semundje të pasherueshme me 22 mars 2016 u nda nga jeta në moshën 65 vjeçare Perlat Rexhep Ramçaj, ish kryetari i parë i zgjedhur me votën e lirë në historinë e Bashkisë Koplë (1992-1996). Perlat Ramçaj nuk ishte thjeshtë kryetari i parë i bashkisë së qytetit të Koplë, si kryeqendër e trevës së Malësisë Madhe në pluralizëm e demokraci, por ishte mbi të gjitha qytetari i parë, që me punën e perkushtimit të tij në këto detyrë fisnike dhe të veshtirë vuri jo vetëm themelet e ndërtimit të një institucioni e qyteti bashkohorë, dhe krijoi edhe modelin e një kryetari dhe drejtuesi shembullor, që votbesimin e popullit e perdori për të shërbyer me fjalë e vepra popullit dhe qytetit që i besoi. Perlat Ramçaj u zgjodhë për të dytën herë kryetar i bashkisë Koplë në vitet 2003-2007, dhe perseri ishte po ai kryetari i parë shembullorë me punë, fjalë e vepra, ishte kryetari, dera e të cilit ishte e hapur “dy kapakësh” për të gjithë pa marrë parasysh bindjet politike.



Perlat Ramçaj edhe pse ishte një ndër antarët e rendesishem të partisë Socialiste, ai në detyren e kryetarit të bashkisë, në detyrat e tjera dhe në jeten shoqerore ishte “thjeshtë” vetvehtja një qytetar model që respektohej dhe respektonte të gjithë ata që e njihnin dhe i njihte, ishte një babaxhan i vertet që njerzit kishin knaqësi ta takonin, të bisedonin, të qanin hallet me të, por edhe të pinin një kafe apo të shoqeroheshin qoftë edhe për pakë kohë.. Perlat Ramçaj ishte një qytetar model dhe një atdhetar i palekundur me të gjitha karakteristikat e malësori të vertet, dhe keto i ka vertetuar çdo njeri që e ka njohur apo ka punuar me këtë burrë fisnik, që fisnikria i kishte hije dhe dukej se edhe ajo vetë fisnikrohej me këtë burr të madh nga shtati, të hijeshem nga paraqitja dhe human nga fjalet e veprat. Per Perlat Ramçajn sado të flasesh apo shkruash është e veshtirë të thuash të gjitha ato vlera e virtyte të mrekullueshme që mbar-te ky burr i Koplikut Malesisë Madhe e më gjerë...Perlat Ramçaj keto virtyte e vlera të mëdhaja njerzore dhe atdhetare nuk i kishin ardhur nga “qielli”, por i kishte fituar e trashiguar nga njeri brez në tjetrin. Të pakten që në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878) dallohet stergjyshi i Perlat Ramçajt, Meto Dema, i cili së bashku me atdhetar të tjer nga Kopliku si Sokol Mustaf Bajraktari, Abdyl Kurti dhe Memë Shabani, si dhe patriot të tjer nga Malesia, Shkodra e më gjerë nënshkruajnë me datën 16 qershor 1878 një Protestë të fuqishme, kunder planit grabitës të kongresit të Berlinit për disa trojeve shqiptare që Europa plakë donte tja jepte Malit të Zi. (më hollesisht mund të shihet në Akte të Rilindjes Kombetare Shqiptare 1878-1912, dok.15, fq.32-37..). Siç dihet kjo proteste si dhe tjerat u shoqerua me luftën mbrojtëse të trojeve shqiptare, ku pjesmarres do të ishte edhe Meto Dema me shoket e tij të atdhetarisë. Por veprimtaria atdhetare e paraardhesve të Perlat Ramçajt nuk mbaron ketu ajo vijon me të gjitha lufttrat mbrojtëse, ku po dallojmë Luftën e Koplikut 1920, ku një ndër luftetaret e njohur të Koplikut në këtë luftë do të ishte gjyshi Perlat Ramçajt, Hajdar Meta, i cili njihet edhe si drejtues i devotshem i pushtetit lokal të atyre kohëve. Gjatë luftës antifashiste (nac-çl.), do të merrnin

pjesë me armë në dorë edhe baba (Rexhep Hajdari) dhe axha (Muç Hajdari). Perlat Ramçaj si trashigimtar i kesaj shtepie dhe ketij fisi është dalluar jo vetem në vitet që ishte kryetar i bashkisë Koplik, por edhe shumë më përpara, kur ai punonte puntor apo drejtues i rendeishëm në ish SMT- n e kohes, në vitet e veshtira të monizmit, ku mbahet mend si një drejtues human, i drejtë, tolerant dhe sfidues i koheve të veshtira kur lufta e klasave ishte forca levizëse e shtetit komunist. Perlat Ramçaj gjatë ketyre viteve të demokracisë ka punuar edhe drejtor i ndermarrjes të kanalizimit të ujrave (bonifikimeve), dhe që nga viti 2013 deri që u nda nga jeta ka qenë drejtori i urgjencave dhe spitalit të Koplikut, ku edhe në keto detyra ka qenë dhe do të mbetet një drejtues model, për nga puna dhe të mirat që u ka sjellur institucioneve që ka drejtuar dhe qytetareve me sherbimet e ketyre institucioneve dhe personalisht të Perlat Ramçajt. I ndjeri Perlat Ramçaj në vitet e demokracisë me

mjaftë sakrificë perfundoi fakultetin e Drejtësisë në Shkodër, si dhe kualifikime të ndryshme që i sherbyen atij për ngritjen e tij kulturore e profesionale, e për rrjedhojë edhe punes tij në favor të qytetareve të Koplikut e të Malesisë Madhe. Emri i mire për punë të mira e të mbara të Perlat Ramçajt prej kohësh i kishte kaluar kufijet e Malesisë e Shkodres, është pikrisht kjo aresyeja që në ditën e varrimit (23 mars 2016), do të merrnin pjesë përveç mijera banorëve që e kanë njohur e kanë degjuar për të, edhe deputet të majtë e të djathtë, kryetari i bashkisë Malesisë Madhe, drejtues të pushtetit, partive të majta e të djathta, e mbi të gjitha në këtë ceremoni varrimi do të ishte i pranishem, kryetari i PSSH dhe kryeministri i Shqipërisë z. Edi Rama. Me vdekjen e Perlat Ramçajt, familja, të afermit, shoket dhe miqtë humben njeriun e tyre të dashur, por edhe Kopliku e Malësia humben një nder burrat më të njohur, më të mirë e më fisnik, vdekja e të cilit ka bërë shenjë në trojet e Malesisë Madhe ...





# Fran Pacaj-Babaj, artisti që u fsheh pas modestisë



Nga Albert VATAJ

**J**o, kurrsesi jo, miku im, Fran Babaj! Nuk duhet të lë që të të shuaj edhe harrimi ashtu siç të fiku vdekja. Nuk e meriton.

## Prologu i një profili të obliguar

“Nji komb qi lindet ka nevojë për fatosa qi t’ desin, por fatosat qi desin nuk kanë se shka bëjnë në nji komb qi i përbuz’e i harron! N’shtete tjera njerzt’ e idealit ne u mbytshin për s’gjalli nderohen për s’dekuni, ndër ne ata mbyten dy herë – edhe harrohen!, shkruan Patër Gjon Shllaku. Edhe personazhi i këtij parakalimi mëtues, përkujtues dhe përunjësish mirënjohës, sintetizohet në fatin tragjik të vdekjes së dyzuar të Fran Pacaj-Babaj.

Ai jo vetëm nuk u nderua por edhe u harrua. Sepsë më së shumti, në një kohë që vulgu dhe perversi propozohen si modele të bashkëkohores; antivlera dhe abuzivja, serviren si arketipe të koherencës; vesi

dhe amoralja trajtohen si virtyte dhe purifikuese, ... nuk ka se si të ndodh ndryshe. Vjen dhe ikën bashkë me rrezëllimin e yllit tënd. Fran Pacaj-Babaj mes gjithë asaj morie, dashamirësish, shokësh, miqsh dhe bashkëpunëtorësh, do të kishte dikë që kurrsesi nuk do të pranonte që gjithçka që Frani ndërtoi me kaq pasion dhe sakrificë, të vdiste së bashku me të.

Unë e ndjej obliguese që ky personazh, ky njeri me dhunti të veçanta, ky talent i ngulmeve të epërme estetike, ky artist që u fsheh pas modestisë, të mos shuhet. Me harrimin ne nuk i mbetemi borxh vetëm Franit, por gjithë asaj galerie të pasur me personazhe, karaktere, tipa dhe profile, që ai jetësoi përgjatë rrugëtimit të tij deri në agimin e kobshëm të 9 marsit të vitit 2014, kur zemra e tij ndali për të mos rrahur më.

## Nga vitet e hershme

Fran Pacaj-Babaj u lind më 6 nëntor të vit 1961 në Vrih të Shkrelit, Malësi e Madhe. Ai erdhi në jetë nga baba Zef dhe nëna Pashke, në një nga fiset më të njohura të Malësisë së Madhe për trimëri, atdhetari dhe bujari. Kujtojmë gjyshin e babës së Franit, Prel Preka i cili ka dhënë jetën në vitin 1912 në luftën heroike të Sukave të Moksetit, në mbrojtje të trojeve shqiptare. Që





fëmijë u detyruar të largohet nga trangu familjar dhe fisnor për shkak të kushteve dhe rrethanave të kohës.

Fati ndoshta nuk do të ishte në anën e tij qysh në çapitjet e para të rendjes. Që në fëmijëri, atë do ta rrisnin dajat për të cilët ai ishte kaq mirënjohës sa i dha atë që do ta bënte të pavdekshme gjithçka ata dhanë dhe bënë për të, mbiemrin. Shumë nga të njohurit nuk kishin dijeni se mbiemri Babaj ishte një huazim nga mbiemri që ai kishte marrë nga daja, i cili e kishte rritur dhe i ishte bërë krah pasioneve të tij. Sikurse të paktë ishin ata që e dinin se kush ishte mbiemri i tij i vërtete, Pacaj. Gjithëpoq Frani gjithnjë u përpoq për të mbajtur jo vetëm një shpirt protagonist, një zell i sfidave të ethshme artistike dhe njëherësh një ngulmëtar për të shndërruar çdo pasion dhe çdo ngul në një triumf artistik. Gjithsesi ai ishte dhe do të mbeste i paharruar, vëllai Pllumi si dhe axha, Gjoni e Prela nuk e harruan dhe nuk do e harrojnë asnjëherë Franin e dashur.

Pas shkollimit në Shkodër fillimet e para si personalitet e artit dhe kulturës Frani i ka në qytetin e Koplikut si punonjës i kulturës. Nga Politika në art dhe nga arti në lëvizjen sindikaliste, ne gjithnjë shohim një Fran Pacaj-Babaj që rrekej të mbetej i tillë, i vensour dhe kërkues, gjithnjë aty ku kishte diçka për të dhënë, diçka për të dëshmuar. Ai mbeti gjithnjë në mes Shkodrës që e lindi dhe e gatoi si personalitetet artistik dhe Tiranës, një

vend mundësish.

### **I besoi kaq shumë ëndrrës, jetoi dhe u shua duke ëndërruar**

“Unë jam një ëndrrimtar. Unë di kaq pak nga jeta reale që unë thjesht nuk mund të ndihmojë t’i rijetoj ato momente si ato në ëndrrat e mia...”, shkruan emblematiku i letërsisë ruse Fjodor Dostojevski.

Vërtetë Frani ëndërroi kaq shumë dhe e dashuroi gjithçka të prekshme dhe ndjesore, me një forcë që vetëm ai mund dhe dinte ta flakërinte në emocionet e tij përjetuese. Jetoi duke ëndërruar dhe ëndërroi me ngulmin e jetësimit të ëndrrave në realen e prekshme, përmes realitetit të një heroikeje.

### **Njeriu tokësor në shpirtin e tij të përkorë**

E përditshmja, nevoja për të bashkëndarë rutinoren me të zakonshmen e ftoi atë shpesh here të ishte i kapur nga vesi, çmimin e së cilës më shumë se askush u desh ta paguante ai. Ndoshta kjo bëri që shumë miq ta kishin të pamundur të ishin të sinqertë, të ndershëm dhe dashamirës me të, siç ai ishte deri në fund me ta. Shumë bashkëpunëtorë nuk nguruan të shpërdoronin mirësinë dhe sinqeritetin e tij, shpirtin e bardhë dhe të dhemshur. E shfrytëzuan dhe e paragjykan, e përdorën dhe nuk e vlerësuan. Për ta gjithçka ishte përfitimi, për atë gjithçka ishte arritja që ëndrra e tij të prekte realen, të shndriste si një dritë hyjnore para ëndjes dhe dëshirimeve të tij si të një fëmije.


Askush në ne nuk mund të përfaqësojë

shenjtoren në tokësoren që jeton dhe bashkëndan me të gjithë, në njerëzoren ku gëlon, të dëshirueshmen për të mbërritur ndonjë nivel të përsosjes dhe ngadhnjimit për të mbetur vetvetja në një botë që s’resht së përpjekuri të të ndryshojë, të të bëjë në një objekt, senda apo gjendje të orjentuar nën vullnesën e një force detyruese.

Ai, Fran Pacaj-Babaj përkundër gjithë kësaj force gravitacionale që e tërhiqte, ai ngulmoi me çdo çmim shkëputjen. Ai nuk pranonte të kishte një orbitë. Ai kishte lindur të ishte i lirë, të ëndërronte dhe të besonte se rrugët që duhet ndjekur janë ato të ëndrrës dhe të zemrës. Dhe vërtetë ai ndoqi ato rrugë për të mbetur deri në fund një e pazakontë që nuk pajtohej të nënshtrohej prej të zakonës, relatives, racionales. Megjithëse ju desh të bënte shumë marrëveshje, gjitha këto i bëri në emër të idealeve të tij krijuese.

### **Pas vdekjes nuk shkojnë të gjitha**

Me vdekjen fizike nuk shkon gjithçka. As Frani nuk duhej të merrte gjithçka me vete në këtë ikje të beftë. Ai i la këtu të gjitha, të gjithë çfarë e shenjtëroi çdo moment të tij, la pa mundur ti marrë me vete gjithçka që e



hyjnozi çastet që ai i ktheu në një mundësi sublime si pakkush tjetër. Me vete ai mori vetëm mishin, shtatin e tij që në ditët e fundit të jetës ju rëndua kaq shumë dhe e bëri të vuante kaq shumë pas një aksidenti të rëndë që pësoi në vitin 2012. Jetoj afro dy vite duke mos e dorëzuar jetën, duke mos hequr dorë për asnjë moment nga adhurimi për artin. Por vdekja vjen atëherë kur nuk e pret dhe Frani priste tjetërkënd para vdekjes dhe ishte kjo e fundit që e mori, e fiku atë shtat që u shterr prej dhimbjes. Në udhën e amshimit rrugëtoi shpirtin e tij. Ai iku por pas, pas la kujtime, shumë kujtime të cilat e mbajnë mes nesh për të mbushur boshin që grryn ky mungim. Frani la pas foto dhe sende të tjera që ai nuk i mori dot me vete në ikjen pa kthim. Ka mbetur këtu gjithashtu edhe ajo përmendore fame, ajo ngrehin përpjekjesh ngadhnjese që kishte për të besuar në realizimin e ëndrrave. Ai iku duke na lënë ëndrrat e tij të shpërdara në dëshirimet e të mundshmeve që



ushqyen kohën dhe u bënë rrjedhë e vërshimit.

Ëndërroi kaq shumë dhe iku duke besuar vetëm në ëndërr. Sepse ëndrra ishte gjithçka që jetoj, deri në mbylljen e qepallave dhe shuarjen e tik-takut të zemrës mëngjesin e 9 marsit të vitit 2014.

### Ai erdhi për të ndërtuar kultin e tij të krijesit

Aktiviteti i tij krijues është i larmishëm dhe synon të mbetet e fokusuar kryesisht në lëmin artistik. Kjo jo vetëm se ai mori shkolim në Liceun e Shkodrës, por edhe se ai kishte një shpirt të pasur, një zell të pasqor për të performuar në gjithçka dhe për të ofruar virtuoze të tij në të gjithë sprovat që në një farë mënyre i'a rrëmbeu me përdhuni jetës aspak dashamirëse. Megjithatë Fran Pacaj-Babaj ishte dhe mbeti një ngadhnjës i së mundimshmes, anatemës dhe heroikes. Sa e sa aktivitete kulturore-artistike mbajnë firmën e tij. Sa e sa sipërmarrje të promovimit dhe ruajtjes së vlerave dhe traditës kanë patur angazhimin e tij, punën kualitative dhe vendosmërinë e tij për të dimensionuar ato në kuota të larta vlere.

“Miss Adolehenca” ishte një produksion që ka dalë dhe ka marrë jetë nga ëndrrat e tij, nga dëshirimi i ethshëm për promovimin e

të bukurës dhe vlerave estetike, fatkeqësisht për t'u shuar në mënyrë të mistershme. Mbrëmjet e fundvitit në qytetin e Shkodrës, galatë me pjesmarrjen e artistëve më në zë të kryeqendrës veriore dhe jo vetëm, do të mbeteshin emblema të arritjes artistike dhe organizative të Fran Pacajt -Babaj. Me “Jehona e Shkodrës” ai mundi të përfaqësonte





dhe të promovonte vlera dhe kaPacajtete artistike inovative dhe ato që mishëronin traditën.

Fran Pacaj-Babaj do të shënjonte një rol të rëndësishëm edhe në veprimtrinë e tij të lëvizjes sindikaliste. Deri në të mbtramë të frymës ai mbajti detyrën President i Sindikatës së Pavarur të Artistëve, Gazetarëve dhe Sportistëve të Shqipërisë, sindikatë e cila vepron në kuadër të BSPSH-së, detyrë të cilën ai kreu me kaq shumë pasion e përkushtim.

Por edhe veprimtaria e tij politike ka një rol shumë domethënës në jetën e tij. Fran Pacaj - Babaj ishte aktivisti dhe anëtari më i përkushtuar i Partisë Demokratike, nismëtari dhe ndër themeluesit e saj në zonën e Kamzës.

Pikërisht për këto kontribute të pamohueshme, Fran Pacaj - Babaj mori mandatin e parë në zgjedhjet lokale të verës së vitit 1992, duke u zgjedhur në mënyrë demokratike si Kryetari i parë i Komunës së Zall-Herit të rrethit të Tiranës, si kandidaturë e Partisë Demokratike. Gjithashtu drejtoi për një kohë të gjatë periodikun e Partisë Demokratike, duke mbajtur njëkohësisht dhe post të rëndësishëm në këtë parti.

**Ikja e trishtë sipas rrëfimit të së bijës**

“Mjaft o babi! - i thirra unë”, tregon e bija teksa përpiqet të na përshkruaj gjithçka ndodhi në atë mëngjes të heret të 9 marsit. Ishte ora diku 6 e gjysmë e mëngjesit”, - vijon

ajo rrëfimin.

Zëri i babit dëgjohej deri tek dhoma ngjitur ku flija. Ai po bënte debat i nervozuar me çfarë po dëgjonte në lajmet e atij mëngjesi. U ngrita dhe gjeta babain teksa shihte lajmet e mëngjesit. Ishte ulur rrafsh mbi tapet dhe qëndronte mbështetur tek ndenjësja e kolltukut”.

-Nuk e sheh o babi se ne po flemë, e qortova. Ai më përcolli me vështrim ndërsa qëndronte ashtu ndenjtur, pa mu përgjigjur.

-Vëllai flinte nga dhoma tjetër. Mami kishte shkuar në Kosovë tek motra, e cila kishte pak kohë që ishte bërë nënë, vazhdon rrëfimin Fjori vajza e dytë e Franit.

U ktheva punëve të shtëpisë, tregon ajo. Nuk e di me saktësi se sa kohë kishte kaluar derikur u dëgjua zilja e derës. Ndërkohë që unë merresha me diçka, zilja binte. Pasi babai nuk po ngrihej të hapte derën shkova ta hap unë. Ndërsa drejtohesha përnga dera pash babin në të njëjtin pozicion ulur rrafsh mbi tapet dhe mbështetur tek ndenjësja e kolltukut. Kishte mbyllur sytë. Mendova se po shtirej.

- Po ti o babi pse nuk ngrihesh të hapësh derën, i thash dhe u drejtova nga hyrja, pa pritur të marr përgjigjen e tij.

Hapa derën dhe te porta ishin dy miqtë e babit, të cilët kishin lënë të takoheshin me Franin për të biseduar për skaletin e një aktiviteti.

- Është Frani në shtëpi, pyeti njëri prej tyre. Me një, “po” i ftova të hynin brenda. Ata përpara unë pas tyre.

Hymë të tre dhe babai qëndronte sërish



ashtu pa lëvizur me qepallat e syve të mbyllura.

Fran, o Fran thirri njëri prej miqve të tij. Ai nuk u përgjigj. Se mos ka gjë, i thash unë. Lërë, ia priti tjetri se ai aktor është dhe luan shumë bukur. Por nuk ishte tamam ashtu. Njëri nga miqtë insistoj ta përmend dhe e lëvizi lehtë pa mundur të marrë reagimin e Franit. Po këtij nuk i rreh pulsi, tha i shastisur ndërkohë që të tre qëndronim rreth tij. Unë, tregon Fjori, u ula dhe e afrova pranë vetes, duke thirrur, babi, babi, zgjohu! Unë thërrisja pa ditur se ai nuk do të zgjohej më, nuk do t'ia shihja më sytë e tij, nuk do t'ia dëgjoja më zërin. Teksa e mbështeta kohën afër times dhe e përqafova munda t'i shquaj frymën e fundit që ju shua në veshët e mi. Por nuk doja të besoja.

Duhet bërë diçka thirri njëri nga miqtë e





babait. Fjori shko me ... thirri dhe njoftoni poshtë për ndonjë ndihmë të shpejtë apo ndonjë ambulancë.

Vëllai kishte dalë nga shtëpia dhe po rrinte diku te lagjja me shokët. Unë zbrita dhe shkova te ambulanca ngjitur me pallatin duke kërkuar ndihmë.

-Babai im është sëmurë, a ka kush të më ndihmojë, thërrisja. Qetësohu u dëgjua zëri i mikut të babait dhe i farmacistes. Ndërkohë që ambulanca ishte njoftuar. Pasi farmacistja përfundimisht nuk kishte se me



çfarë të më ndihmonte, iu drejtova një grua aty pranë që kishte punuar kohë më parë si infermiere. Lutjeve të mia përgjëruese nuk mund t'i përgjigjej as ajo. Ndërkohë kisha njoftuar vëllain që rrinte me shokët tek pallati afër nesh që të ngjitej se babai nuk ishte mirë. Pas tentativave të dështuara, bashkë me shokun e tim e ti u ngjitëm dhe derën ma çeli vëllai, i cili më tha se babai kishte vdekur. Mes të qarave dhe britmave i'u afrova babait i cili vazhdonte të qëndronte në pozicionin ndenjor sikur flinte. Thërrisja, babi, babi! Qaja dhe vetëm qaja. E mora në një përqaftim pranë vetes pa mundur të

marrja reagimin e tij.

Ndërkohë shërbimi i ambulancës kishte mbërritur, kishte mbërritur atëherë kur gjithçka kishte marrë fund.

Doktori bëri ekzaminimet e duhura dhe duke u ngritur në këmbë, më gjysmë zëri tha, më vjen keq, ai ka vdekur nga një atak kardiak. Unë zura të qëlloj në gjoks mjekun duke thirrur, babai im nuk vdes, ai po fle, duhet ta zgjosh. Qaja, thërrisja dhe qëlloja mjekun, i cili nga ana e tij u përpoq të më qetësonte. Por gjithçka kishte mbaruar tashmë"

### Epilog

Të flasësh për jetën dhe veprimtarinë e Franc Pacaj -Babaj është si t'i hysh një aventure nga ato të kërkimit të thesareve. Sepse vetë jeta e tij ishte intensive, ishte e shumëformëshe, e shumëngjyrshme, ishte si një mister që rreket të ruaj deri në fund të fshehtë e zbulimit të thesarit.

Megjithatë në emër të mirënjohjes për gjithçka ai bëri duhej zberthyer ky kod, duhej hyrë në mistikën e kësaj jehone, duhej zbuluar gjithçka që ishte ngjeshur shtresë pas shtrese dhe mbante nën vete atë që do të rikthejë në jetë përmes kujtimeve



mikun dhe kolegun tim fort të çmuar, Fran Pacaj-Babaj.

Rrugët tona gjatë atyre viteve të njohjes, u bashkuan dhe u ndanë, për tu kryqëzuar disa herë. Sërish dhe sërish ai vazhdonte ishte ai, Frani, vërshuesi.

Gjithnjë do ta kujtoj atë si një burrë elegant. Gjithnjë shumë, po shumë i kujdesshëm për paraqitjen. Dukej se asaj ai i kushton-te kaq shumë, ndoshta edhe për shkak të veprimtarisë së tij dhe nevojës për të patur një paraqitje sa më dinjitoze. Sa herë takoheshim gjithnjë kishte, jo një, as dy, por disa projekt-ide për të realizuar, disa synime



për të mbërritur. Dhe gjithnjë pengesë ai do të kishte gjithnjë mundësinë financiare, volumin e madh të punës që kërkonte që ëndrrat e tij të bëheshin realitet. Bisedonim dhe shohisnim në aspekt formalizues të



ideve të tij, duke rrahur mendime rreth mundësive të arritjes së kësaj apo asaj ide, këtij apo atij projekt, sigurisht duke lënë shumë projektide të tjera si të panevojshme për tu trajtuar, pasi ishin relativisht pa mundësi realizimi. Gjithnjë gota do të ishte e pranishme, gjithnjë ai njeriu babaxhan do të shërbente për të qenë një mundësi e akomoduar mirë bisede dhe shoqërie.

Gjithqysh ai do të ishte një artist i talentuar, një mik i pashoq, një veprimtar i zellshëm dhe një ëndërrimtar që besoi kaq shumë tek ëndrrat dhe kaq shumë ëndrra arriti t'i bënte realitet.

# Gjok Pjetër Deçkaj shqiptaro-amerikani nga Kushe e Hotit flet për tmerret në kampet e Enverit

*Deshmia ekskluzive për Gazeten "Malësia" e shqiptaro-amerikanit, Gjok Pjetër Deçkaj, me origjinë nga fshati Kushe i Hotit, i cili pasi provoi kampet e Tepelenes dhe Savres, në vitin 1954 u arratis nga Shqipëria dhe perfundoi në SHBA*

E PAVARUR, INFORMATIVE, HISTORIKE DHE PATRIOTIKE

"Nje nate, nje grua e re nga Tropoja e cila priste te lirohej, shkoi naten per te hapur varrin e femijes se saj i cili i kishte vdekur para 8 muajve ne moshen 5 vjecare. Duke hapur varrin me lugen qe hanim supen, ajo fshinte eshtrat me fustanin e saj dhe i thoshte: "Nuk te le nena ketu ty jo". E shkreta grua, u detyrua t'i thyente eshtrat e te birit me qellim qe t'i fshihte ne rrobat e trupit pa u diktuar nga rojet e kampit, pasi nuk lejohej qe t'i merrte. Ate nate, bashke me te ka qene dhe nena ime duke e ndihmuar dhe me pas ajo mundi t'i merrte eshtrat e te birit dhe t'i varroste ne Theth". Deshmia e mesiperme e cila duket sikur eshte pjese e ndonje skenari te filmave horror, nuk eshte as me shume dhe as me pak, por nje ngjarje krejt e vertete e ndodhur gjysem shekulli me pare ne kampet e tmerrshme te regjimit komunist te Enver Hoxhes. Njeriu qe e rrefen kete histori tragjike, eshte 64 vjecari, Gjok Pjetër Deçkaj, i cili ka pasur vete fatin tragjik te provonte keto kampe qe porsa kishte ardhur ne jete. Per keto dhe te tjera ngjarje nga jeta e tij, ai rrefen ne kete interviste.

**Cila eshte origjina e familjes suaj?**

Origjina e familjes sone eshte nga fshati Kushe i Hotit ne Malesine e Madhe. Ne nuk kemi qene familje shume e madhe,

por babai im, Mark Pjetër Deçkaj, ka qene shume i njohur si burra i urte dhe me emer te madh ne te gjithe ate krahine. Si gjate kohes se Zogut dhe ne periudhen e Luftes, baba nuk eshte perziere fare me politike, por ka qene i njohur si nacionalist dhe patriot.

**Po me ardhjen e komunisteve ne pushtet ne vitin 1944, cfare ndodhi me familjen tuaj?**

Kur erdhen komunistet ne pushtet, ne nuk na pane me sy te mire, dhe baba, Marku, shihej si njeri i dyshimte. Kjo per faktin se ne vitin 1945, ai ishte mobilizuar forcerisht nga nje repart special i forcave partizane, dhe gjate asaj kohe, duke pare krimet e shumta qe bente ai repart, me arrestime, vrasje, tortura, djegie shtepish etj, kishte fituar nje urrejtje te madhe per ta. Pak kohe pasi u lirua nga ai repart, diku nga viti 1948, babai dhe gjyshi im, Pjetër Deçkaj, u arratisen nga Shqipëria.

**Si ndodhi arratisja e tyre?**

Ate vit, pra ne 1948-en, u arratisen plot 30 vete nga Hoti ne nje dite te gjithe se bashku dhe dolen ne Jugosllavi. Kjo ndodhi pasi nje oficer i postes se kufirit, u shkoi dere me dere dhe i njoftoi te gjithe keta persona se ishin ne liste per t'u arrestuar. Dhe kjo kishte qene e vertete, pasi nje ore pasi ata u arratisen, forcat komuniste u shkuan shtepi

me shtepi duke kerkuar per t'i pushkatuar. Nga keta 30 burra, me te njohurit ishin; Prek Gjeto Marku, Nikoll Luc Doka, Mark Doshi Frangaj, Pjetër Gjoni Luka etj. Bashke me keta 30 persona, u arratis edhe komandanti i postes se kufirit.

**Çfarë ndodhi me familjen tuaj pas arratisjes se babes dhe gjyshit?**

Une linda me 17 shtator ne 5 te mengjesit (dy jave pas arratisjes se babes dhe gjyshit) dhe ne ora 9, kur nena ime (File Pashk Ademi) ishte akoma me zorre neper kembë, erdhen dhe na moren forcerisht duke na cuar ne burgun e Koplikut. Gjyshja ime shkoi te Kol Maci i cili nderhyri tek komunistet dhe ne na kthyen prape ne fshat. Por nuk na lane me shume se 3 muaj dhe me 23 prill 1949, na internuan ne Tepelene. Ate dite qe ne moren per te na cuar ne Tepelene, baba kishte ardhur afer fshatit me dy shoke te tij, trima, me qellim per te na marre me vete, e me dal ne Jugosllavi. Ai eshte afruar jo me larg se 500 metra nga ne, duke me degjuar edhe mua qe qaja pa pushim, por nuk mundi te na ndihmonte dot. Ata dy shoket i thane: Medet Mark c'ka te bejme? Dhe baba iu pergjigj: Me ngushte nuk e kam pa veten kurre. Kam frike se ma vrasin djalin, prandaj nuk mundemi te nderhyjme. Pas nje udhetimi te gjate ne rruge pa rruge, ne na cuan ne kampin e Tepelenes. Djepi ku isha une ishte duke u rrezuar nga shpina e kalit dhe e ka mbajt Bora e Prek Gjeto Markut, se ndryshe do kisha rene ne gremine. Ne Tepelene gjetem edhe familje



**GJOK PJETËR DEÇKAJ**

te tjera nga Hoti e Kastrati dhe midis tyre edhe 13 priftërinj katolike të internuar. Une kam qene i vogel ne ate kohe, por nena me pas me ka treguar per vuajtjet dhe tmerret e paimagjinueshme qe kemi kaluar aty. Me kan treguar kur u rrita se Kryetari i Kooperatives se fhsatrave per rreth kampit dhe sekretari i partise kishin porositur fshataret e ketyre fshatrave te Tepelenes, qe femijet e tyre ti shanin dhe tu gjuanin me gure te internuarve. Dhe ka pas disa raste qe kur ktheheshin nga mali u dilnin perpara fshataret dhe shanin e gjuanin te internuarit.

### **Konkretisht çfarë mbani mend nga ai kamp?**

Aty vdisnin njerez cdo dite nga uria dhe semundjet, ku me se shumti femije te vegjel. Puna ishte mjaft e rende dhe sfiltese. Te internuarit punonin ne transportim lendesh drusore nepermjet Lumit Vjose dhe kur lumi ishte shume i rrembyeshem, qellonte qe lenda drusore t'i godiste dhe i linte te vdekur ne vend. Nga Gjirokastra aty sillnin

qen te ngordhur dhe qelbej i gjithë kampi. Vec ketyre nje tmerr i vertete i kampit te Tepelenes ishte nje kapter me emrin Tomi, i cili i ndiqte vajzat dhe nuset e reja duke i futur forcerisht ne nje magazine per t'i perdhunuar. Mua me kujtohet se kur kam qene 5 vjec, kapter Tomi me mbajti disa minuta ne uje te ftohte, me qellim per t'i bere presion nenes sime. Aq shume zullume beri kapter Tomi me grate e vajzat e internuara, saqe vete komanda u detyrua dhe e hoqi. Nena me lidhte me brezin e djepit tek krevati qe te mos bija, pasi ne flinim ne krevate me tre kate. Here pas here nenen e nxirrnin para te gjithë kampit dhe i shanin baben, Markun, duke thene se ai ishte kriminel e lloj-lloj sharjesh te tjera. Por nena ua kthente duke iu thene: Une e njoh per burre shume te mire. Po kete gje ia benin edhe Bores se Prek Gjeto Markut (Lulaj), por ashtu si nena edhe ajo nuk fliste asnje fjale te keqe per burrin e saj, perkundrazi e lavderonte. Po te mos kishim pasur ndihmen e dajave

te mi dhe gjyshes Katrine Praela, te cilet na vinin dhe na sillnin ushqime te thata ne Tepelene, ne do te kishim vdekur urie si shume nga bashkevuajtësit tane.

### **Çfarë kujton ndonjë ngjarje tjetër nga ai kamp?**

Nje nate, nje grua e re nga Tropoja, (gjyshja e nenes se Gezim Nikes, kengetarit te njo-hur) e cila priste te lirohej, shkoi naten per te hapur varrin e femijes se saj i cili i kishte vdekur para 8 muajve ne moshen 5 vjecare. Duke hapur varrin me lugen qe hanim supen, ajo fshinte eshtrat me fustanin e saj dhe i thoshte: "Nuk te len nena ketu ty jo". E shkreta grua, u detyrua t'i thyente eshtrat e te birit me qellim qe t'i fshihte ne rrobat e trupit pa u diktuar nga rojet e kampit, pasi nuk lejohej qe t'i merrte. Ate nate bashke me te ka qene dhe nena ime duke e ndihmuar dhe me pas ajo mundi t'i merrte eshtrat e te birit dhe t'i varroste ne Theth.

### **Kur u liruat nga ai kamp?**

Ne vitin 1954, ai kamp u mbyll dhe ne na derguan ne kampin e Savres ne Lushnje. Bashke me te tjeret dhe nena ime, punonte deri ne brez ne uje ne tharjen e Kenetes se Terbufit. Ne nje rast nenen e sulmuan shume ushunjëzat dhe asaj i ra te fiket sapo shoqet e saj e nxoren ne breg duke e ditur te vdekur. Tone Nuthi me kunatat e saj nga Pjetroshani i Bajzes se Kastratit, u perleshën me policet, te cilet donin ta fusnin nenen ashtu gjysem te vdekur me punu ne uje duke i thene: "Coju dhe puno moj kriminele". Ne ate pune nena punoi plot 3 vjet. Aty nga viti 1956, nje dite kur erdhi aty nje oficer madhor per inspektim, Rrok Kont Marashi, me mesoi mua t'i dilja perpara dhe t'i thoja se isha i pafajshem. Konti m'i kishte shkruar ne nje leter se cfare do t'i thoja oficerit dhe une ashtu bera. I thashe se baba me kishte lene ne bark te nenes kur ishte arratisur dhe c'faj kisha une. Ai u prek nga fjalet e mia dhe tha se do e studionin punen time. Mbas disa kohesh erdhi letra dhe une u lirova kur isha 8 vjec, ndersa nena mbeti aty. Erdhen kushërinjte dhe me moren aty ne kamp e me cuan ne fshat. Por edhe aty nuk me lane te jetoja, pasi fshati ishte zone kufitare dhe me cuan ne Kastrat, ku beja cdo dite nga 2 ore rruge per te shkuar ne shkollë dhe 2 ore per t'u kthyer ne shtepi. Shkollen 8-vjecare e mbarova shkelqyeshem duke qene nxenesi me i mire dhe bera nje kerkese qe te shkoja ne Konviktin "Tom

Kola” ne Shkoder, por me thane: “Rri urte e mbyll gojen se ti je djali i kriminelit Mark Deckaj. Shtrengo fort kazmen dhe mos u ndiej”. Keshtu, deri ne moshen 16 vjecare mua me rriten dajat. Ne ate kohe une isha i rritur dhe duke e kuptuar se nuk kisha asnje shprese per jeten, fillova te mendoj qe te arratisesha nga Shqiperia dhe te shkoja tek baba.

### **Ku ndodhej babai juaj ne ate kohe?**

Deri ne ate kohe, baba ishte ne Itali, ndersa gjyshi ne Tuz te Malit te Zi dhe ne komunikonim me letra me ta.

### **A kishit provokime dhe a u ndiqnin njerezit e Sigurimit?**

Nje person i quajtur Ndue Nikoll Markhelli, i cili ishte i dekoruar nga Kadri Hazbiu, me provokonte vazhdimisht duke vene radion te Zeri i Amerikes gjoja se do fliste baba im. Po keshtu here pas here ai me thoshte te arratiseshim se bashku. Une e kuptoja ate gje dhe nuk i lashe kurre te kuptonte se doja te arratisesha. Nje dite i thashe nenes (ne 1959 ajo u lirua nga internimi) qe te arratiseshim se bashku, por kur ajo pyeti nenen e saj, gjyshja tha: “Mos e len se do na vrasin djalin dhe do na marri ne qafe te gjithëve”. Keshtu nena me tha se ajo nuk vinte dhe une nuk duhet te ikja. Por une e kisha vendosur se bashku me dy shoket e mi, Kol dhe Gjelosh Narkaj dhe keshtu u arratisem.

### **Si mundet te arratiseshit nga Shqiperia?**

Me 13 qershor 1966, ditën e festes se Shen Ndout, i thashe nenes se do shkoja ne kisha. Ne fakt, se bashku me shokun tim, Kol Narkaj, (Gjeloshi nuk erdhi se martonte vellane) qe ishte nje vit me i madh se une, morem rrugen dhe ne fshehtesi dolem tek Leqet e Hotit, poshte ne Grabam dhe kaluam kufirin duke dale ne Jugosllavi. Aty u dorezuam te nje shtepi ku i treguam te verteten dhe ata na priten shume mire. Ajo shtepi kishte lidhje miqesie me familjen tone dhe gjeten mundesine te lajmeronin se ne ishim dorezuar tek ata. Me pas, sipas rregullave ata na dorezuan tek ushtaret, te cilet na moren dhe na derguan ne burgun e Leshkopoljes, ku na mbajten 2 muaj ne hetuesi duke na pyetur. Gjate asaj kohe, me nderhyrjen e Rroko Keqit (nga Tuzi), tek autoritetet jugosllave, ne nuk na kthyen ne Shqiperi, por na liruan dhe une shkova tek gjyshi im, Pjeter Deckaj i cili ishte ne Tuz. Me gjyshin qendrova 9 muaj ne Tuz dhe ne ate kohe, baba qe ndodhej ne SHBA, kishte

bere letrat dhe me 27 shkurt 1967, me doli azili politik per ne Amerike. Keshtu nga Beogradi u nisa per ne New Jork, ku me priste baba me nje foto timen ne dore, te cilen ia kisha derguar me poste. Ka qene nje takim prekes ai me baben ne aeroportin Xhon Kenedi te New Jorkut. Baba me shikonte dhe une e shikoja. Kur m’u afrua une i thashe: “A ti je baba im?” Po tha, vetem njehere ta kam degjuar zerin. Te kam lene ne bark te nenes dhe thosha se do jete djale. Lotet na kishin mbuluar te dyve. Une i thosha: “O Mark Deckaj. Behu i forte pse qan”? Baba me pyeste se pse kisha ardhur dhe une i thosha se kisha pritur 17 vjet dhe doja t’i shikoja syte e ballit babes tim. Ndersa ai me puthte, une i thosha: Tash nuk jam ma i varfen, nuk jam i pababe.

### **Po pas arratisjes suaj, cfare ndodhi me nenen?**

Pasi ika une, diku nje vit me vone, ndersa nena ishte ne bjeshke, spiuni Ndue Nikoll Markhelli, lajmeroi policine se nena donte me u arratis, dhe ata erdhen e moren dhe e internuan ne Hajmel, ku qendroi per 19 vjet me radhe.

### **Gjate kohes qe babai juaj Marku jetonte ne Amerike, a eshte marre me politike?**

Me politike babai eshte marre qe kur ishte ne Itali, ku u zgjodh kryetar i Bllokut Independent Kombetar duke bashkepunuar ngushte me Ernest Koliqin, Gjon Markagjonin, Ismail Verlacin, Kol Bibe Mirakajn etj. Gjate asaj kohe, njerezit e Sigurimit te Shtetit Shqiptar i bene babes nje atentat me pistolete, por ai mundi te shpetonte i plagosur ne krah. Por edhe ne spital ate deshen ta helmonin me disa biskota te cilat

i solli aty nje grua e veshur si murgeshe e cila pas hetimeve te Ernest Koliqit, rezultoi se kishte dale nga Ambasada Shqiptare ne Rome. Pas kesaj, baba u detyrua dhe shkoje ne Amerike.

### **Po me nenen tuaj kur u bashkuat?**

Me 16 gusht 1990, kur isha 42 vjec, une erdha ne Shqiperi dhe takova nenen e cila ne ate kohe banonte e vetme ne Shtoj. Baba dhe gruaja ime me thoshin te mos vija se akoma nuk kishte rene komunizmi, por une e kisha vendosur dhe me mua erdhi dhe gruaja. Ne Rinas me nxoren shume probleme dhe nuk donin te me vulosnin pasaporten dhe pas nje debati prej 15 minutash, ma vulosen. Nenes i kerkova falje dhe ajo me tha se ma kishte bere hallall. Pas 5-javesh munda t’i bej letrat nenes dhe e mora me vete ne Itali, ku me pas erdhi dhe baba. Keshtu pas 42 vjet e 3 muajsh, ata u takuan ne Rome. Ka qene nje takim prekes ku vetem lot kishte. Baba dhe nena jetuan 3 muaj ne Itali dhe me pas erdhen ne SHBA ku u beme te gjithë bashke. Une i shihja kur ata qanin per njeri-tjetrin. Kur nena e pa se sa mire jetonim, tha: Tani jam gati me vdek. Dhe ashtu ndodhi vertete: Me 2 korrik 1991, dite e marte, ata te dy humben jeten ne nje aksident automobilistik.

### **Po ju kur e krijuat familjen?**

Une jam martuar me 22 tetor 1971 me Lajde Mark Gjonajn, babai i se ciles, Pashuk Markgjonaj rrjedh nga nje familje nacionaliste mjaft e persekutuar nga regjimi komunist, njesoj si ne. Une kam 3 djem: Robertin, Palin dhe Tomin, i cili eshte asistent-regjisor dhe producent filmash ne Hollivud ku ka bashkepunuar ne 34 filma.



**BANESA KU STREHOHESHIN TË INTERNUARIT**



# ERMIRA YMERAJ

## intelektualja që nderon vendin e origjinës Malesinë e Madhe dhe Shkodër locen!

**E**rmira Nikolin Ymeraj, ndonse ka lindur dhe është rritur në qytetin e Shkodrës, aty ku prej shumë dekadash më përpara kishin ardhur nga Malësia e Madhe (etnike) të parët e saj për një jetë më të mirë, në malesorët krenohemi me punët studimore dhe veprat e kesaj Doktoreshë të Shkencave, pasi në e kosniserojmë bijën tonë të Malesisë së Madhe. Dr. Ermira Ymeraj prej disa vitesh njihet si një intelektuale e formuar, e ditur dhe me një kulturë të gjerë. Dijet dhe kulturen e saj të fituar gjatë arsimimit, kualifikimeve dhe studimeve, ajo kurr nuk ka kërkuar ti mbajnë për vehte, por është perpjekur tju a jap edhe të tjerëve e veçanarisht nxënësve të gjimnazit të Koplikut e tjer, ku ajo ka punuar si mesuese para disa viteve. Mesuese Mira siç e thërrisnin nxënësit e saj mbahet mend edhe sot, për aktivitetet dhe veprimtaritë e zhvilluar (letrare dhe artistike) nga ajo në shkollë e më gjërë. Dr. Ermira Ymeraj studimet dhe dijet e saj prej vitesh i ka kthyer në vepra (libra).. Si çdo i ri apo e re me formim e me shpirt dije, ajo si fillim në vitin 2011 do të prezantohej me librin e parë me poezi, me titullin dmth “Pirg Dhimbjesh”, botim i shtepisë botuese “Naimi”, Tiranë. Në vitin 2013. Dr. Ermira do të botonte edhe librin e dytë me poezi me titullin “Zemër Dip-tike”, liber që do tja besonte po shtepisë botuese “Naimi”, Tiranë. Po në vitin 2013 Dr. Ermira Ymeraj do të publikonte monografinë –studim :”Shtegtimi i Miteve ; nga religjioni e folklori në letersi”. Të botuar nga shtepia botuese “Naimi”..Por libri



ERMIRA YMERAJ.

më domethenës është libri i “fundit” (nga radha) i Dr. Ermirës me titullin “Balada si paratekst në letersinë shqipe (Motivi i ringjalljes, flijimit dhe inçestit) Studim krahasues ndërballkanik”, botim i entit botues “Gjergj Fishta”, Tiranë 2015. Ky libër siç e pohon edhe vetë autorja e ka fillimin në desertacionin e saj të vitit 2009..., por tashma ky liber është një veper e vertet studimore prej 320 faqesh, që sjell mjaftë risi në fushat që trajton... Libri është i ndarë në dy pjesë, ku pjesa e parë perbehet nga dy kapituj dhe pjesa e dytë nga tre kapituj. Temat që trajtohen në këtë libër janë shumë interesante. Disa nga keto trajtesa

unë mendova ti cilësoj (pa komente): Prej djepit në varr. Ëndërra e njeriut për jetë të pakufi ; perjetsia-amashimi, Ringjallja e Lazërit, ringjallja e Krishtit. Shenjtërimi i ringjalljes. Ringjallja sanktuale kanonike, ekskluziviteti i ringjalljes në letërsinë ungjillore. Ringjallja si pikë takimi e shumë eposëve. Vdekja e perkohshme ; ”Muji mbas deket”, “Halili mbas deket”. Heroi shqiptar dhe statuset e vdekjes. Kufiri midis jetës dhe vdekjes dhe eposi ynë. Ringjallja laike si paratekst i baladave. Paralelizma mes trekendëshit motivor Brenda arealit kulturor ballkanas. Miti i ringjalljes –Kadare ; miti i flijimit –Andriç ; miti i Penelopës- Varnalis, në arealin ballkanik :Shqiperi –Bosnje-Greqi...Baza pagane dhe e krishterë e motivit të flijimit në balada. Funkzioni simbolik i flijimit të gruas nga mitologjia në baladë. Zidanje Skadra dhe Kënga e Rozafatit, veshtrim krahasues...Motivi i inçestit dhe format e saj. Tipet e inçestit si kujtesë motivore dhe shtresa e saj universale ; indoeuropiane, ballkanike dhe protoshqiptare. Kulti i prindit, kulti i mallkimit si nyjëtoje e ndalesave dhe fillesa të tragjikës... Tabu dhe Eufemizmë në gjuhën e baladave... etj.. Të gjitha keto trajtesa pershkohen nga një finesë e zhdervjedhtë letrare, gjuhësore, artistike, psikologjike e mbi të gjitha filozofike, edhe pse ato mbeshteten edhe në tabanin popullor, dhe janë të krahasueshme me atë ndërballkanik. Trajtesat kanë edhe një burimologji interesante të autorëve më në zë shqiptar e të huaj, çfarë i jep këtyre librat edhe vlera shkencore. Kjo duket se

ka qenë aresyeja që recensentë të ketij libri të jenë Prof.dr. Shaban Sinani, i cili shkruan edhe pasthenien e librit dhe prof. dr. Roland Zisi.

Dr. Ermira Ymeraj pjesmarrese edhe në disa konferenca shkencore nderkombëtare Në të gjitha konferencat shkencore (jashtë Shqipërisë) kumtesat dr. Ermira Ymeraj që janë vlersuar si një punë e mirfilltë studimore, krijuese dhe shkencore, ndaj disa nga ato kumtesa po i rendisim si më poshtë :

1. “Eposi i kreshnikëve: monument i trashëgimisë kulturore shqiptare”, Organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Qendra e Studimeve Albanologjike në Tiranë, 28 - 30 Gusht 2010. Me temë: “Ringjallja në eposin shqiptar si trashëgimi ungjillore”

2. “Java e Albanologjisë”, Instituti i Albanologjisë, Prishtinë, 25 - 29 Tetor 2010. Paneli: “Letërsia shqipe pas rënies së mureve”. Me temë: “Azem Shkreli dhe Xhevahir Spahiu, dy poetë “mbi mure”.

3. “Demonstratat e vitit 1981; “Kthesë e madhe në lëvizjen kombëtare shqiptare”, Me temë: “Letërsia, kultura dhe artet në Tiranë dhe demonstratat e vitit 1981, jehona frymëzimi”. Mbajtur në konferencën shkencore në Instituti i Albanologjisë dhe SHBPK, Prishtinë, 03 - 04 Qershor 2011.

4. Kumtesë në Takimin e VI-të vjetor të Institutit Albshkenca, Prishtinë, 01-04 Shtator 2011. Me temë: “Familjet patronimike arbërore në anëshkrimet e kodikëve të Shqipërisë: aristokracia arbërore dhe aristokracia evropiane”.

5. Kumtesë në Javen e Albanologjisë, - Organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës..dt. 14 - 18 Nëntor 2011. Me temë: “Andrra e Pretashit” dhe “Valë mbi valë”, si dy vepra mes historisë dhe letërsisë”, Autor i parë: Ermira Ymeraj, autor i dytë: Eduart Grishaj.

6. “Kontributi i dy revistave letrare “Hylli i Dritës” dhe “Leka” në vitin 1937, në prapë e 25-vjetorit të pavarësisë”, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore ndërkombëtare: “Shekulli i shtetit shqiptar”, Prishtinë 11-13 Qershor 2012, tjer...

Pak nga Curriculumi i edukimit intelektual e ngrzor i dr. Ermira Ymerajt

Dr. Ermira Ymeraj në vitin 1995 mbaroi me sukses studimet e larta në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në Fakulte-



**KOPERTINAT E KATËR LIBRAVE TË DR. ERMIRA YMERAJ**

tin e Shkencave Shoqërore, dega Gjuhë Letërsi. Vazhdoi studimet pauniversitare në Universitetin Shtetror të Tiranës për letërsi dhe në vitin 2010 mbaroi studimet Master Shkencor për “Etnokulturë dhe letërsi shqipe” në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ku mbrojti temën “Ringjallja në Epos”. Në vitin 2013 mbrojti titullin “Doktore Shkence”, në fushën e studimeve letrare, specialitetin “Letërsia dhe Baladat”, me tezë “Balada si paratekst në letërsinë shqipe –veshtrim krahasues ndërbalkanik”, pranë Qendres së Studimeve Albanologjike në Tiranë. Por dr. Ermira Ymeraj nuk është e knaqur me kaq, pasi ajo vijon studimet dhe punimet e saja për të fituar gradën e profesoresh, që me thenë të drejten me punën dhe vepratë saja e ka fituar prej kohësh praktikisht. Dr. Ermira Ymeraj në hyrje të ketij libri “Dy fjalë për lexuesin” shkruan : “falnderoj dhe vlersoj për bashkëpunimin në rritjen dhe pjekurinë, argumentin tim shkencor, udhëheqësin tim prof.dr.Shaban Sinanin , për kritiken, inkurajimin, mbështetjen dhe rreptësinë gjatë studimeve akademike, profesor Emin Kabashin , për mbështetjen dhe ndihmen shkencore. Një falnderim të veçantë do ua dedikoj miqve dhe kolegëve që asnjëherë nuk më shmangën informacionin e kerkuar dhe nuk i kursyen men-

dimet e tyre, prof. Ledri Kurtin, prof.dr. Vebi Buxhetin, prof.dr. Matteo Mandala e shumë studiues të tjerë. Botimin tim ua dedikoj bijave të mia, Keidës, Klevias, Jasminës, bashkëshortit tim Kadri Ymeraj për gjithshka bëri e vazhdon të bëjë për mua, nënës time Marjana e babit tim të ndjerë Nikolin Preka. Babi i shtrenjtë, që atje lart më ndiq”. Në këtë dedikim unë verej përveç të tjerave edhe funksionimin e institucionit të bashkëjetesës dhe harmonisë të mrekullueshme ndërjetare, që ka qenë dhe është themeli i qendresës ndërshekullore të kombit tonë, pasi Ermira është katolike, ndersa burri i saj është intelektual i njohur e nderuar z. Kadri Ymeraj –musliman nga besimi, ndaj unë besoj se dr. Ermira edhe në të ardhme do të jenë ndera e faqja e bardhë e intelektualizmit shqiptar, por mua më “intereson” mbi të gjitha të atij të Malesisë së Madhe dhe të Shkodrës, e cila pa malesoret e saj që e popullojnë me shumicë pas shekullit XV-të e ketej, do të ishte një ISH...e jo siç është sot djepi i kulturës dhe historisë së shqiptarisë... .Faleminderit Ermira dhe suksese të metejshme, që janë padyshim edhe suksese të origjinës tënde Malesisë së Madhe që siç ka “mbiemrin” e madhe ka edhe vlerat , ku një nga keto vlera je edhe ti dr. Ermira Ymeraj... **Ndue Bacaj**

# Veleciku i Koplikut apo i Malësisë?!

**E**kipi i futbollit të qytetit të Koplikut, me emrin Veleciku kulmet e veta i ka në vitet 80-te dhe që perkonte edhe me shpalljen Qytet të qenderes së Malesisë së Madhe e sic është edhe tani. Formimi i të cilit aso kohe i dha koplikut me shumë qytetari, dhe ku në emer të ketij ekipi me se shumti luanin Shkodranet që i tepronin Vllaznise, të izoluar nga bota tjetër e futbollit European e Boterore, dhe ku sporti ishte shumë masiv, është e vertet se Malesia e Madhe nuk ka ndonjë histori të madhe futbilli, por është edhe e vertet se nga malesia kanë dale jo pak sportiste shumë të njohur, dhe në disa lloje sportesh e nese mbetemi tek futblli. Dy malesore nga Reci i malesisë dhe konkretisht E. Hysaj dhe B. Bala sapo moren pjese në kampionatin European të futbollit.

Nese i referohemi historise se pase viteve 1990, kontribuesi me i madhe i ruajtjes së futbollit në Malesin e Madhe padyshim që është Besnik Duli, pore i ndihmuar fare pak ose aspak që kompleksin Vellezerit Duli, ta kthejë se paku në një fushe të mirfillt futblli sa për kushtet që i

nevoiten Velecikut për të luajtur në Qytetin e vete, fushe e cila pas kaq vitesh mese shumë ngjan me një tok bujqesore se sa një fushe futblli. e kete e tregon edhe kadegoria ku Veleciku luan tani ekip i cili në vitet 2003-2004 dilte kampion dhe luante edhe në kadegorin e pare, të futbillit Shqiptare kjo e realizuar për merit edhe të ishe kreut të bashkis Koplík. Ramadan Likaj i cili e shrytezoj me se miri edhe politikisht por se paku ekip dhe jo rralle, edhe me parat e veta si biznesmen ka bere.

Politik që e perseriti edhe kreu aktual tani i Bashkisë Malesia e Madhe T. Marinaj i cili solli në fushatën e tij elektorale futbollistin shkodran nga Malesia. Rudi Vata që perpak sa nuk e futi Velecikun edhe në Campions Lige.

Nuk duhet harruar ase kontributi i të ndjerit

Perlat Ramcaj që me shumë veshtiresi por me fisnikerin që ai kishte, kontribonte dhe ndihmonte ekipin e qytetit tij të lindjes. Edhe pse quhej Veleciku i koplikut, kure dihet se mali i velecikut ndollet në njesin administrative të Kastratit, mirpo gjerat tani kanë ndryshuar e Malesia e Madhe është një njesi administrative, ku me për një pele nuk të bie një fel. Ndoshta masa e pare që duhet marrë është ndryshimi i emerit, duke e quajture Veleciku i Malesisë. Ose ekipi Malesia e Madhe sic e ka Vllaznia e Shkodres, për mendimin time në kushtet e sotme dhe kure veleciku nuk ka Stadium të vetin, ase mjet ulltimi, ase sponsor, e shumë mangesi të tjera financiare dhe kure ase biznesmenet nuk japin me se nuk kanë ku të marrin, ky ekip nuk mund të funksionoj kurrsesi vetem me ato pake fonde që jep Bashkia, vertet



që T. Marinaj ka premtuar Stadium por edhe Berlusconi po e shet Milanin, ekip disa vite më parë kur malesoret i kishin pak para pati bere edhe Sterbeqi por nuk mbijetoj, e në keto kushe mose mbijetese tani është edhe Veleciku. dhe për më tepër i mbetur jetim duke mos u ditur se i kujt është i koplikut apo i malesisë. Gjithsesi që të sigurohet egzistenca aktuale e ketij ekipi bashkia e koplikut duhet të hapi një numer llogarie banke ku çdo Malesore në të gjithë botën, duhet të japin nga pake para për Velecikun e Malesisë. Sa mirë u gjetkan fonde për mëse bjeshken apo mëse malesin, e biles edhe duke sjellur vajza Malesore edhe nga vende të tjera të botes ku ato jetojnë. Malesia ka jo pake kapacitete dhe mundesi që kete stadium, ja tre alternativa që janë të mundura e para. Egziston në Ministrin e Kultures dhe Sporteve projekti i disa viteve më parë i bere nga një tjetër i ndier. Millan Vaso kure ishte zevendes Minister, që fusha e futbollit të Razmes të behet Stadium, alternativa e dyte është blerja nga bashkia e ishe fushes së para viteve 90, dhe treta dhe që do kishte kosto ndoshta më të ulët është, ndertimi i shkalleve në kompleksin Duli, vendi Gazetareve, dhomat e zhveshjes si dhe një rrethim i sigurt. Në të kundert Velecikun nuk do ta kemi e dita e gjykimit nuk do të jetë e largët për të gjithë ne. **Vasel Gilaj/ New York**





# KUR QESH MALËSORI

Nga "Malësori hokatar"

1 Djali ishte bere 40 vjec dhe nuk prante te martohej,ne nje momente per t'ia mbushur mendjen baba i tij i thote, te paste baba shpejto per te paren qe te lashe vend edhe per te dyten.

2 Nje tjetër Malesore i kishte kaluar te 50 – tat, pa u martuar nje shok i thote po pse nuk martoresh mor burr te kaloj koha,po si te Martohem ne kete moshe kur te me lindin Djali me thote per shpirt Babes.

3 Ne vitin 1997 ne Malesin e Madhe vdes nje person me emerin Martin,i cili kishte qene anetar i partise komuniste e me pase edhe i asaj demokratike.Ne mes tjerash gjate vajtimit Vajtoria i thote

Ooooo Martin he ty te rafte Zana  
Po ti qief ke pase me i thith te tana  
Me thye zyra edhe xhama  
A t' met marak ty Fatos Nana  
Ooooo Martini i amel e i bute  
Si gjithmon hangre me dy luge  
E pse i dhe Dulles informacion  
Te shperbleu Sala me 20 milion  
Martin kuku lele per mua  
Paj kush si ti s'ka diskutua  
Gjithmone ne mbeledhje te Partis  
Ti i pari ja ke nise  
Se kje Martini i Partise  
Dhe Martiri i demokracise

4 Nje Malesore vdes ne moshe te re dhe kishte lan kuptohet ,edhe gruan po ne moshe te re

Vajtori qe po e vajtonte sipas zakonit ne mese tjerash i thote edhe keto fjale.

A'po nie more i Nisan  
12 muaj kane 13 hane  
A'e sheh Nusen qe ke lane  
Me 100 kile mish e dhjam  
E s' mujti e mjera me u ba nane  
E ti i dekun e kjo shnosh  
Oooo me pase vete kjo t'bane Binosh  
More i mjeri ooo,oh,oh,oh


5 Njeri po ulltonte me Autobuzin e qytetit ishte afruar nje gruaje dhe e shtynte her

pase here, gruaja i drejtohet po mos na shtyj more shok shum afer po na rrin,burri per tu justifikuar i thot nigjo moj shoqe sot kam marre rrogen dhe kam fute doren ne xhiep se mose ma vjellin,udhtimi vazhdonte pas pak gruaja i drejtohet perseri shok me duket se po te rritet rroga.

6 Nje malesor ne Amerik po kthehej naten vone nga puna,takon nje femer ne rruge dhe i thote sa dollar kushton 20 dol-lare,per drej i gjen policia dhe malesorin e burgosin,kur i shkon bashkeshortja te burgu i thote po si na korite more burr,hajt he burneshe se per 20 dollar nuk deshta me te cua ty prej gjumit.

7 Njani ne Malesi shkon per vizite tek nje shok i tij,gruaja e shokut po fergonte specat dhe i kishte hapur kembet pak si keq burri i saj e shikonte skenen por nuk po dinte si me ja thane,pase pak i thote grua mblidhi kamet pake se po na marrin specat voj shume.

8 Pash nerin i thote njeri ne SHBA shokut te vete,a me pate than se e kam gruan shtatezan c' ka ndolli po por e deshtuam e pse,sepse patme frige se po na del zezak



Kush është për një xhiro... rrugën tjetër

sqaroi tjetri.

9 Burre e Grua shkojn te flen,gruaja duke kerkuar ndihmen e zotit thot disa here O krisht flej sonte me ne O krishte flej sonte me ne, burri cohet nga krevati dhe vishet ku po shkon i thot gruaja,une po dal se nuk na zene te treve u pergjigj burri.

10 Gjok i thote shoku shokut qe po takoheshin pase shum vitesh,a jan martuar djemt po po,po prej kahit i kan marre nuset oouu u pergjigj Gjoka kjo nuk eshte pyetje,keta kopila me dasht ti bien edhe mashkuj,e ti po ankon se prej kahit i kane marre femrat.

11 Dy malesore sapa zbriten nga Avioni ne aeroportin e New Yorkut,gjeten 50 dollare a te kam than tha njeri se ne Amerik jan leket per toke,mose i merr ia ktheu tjetri se fillojm e i mbeledhim nesar se sote jena lodhe.

12 Ku i ke mustakt i drejtohet njeri nje mikut te tij i hoqa po pse te kan shkuar shume,po sepse mora nje kredi nuk mujta me pagua, e tash po me vjen marre se me thone je edhe burre me mustak.

13 Pashe nerin pse bertasin kaqe shum shqiptaret per kyt reformen ne drejtesi a c'ka po i thon tha njeri po shqiptaret jan mesua me nej ne burg tha tjetri.

14 Nje ishe komuniste thote per ideal te partise Enver Hoxha ka qen burr i forte,pasha nerin ma te forte na qe e kem durua sqaroj tjetri.

15 Njeri nga SHBA shkon ne Malesi te Madhe nje dite i thot shokut te tij,ma gjej noj peder,po nuk ka jap 5000 dollar jo jo nuk ka,po jap 10000 dollar prap i thot nuk ka,po jap 15000 dollar jam mesuar keq at'her tek jam une sqaroi shoku,po pse thua se nuk ka po thuaj se nuk ka lek.